

Raporti Vjetor i vitit 2000, siç është tradita e këtij raporti, paraqet zhvillimet më të rëndësishme të ndodhura gjatë vitit në Bankën e Shqipërisë dhe në mjedisin ku ajo vepron. Këto zhvillime janë trajtuar me detaje për të prezantuar për publikun një pamje sa më të qartë të ngjarjeve.

Nga kjo mori ngjarjesh dëshiroj të veçoj tre aspekte kryesore: situata makroekonomike, politika monetare dhe zhvillimi institucional i Bankës së Shqipërisë.

Për të tretin vit, rradhazi, në Shqipëri patëm **zhvillime makroekonomike** të balancuara dhe brenda kornizave të vendosura nga programi i zhvillimit afatmesëm. Në tërësi, vlerësohet që ekonomia shqiptare të jetë gjallëruar më tej nga rritja e sektorit privat të ekonomisë. Ndërkohë, sektori shtetëror vazhdon të tkurret si pasojë, kryesisht, e privatizimit të tij. Zhvillim i rëndësishëm i vitit 2000 ishte privatizimi i disa njësive publike të sektorit strategjik të ekonomisë gjë që u shoqërua me më shumë investime të huaja, me përmirësim të klimës së investimeve në ekonominë shqiptare dhe me më shumë të ardhura për buxhetin e shtetit. Mbi të gjitha rëndësi kanë përfitimet afatgjata që do të sigurojë ekonomia shqiptare nga ky proces. Megjithatë, gjykohet se për shkak të krizës energjitike që kaloi vendi në tremujorin e fundit të vitit, rritja e ekonomisë të mos jetë realizuar aq sa ç'ishte parashikuar në fillim të vitit.

Inflacioni në fund të vitit arriti në 4.2 për qind. Prej tre vitesh, në Shqipëri, po vërehen norma të ulëta inflacioni gjë që ka bërë që të arrihet stabiliteti i çmimeve. Por, nuk mund të themi ende se është ruajtur ky stabilitet çmimesh. Pavarësisht se tendenca e çmimeve të konsumit prej vitit 1998 ka qenë në rënie, lëvizjet, nga një muaj në tjetrin, të tyre kanë qenë relativisht të konsiderueshme duke mos paraqitur një situatë të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Treguesi më i drejtpërdrejtë është rritja e inflacionit me 4.6 për qind në muajin dhjetor 2000.

Viti 2000 shënoi të tjera zhvillime pozitive në aspektin fiskal. U rrit niveli i realizimit të të ardhurave, sidomos i të ardhurave nga tatimet dhe doganat gjë që flet për përpjekje të shtuara për reduktimin e evazionit fiskal dhe kontrabandës. Po ashtu, ndryshe nga vite të tjera, ka një realizim më të lartë edhe të shpenzimeve buxhetore duke mbetur si një nevojë përmirësimi i punës në realizimin e shpenzimeve kapitale dhe sigurimi i një shpërndarjeje më ritmike të shpenzimeve gjatë gjithë vitit.

Sipas vlerësimeve më të fundit të Bankës së Shqipërisë për zhvillimet në bilancin e pagesave, në përgjithësi, mund të thuhet se treguesit kryesorë në fund të vitit përputheshin me zhvillimet e parashikuara në programin monetar. Përfundimisht bëjnë eksportet, të cilat këtë vit jo vetëm nuk u rritën, por u paraqitën 7 për qind më të ulëta se viti i mëparshëm. Megjithatë, si llogaria korente ashtu edhe ajo kapitale përputhen me parashikimet.

Klima e favorshme, e krijuar në ambjentin makroekonomik mundësoi arritjen e rezultateve të kënaqshme në fushën e zbatimit të politikës monetare me anë të instrumenteve indirekte. Pra, zhvillimi më i rëndësishëm në **zbatimin e politikës monetare** ishte zëvendësimi i plotë i instrumenteve direkte (kufiri i kreditit dhe norma e interesit për depozitat me afat në lekë në bankat shtetërore) me ato indirekte. Nëpërmjet ankandeve të repo-ve dhe konkretisht nëpërmjet interesit maksimal që Banka e Shqipërisë ofron në treg dhe shumës së rezervave të tepërta të deklaruar për t'u blerë, përçohet politika e bankës qendrore në lidhje me normat e interesit. Në vitin 2000, në mënyrë të vazhdueshme, Banka e Shqipërisë ka vepruar në drejtim të uljes së normave të interesit në ekonomi. Rezultate të drejtpërdrejta të politikës së bankës qendrore dhe të situatës makroekonomike kanë qenë rritja e gjendjes së kredive, me rreth 3 herë, krahasuar me vitin 1999 dhe rritja e fitimit të sistemit bankar me rreth 4.5 herë më shumë se viti 1999. Objektivat sasiorë të politikës monetare u realizuan brenda kufijve të vendosur. Në tërësi, politika monetare e hartuar dhe e zbatuar nga Banka e Shqipërisë kontribuoi në mbajtjen në nivele të ulëta dhe të qëndrueshme të çmimeve të konsumit.

Së fundi, vetë **institucioni i Bankës së Shqipërisë** ka rritur cilësinë e punës së tij. U riorganizua struktura e bankës me qëllim që t'i përshtatej më mirë përmbushjes së objektivave strategjike si dhe për të siguruar një lidhje funksionale më efikase midis departamenteve dhe njësive përbërëse të tyre; vëmendje iu kushtua zhvillimeve në teknologjinë e informacionit, përmirësimit të statistikave, rritjes së transparencës dhe besueshmërisë së bankës, angazhimit më intensiv në çështje të legjislacionit ekonomik dhe të integritit. Të gjitha këto aktivitete ndihmojnë në realizimin e objektivit strategjik të Bankës së Shqipërisë, përafrimin me Bankën Qendrore Europiane.

Shkëlqim Cani

Guvernator



Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

Nga e majta në të djathtë ulur:

Fatos Ibrahimi	anëtar dhe Zëvendësguvernator i Parë
Shkëlqim Cani	kryetar dhe Guvernator
Dhame Pite	anëtar dhe Zëvendësguvernator i Dytë

Nga e majta në të djathtë në këmbë:

Drini Salko	anëtar
Llazi Balliu	anëtar
Sabah Hilmia	anëtar
Bajram Muça	anëtar
Sulo Hadëri	anëtar

Kapitulli I. Ekonomia

1.1. ZHVILLIMET NË EKONOMINË BOTËRORE

1.1.1. EKONOMIA BOTËRORE GJATË VITIT 2000.

Mbarimi i vjeshtës 2000, përkon me një ndryshim në parashikimet e bëra në fillim të vitit për rritjen globale. Parashikimet “e reja” jepnin një situatë pak më pesimiste duke u bazuar kryesisht: në një ngadalësim të dukshëm të ekonomisë amerikane, në një mosbesim në ringjalljen e ekonomisë së Japonisë, në një rritje më të moderuar të vendeve të zhvilluara të kontinentit amerikan dhe të një numri të madh të ekonomive në zhvillim.

Ekonomia amerikane vazhdoi të ketë një rritje të fortë gjatë gjysmës së parë të vitit 2000 (me një ritëm 5,25 për qind në bazë vjetore), duke kapërcyer edhe parashikimet më optimiste të bëra deri në atë moment. Rritja ishte më tepër rrjedhojë e forcimit të kërkesës së brendshme se sa e eksporteve neto. Megjithatë, gjysma e dytë e vitit regjistroi një frenim të aktivitetit ekonomik (sidomos në tremujorin e fundit, i cili në bazë vjetore shënoi vetëm 1 për qind). Ky ngadalësim pasqyron kryesisht rritjen e çmimeve të energjisë si dhe përkeqësimin e kushteve financiare, përfshirë rënien e Nasdaq dhe vlerësimin e dollarit amerikan.

Ndërkohë, sinjalet nga **ekonomia japoneze** vazhdojnë të jenë akoma të paqarta, duke reflektuar ngadalësimin e përgjithshëm të ekonomisë botërore, besimin akoma të dobët të konsumatorëve, si dhe problemet e njohura që karakterizojnë sistemin financiar të Japonisë.

Rritja në **zonën e Euros** pritet të jetë kontribut i rritjes së kërkesës së brendshme, meqenëse ngadalësimi i përgjithshëm ka filluar të ketë ndikimin e tij mbi eksportet.

Rritja ekonomike po fiton terren të fortë në vendet e **Europës Qendrore dhe Lindore**, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së eksporteve të tyre drejt Bashkimit European. Hungaria, Polonia dhe Sllovenia parashikohet të ruajnë një rritje vjetore mbi 4 për qind, si për vitin 2000 dhe për dy vitet e ardhshme. Nga ana tjetër, edhe ekonomitë e Rumanisë dhe të Republikës Çeke, pas rënies së shënuar gjatë vitit të mëparshëm, po stabilizohen. Efektet e përkeqësimit të mjedisit të jashtëm (për shkak të krizës ekonomike të Rusisë dhe të krizës kosovare) po eliminohen, duke krijuar kushte më të favorshme për ekonomitë e tjera të këtij blloku.

Me nismën dhe pjesëmarrjen e Bankës Qendrore Europiane, autoritetet monetare të SHBA-së, Japonisë, Britanisë së Madhe dhe të Kanadasë ndërmorën, në 22 shtator 2000, një veprim të bashkërenduar ndërhyrjeje në tregjet valutore botërore, në reagim të një shqetësimi të përbashkët lidhur me ndikimin e lëvizjeve të fundit, të kursit të këmbimit të euro-s në ekonominë botërore. Arsyeja ishte se në 20 shtator, euro ra në raportin më të ulët ndaj dollarit amerikan, në 0.848 USD për euro, niveli më i ulët historik që nga lindja e monedhës së re. Ky nivel këmbimi, konsiderohet si jokonsistent me parimet bazë ekonomike, e për rrjedhojë, implikimet e tij për ekonominë botërore mund të ishin të rëndësishme. Rezultati i ndërhyrjes ishte një ndalim i rënies së mëtejshme të euro-s dhe stabilizim i kursit të këmbimit gjatë muajit tetor, në 0.87 USD.

Në reagim të parashikimeve pozitive të rritjes ekonomike në zonën e euro-s dhe të një rënieje të ekonomisë së vendeve të tjera, euro filloi të fitojë terren, veçanërisht ndaj dollarit amerikan dhe jenit japonez. Megjithatë, në fund të muajit dhjetor ajo qëndroi rreth 5.5 për qind nën nivelin e fillimit të vitit 2000, ndërsa në raport me jenin qëndroi rreth 6 për qind mbi nivelin e shënuar në fillim të vitit 2000.

Tabela 1. PBB, rritja reale në përqindje.


Vendet	1995	1996	1997	1998	1999	2000*
SHBA	2.7	3.6	4.5	4.4	4.3	5.0
Japoni	1.5	5.0	1.6	-2.5	0.2	1.5
Bashkimi European	2.4	1.7	2.5	2.7	2.5	3.3
Zona e Euro-s	2.3	1.5	2.3	2.8	2.5	3.4
Vendet e Marrëveshjes Europiane	5.7	3.6	3.2	2.5	1.8	4.6
Bullgaria	2.9	-10.1	-6.9	3.4	2.4	5.0
Rep. Çeke	6.4	3.9	1.0	-2.3	-0.2	2.8
Estonia	4.3	3.9	10.6	4.0	-1.1	6.3
Hungaria	1.5	1.3	4.6	5.1	4.5	5.3
Letonia	-0.8	3.3	8.6	3.6	-1.4	5.5
Lituania	3.3	4.7	7.3	5.1	-4.1	2.7
Polonia	7.0	6.0	6.8	4.8	4.1	4.1
Rumania	7.1	3.9	-6.1	-5.4	-3.2	2.0
Sllovakia	6.9	6.6	6.5	4.4	1.9	2.2
Sllovenia	4.1	3.5	4.6	4	4.9	4.7

*Vlerësim i FMN-së, mars 2001.

Burimi: World Economic Outlook, IMF.

Box 1. Euro – dy vjet nga lindja e saj.

Që nga lindja e saj, euro ka humbur gati 25 për qind të vlerës në raport me dollarin amerikan. Argumenti kryesor që përdoret për të shpjeguar këtë rënie është vetë momenti i shfaqjes së euro-s, që sipas disa analistëve konsiderohet i papërshtatshëm. Megjithatë ekonomia europiane është rritur me një ritëm prej 2 për qind në vit që nga viti 1998, ekonomia amerikane ka shënuar rritjen më të lartë, me rreth 4 për qind (duke arritur pikun në qershor 2000 me 6.1 për qind) pa njohur presione inflacioniste. Kjo mrekulli e ekonomisë amerikane i dedikohet zhvillimit të ekonomisë së re, investimeve të ndjeshme në ICT (industritë e informacionit dhe telekomunikacionit) dhe rritjes, për rrjedhojë, të produktivitetit. Mungesa e rezultateve të reformave strukturore të tregut të punës në Eurozonë, qëndron në thelb të skepticizmit të qëndrimit negativ të tregut ndaj monedhës së re.



Grafiku 1. Kursi i këmbimit Euro / USD (janar 2000 - dhjetor 2000).

Arritjet impresionuese të ekonomisë amerikane, krijuan një treg mjaft tërheqës për investimet nga vendet e tjera (Europa dhe Japonia). Për herë të parë në histori, investimet e huaja direkte (që arritën kulmin në tremujorin e tretë të vitit 1999 me 198 miliardë dollarë, duke rënë më pas në 76 miliardë dollarë) u bënë burimi kryesor i financimit të deficitit të llogarisë korente. Hyrjet e mëdha të kapitaleve u regjistruan dhe në investimet portofol, domethënë, në letrat me vlerë të borxhit dhe të pasurisë. Investimet në portofol arritën, gjithashtu, kulmin në muajin qershor, me 270 miliardë dollarë.

Ekonomistët besojnë se ky kontrast në gjendjen e llogarisë kapitale qëndron në bazë të ekuacionit të kursit të këmbimit Euro/USD.

Perspektivat, për periudhën në vazhdim, duket se do të flasin në favor të Euro-s. Financimi i deficitit të llogarisë korente prej 400 miliardë dollarësh, duke marrë parasysh raportet e IHD-ve dhe të investimeve portofol, mendohet se do të krijojë terren për një humbje të vlerës së dollarit. Kjo, e parë dhe në kontekstin e rënies që pritet të shënojë ekonomia amerikane në vitin në vazhdim dhe të ngushtimit të 'spread'-it të normave të interesave.

Në janar të vitit 2002, monedha europiane bëhet realitet për konsumatorët. Nga kjo datë, në qarkullim do të dalë euro. Në kohën që do të ndodhë kalimi në monedhën e re, njerëzit që do të ndikohen, do t'i ndjejnë kostot në mënyrë të qartë dhe kjo është faza në të cilën po hyn ky proces.

Burimi : Forecast 2001, the new euro-economy, Rabobank.

1.1.2. ZHVILLIMET NË TREGTINË NDËRKOMBËTARE DHE ÇMIMET E MALLRAVE

Volumi i tregtisë botërore¹ (i mallrave dhe shërbimeve) pritet të shënojë një rritje prej 10 për qind, dy herë më të lartë se rritja e shënuar gjatë vitit 1999. Rritjen më të madhe pritet ta shënojë importet, me 10.3 për qind, ndërsa eksportet me 9.9 për qind. Si në importe dhe në eksporte, rritja më e lartë do të shënohet në ekonomitë e vendeve në tranzicion, me 12.4 për qind dhe 10.1 për qind, respektivisht.

Ndërkohë, çmimet e mallrave në tregjet botërore, me përjashtim të mallrave ushqimorë, kanë shënuar një rritje të ndjeshme. Rritja më e spikatur i përket çmimit të produkteve energjitike në tërësi (me 54.1 për qind, kundrejt vitit 1999) dhe naftës, në veçanti, me 62.7 për qind. Çmimi i naftës arriti kulmin e tij gjatë muajit tetor (me 37 dollarë për barrelë), niveli më i lartë i shënuar që nga fillimi i viteve '90-të, ndërsa, në muajin dhjetor, shënoi rënien më të ndjeshme, duke arritur në çmimin mesatar mujor prej 29.4 euro për barrelë.


**Tabela 2. Çmimet e mallrave primarë.
(në USD, % e ndryshimit kundrejt vitit të mëparshëm).**

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Mallrat ushqimorë	14.0	7.2	7.4	-5.6	-14.5	-11.7	-7.2
Materialet bazë	11.4	9.7	-4.8	-2.1	-14.8	-4.0	7.3
nga të cilat							
produktet jobujqësore	9.6	4.4	-1.2	-5.9	-14.3	-6.3	4.1
Mineralet dhe metalet	14.5	18.0	-10.0	3.7	-15.4	-0.8	11.5
Produktet energjitike	-5.1	8.6	16.4	-6.7	-28.4	25.0	54.1
nga të cilat							
Nafta e papërpunuar	-7.1	7.8	21.1	-7.5	-33.4	40.0	62.7
Mallrat primarë							
Totali, përjashto lëndët djegëse	12.3	8.9	-0.8	-3.4	-14.7	-6.7	3.7
Çmimi naftës në USD/Barrelë	15.8	17.1	20.7	19.1	12.7	17.8	29.0

¹ International Monetary Fund "World Economic Outlook", October 2000.

Box 2. Pse paraqet shqetësim rritja e çmimit të naftës?

Së pari, ekonomitë e shumë vendeve në zhvillim do të ndikohen seriozisht. Së dyti, rritja mund të vazhdojë dhe në të ardhmen për shkak të ofertës apo të rritjes së kërkesës. Së treti, një kombinim i çmimit të lartë dhe i dobësimit të tregut të letrave me vlerë të pronësisë, mund të bëjë që investorët privatë në ekonomitë e zhvilluara të shkurtojnë investimet dhe të rrisin kursimet, duke çuar në një rënie ekonomike. Sipas një studimi të fundit, nëse çmimi mesatar deri në pranverën e vitit të ardhshëm, do të qëndronte në 32 dollarë për barrelë dhe do të ulej në 27 dollarë për barrelë në vitin 2001 (ashtu siç është parashikuar) ndikimet e tij do të ishin:



Grafiku 2. Çmimi për një barrelë (në Euro) në fund të periudhës.

Humbjet e të ardhurave në vendet e OECD-së do të arrinin në 0.7 për qind të PBB-së; humbjet e ekonomisë amerikane do të ishin në 0.6 për qind të PBB-së; për Japoninë në 1 për qind dhe për zonën e euro-s në 0.8 për qind. Përfitimet për Britaninë e Madhe do të ishin 0.4 për qind dhe për Kanadanë 1.5 për qind (pasi janë eksportuese neto të energjisë).

Shumica e vendeve në zhvillim, që janë importuese neto të energjisë do të pësonin humbje më të mëdha (për disa vende të Europës Qendrore humbjet llogariten në mbi 1 për qind të PBB-së. Ndërsa, vendet që do të përfitonin përfshijnë prodhuesit dhe eksportuesit e naftës (Rusia, Venezuela, Meksika, Nigeria etj.). Ajo që evidentohet nga këto zhvillime në çmimet e naftës është se ekonomitë e industrializuara, gjatë katër dekadave të fundit, janë bërë më pak të ndjeshme ndaj luhatjeve në tregun e produkteve energjitike se sa në periudhën e krizës energjitike të viteve '70. Kjo është rrjedhojë e faktit se importet e naftës për njësi të PBB-së janë përgjysmuar dhe inflacioni është nën kontrollin e autoriteteve. Po kështu, në ekonomitë e vendeve të industrializuara kanë ndodhur ndryshime strukturore, të cilat e kanë ulur varësinë nga burimet energjitike.

(Burimi: Marrë me shkurtime nga Martin Wolf, "The new economy gets a shock", Financial Times October 18, 2000.

Zhvillimet e vërejtura në ekonominë botërore, sidomos në vendet partnere, pavarësisht se ekonomia shqiptare nuk ka shkallë të lartë integrimi, kanë ndikuar në disa drejtime. Niveli i qëndrueshëm dhe i stabilizuar i çmimeve në vendet e BE-së, ecuria e euro-s kundrejt dollarit amerikan si dhe çmimet e energjisë vlerësohet të kenë ndikuar në importimin e një niveli të ulët inflacioni dhe, nga ana tjetër, kanë shkaktuar rritjen e çmimeve të energjisë në vend të cilat kanë çuar në rritjen e kostos së prodhimit.

1.2. EKONOMIA KOMBËTARE

Viti 2000 përkoi me një gjallërim të mëtijshëm të aktivitetit ekonomik në tërësi. Megjithatë vendi u përball me një krizë të prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike kryesisht në muajt e fundit të vitit 2000, përsëri vlerësohet se rritja e prodhimit ishte e konsiderueshme, përtej nivelit të programuar në fillim të vitit prej 7 për qind. Sipas vlerësimeve më të fundit rritja është veçanërisht e fortë në sektorin e ndërtimit dhe atë të transportit, ndërkohë që investimet më të larta në makineri dhe pajisje si dhe importet e rritura të plehrave kimike dhe pesticideve kanë bërë që prodhimi bujqësor të rritet më shpejt se vitin e kaluar. Edhe sektori privat i industrisë vlerësohet të ketë regjistruar një periudhë gjallërimi të mëtijshëm, gjë që reflektohet në rritjen relativisht të konsiderueshme të kredisë gjatë vitit 2000, si dhe në rritjen e importeve në zërin makineri e pajisje. Megjithatë në total, prodhimi industrial vazhdon të pasqyrojë paqartësinë që karakterizon sektorin shtetëror të industrisë, veçanërisht sektorin minerar.

Tabela 3. Tregues ekonomikë të përgjithshëm.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Popullsia (000)	3202.0	3248.8	3283.0	3324.3	3354.3	3373.4	3401.1	3428.3
Përqindja e rritjes së popullsisë	1.1	1.5	1.1	1.3	0.9	0.6	0.8	0.8
Numri i të punësuarve (000)	1046.0	1161.0	1138.0	1116.0	1107.0	1103.0	1081.0	1064.0
PBB (çmime të vitit 1990, milionë lekë)	12309.0	13331.0	15107.0	16478.0	15325.0	16556.0	17764.6	19150.2
Rritja në % e PBB-së (çmime të vitit 1990)	9.6	8.3	13.3	9.1	-7.0	8.0	7.3	7.8
PBB (çmime korente, milionë lekë)	125340.0	187891.0	224745.0	280998.0	341716.0	460631.0	506205.0	539210.0
PBB (çmime korente, milionë USD)	1221.6	1984.5	2422.1	2689.0	2294.5	3057.8	3676.4	3752.1
PBB (për frymë në USD)	381.5	610.8	737.8	808.9	684.0	906.5	1080.9	1094.4
Përqindja e papunësisë	22.3	18.4	13.1	12.4	14.9	17.8	18.0	16.9
Përqindja e inflacionit (v/v)	30.9	15.8	6.0	17.4	42.1	8.7	-1.0	4.2
Borxhi brendshëm (në % të PBB-së)			25.1	30.7	35.8	32.9	36.4	41.5
Llog. korente (në % të PBB-së) 1/	-28.8	-14.3	-9.7	-11.5	-14.4	-8.2	-7.2	-7.0
Borxhi jashtëm (në % të PBB-së)		52.5	30.4	29.2	35.6	26.5	25.8	29.2
Kursi mesatar i këmbimit	102.6	94.7	92.8	104.5	148.9	150.6	137.7	143.7

1/ Llogaria korente përjashtuar të ardhurat neto nga faktorët e shërbimeve dhe transfertat shtetërore.


Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN-së.

Problemet që po karakterizojnë sektorin minerar të vendit kanë ndikuar dhe në një pakësim të eksporteve gjatë vitit 2000, i cili së bashku me rritjen prej 14 për qind të importeve kanë çuar në përkeqësimin e mëtijshëm të deficitit tregtar² prej rreth 3,7 pikë përqindjeje të PBB-së. Megjithatë pozicioni i bilancit të pagesave vlerësohet të jetë në një nivel të përshtatshëm falë hyrjeve më të larta nga privatizimi dhe turizmi. Nuk duhet lënë pa përmendur se, edhe gjatë vitit 2000, transfertat private ishin përsëri të larta duke u konsoliduar tashmë si një nga zërat me peshën më të madhe balancuese të deficitit tregtar.

² E shprehur në terma të dollarit amerikan. Kjo është e vlefshme edhe për eksportin dhe importin.

1.2.1. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO.

Në vlerësimet më të fundit, të bëra së bashku me FMN-në, gjykohet që në vitin 2000 rritja reale ekonomike të jetë në nivelin 7.8 për qind. Ashtu si dhe vitet e mëparshme edhe gjatë vitit të kaluar degët kryesore që kanë kontribuar në rritjen e prodhimit, vlerësohet të jenë ndërtimi, transporti dhe bujqësia. Duhet theksuar se viti 2000 ishte i mbarë edhe për sektorin privat të ekonomisë sidomos për atë industrial, duke përfshirë përpunimin e metaleve, përpunimin e ushqimeve etj..



Grafiku 3. Rritja reale në % e prodhimit të brendshëm bruto.

Prodhimi bujqësor gjatë vitit 2000³ ka patur një ritëm rritjeje më të lartë se një vit më parë. Megjithë vështirësitë e shkaktuara nga thatësira e madhe dhe e tejzgjatur, viti 2000 mund të quhet viti i arritjeve pozitive në fushën e bujqësisë. Kështu, prodhimi bujqësor në vlerë arriti në 109 miliardë lekë (vlerësuar me çmimet e vitit 1994). Në krahasim me vitin 1999 rezulton një rritje prej 6.8 për qind, duke kontribuar me mbi 55 për qind në rritjen e PBB-së. Në totalin e prodhimit bujqësor kontributi kryesor vazhdon të jepet nga blegtoria, rreth 48.5 për qind, pastaj nga prodhimi i bimëve të arave dhe pemëtaria, përkatësisht me 44.5 dhe 7 për qind. Ky ndryshim në strukturën e prodhimit bujqësor në vlerë ka filluar që në vitin 1994 dhe janë ruajtur gjithnjë të njëjtat raporte.

Gjendja më e mirë e bujqësisë shqiptare reflektohet në praninë e prodhimit vendas në treg në sasi më të madhe, cilësi më të lartë dhe çmime më të ulëta për konsumatorin, gjë që u pasqyrua në reduktimin e ndjeshëm të indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore sidomos gjatë periudhës maj–korrik 2000.

Megjithë arritjet pozitive të theksuara më sipër, problem kryesor për bujqësinë shqiptare vazhdon të mbetet ekzistenca tregjeve bujqësore pak të zhvilluara, mungesa e informacionit për tregun dhe fakti që fermerët shqiptarë, në përgjithësi, prodhojnë për vetkonsum dhe jo për treg.

³ Të dhënat për vitin 2000 janë marrë nga raportimet e Ministrisë së Bujqësisë.

Fillimi i mbushjes së tregut me prodhime vendase vihet re kryesisht në prodhimet blegtorale si rezultat i shtimit të numrit të krerëve të blegtorisë. Në kushtet e rritjes së prodhimit bujqësor si dhe të rritjes së kërkesave të konsumatorëve në treg, rëndësi mjaft të madhe merr zhvillimi i industrisë përpunuese agrourbushqimore.

Të dhënat më të fundit mbi **prodhimin mall të shitur**, dëshmojnë për një rënie të aktivitetit industrial në sektorin shtetëror⁴. Në total, prodhimi mall i shitur për vitin 2000, paraqitet rreth 10 për qind më i ulët se viti i kaluar. I ndihmuar nga zhvillimet në çmimet e tregut, prodhimi i industrisë së degës së naftës paraqitet 11.2 për qind më lart se niveli i vitit 1999, ndërsa industria e minierave dhe industria përpunuese paraqiten me nivele më të ulëta, veçanërisht në industrinë përpunuese në tërësi, ku treguesi i prodhimit paraqitet në gati gjysmën e nivelit të shënuar një vit më parë. Në sektorin minerar është përfshirë vetëm prodhimi nga industritë e kromit dhe qymyreve e i mineraleve të tjera, prodhimi i të cilave është gati përgjysmuar përkundrejt vitit të kaluar.

Megjithatë, kjo analizë duhet parë në kontekstin e ndryshimeve strukturore, që kanë vazhduar të ndodhin përgjatë vitit në analizë. Ndërmarrje të rëndësishme shtetërore janë privatizuar, e për rrjedhojë nuk përfshihen në sistemin e raportimit statistikor të ministrisë. Ndërmarrje të tilla të rëndësishme ishin industria e çimentos dhe shumë aktivitete të industrisë së lehtë (birra, kantinat e verës etj.) telekomunikacioneve (me privatizimin e AMC-së) etj..

Mbi këto argumente, është plotësisht e pritshme që aktiviteti prodhues i sektorit privat të ketë pësuar rritje. Megjithatë, përsëri gjykimin tonë për këto zhvillime vazhdojmë ta bazojmë në disa tregues të tërthortë, të raportuar nga INSTAT, të tillë si rritja e konsumit të brendshëm, investimet (importet e makineri e pajisjeve), konsumi i çimentos etj.. Ndër faktorët me ndikime negative në zhvillimet e sektorit të prodhimit⁵ mund të përmendet kriza e rëndë energjitike në vend, e cila u shoqërua, përveç të tjerash, me ndërprerje të shpeshta dhe për një kohë të gjatë të furnizimit me energji të subjekteve ekonomike. Kjo, e shoqëruar dhe me rritjen e çmimeve të karburanteve në tregun ndërkombëtar, ka dhënë ndikimin e saj negativ në ecurinë e prodhimit si dhe në rritjen e kostos së produkteve. Megjithatë, një vlerësim i saktë i ndikimeve të kësaj krize në prodhim dhe në kosto, tani për tani është i pamundur për shkak të informacionit të paplotë nga sektori privat.

Aktiviteti investues i firmave private në teknologji dhe aktive të qëndrueshme, duket se ka pësuar një rritje të ndjeshme. Importet e makineri e pajisjeve, gjatë vitit 2000, zunë 13.8 për qind të totalit të importeve, duke arritur shifrën prej rreth 149 milionë dollarësh. Shifra e mësipërme përfaqëson një nivel prej rreth 37 për qind më të lartë, në terma realë, se importet e makinerive e pajisjeve të regjistruara një vit më parë. Po kështu dhe zërat e tjerë të importit duket se janë dominuar nga mallrat investues, të tillë si produktet minerale, tekstilet dhe artikuj të tyre, të cilët përdoren për përpunim nga industria e vendit.

⁴ Të dhënat janë marrë nga raportimet statistikore të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

⁵ Në një vlerësim të Bankës së Shqipërisë për ndikimin e krizës energjitike në ekonominë e vendit, të bërë gjatë muajit nëntor 2000, vlerësohet se humbja e të ardhurave të ekonomisë për shkak të rritjes së çmimit të produkteve energjitike arrin në 0.3 për qind të PBB-së.

Edhe ky fakt, evidentohet nga rritja e aktivitetit të rieksporëve në krahasim me vitin e kaluar. Kështu, produktet tipike të kësaj kategorie, tekstilet dhe artikujt prej tekstili, paraqesin një rritje të eksportëve prej mbi 30 për qind kundrejt vitit 1999. Këto të dhëna, mund të konsiderohen si evidenca të faktit se aktiviteti ekonomik nga sektori privat është gjallëruar përkundrejt vitit të mëparshëm.

1.2.2. KURSIMET DHE INVESTIMET.

Krahasuar me një vit më parë kur kursimet e brendshme ishin rreth 9.6 për qind të PBB-së, në fund të vitit 2000 ato vlerësohen të jenë rritur në 12 për qind të PBB-së. Kontribuesi kryesor në rritjen e nivelit të kursimeve i përket reduktimit të deficitit buxhetor gjë që është pasqyruar në një përmirësim të kursimeve publike me rreth 3 pikë përqindjeje. Megjithatë, bilanci i përgjithshëm i kursimeve publike mbeti përsëri negativ në nivelin prej 2,6 për qind të PBB-së.

Të rejat e pakta në zhvillimin e tregjeve, në ndërmjetësimin financiar etj., kanë bërë që përsëri të mbizotëronte si alternativë investimi e individëve, depozitimi në banka (më shumë në formën e depozitave në valutë). Sipas të dhënave paraprake në fund të vitit 2000, totali i depozitave të rezidentëve arriti në 228.8 miliardë lekë ose pati një rritje vjetore prej 8.2 për qind. Kështu, gjendja e depozitave gjithsej është rreth 42.6 për qind të PBB-së, nga 40.4 për qind të PBB-së që ishte vitin e kaluar.

Gjatë vitit 2000, krahasuar me një vit më parë, investimet gjithsej, pësuan një rritje prej 2.2 pikë përqindjeje, duke arritur në 19 për qind të PBB-së. Duhet thënë se si investimet private ashtu dhe ato publike u rritën me rreth 1 pikë përqindjeje.

1.2.3. TREGU I PUNËS DHE TË ARDHURAT.

1.2.3.1. TREGU I PUNËS.

Edhe gjatë vitit 2000, tregu i punës vazhdoi të karakterizohej nga bashkëjetesa e tregut formal me atë joformal, i cili për nga madhësia gjykohet të jetë ende i konsiderueshëm. Nga ana tjetër, ashtu si dhe gjatë viteve të kaluara, si rezultat i privatizimit, konsolidimit të sektorit privat, emigracionit etj., përsëri kanë vazhduar ndryshimet në strukturën e tregut të punës⁶.

Megjithë zhvillimet e ndodhura në dekadën e fundit, Shqipëria ende klasifikohet si një nga vendet me popullsi në moshë të re. Vlerësimet më të detajuara për strukturën moshore të popullsisë së vendit, tregojnë se rreth 40 për qind e popullsisë, si për meshkujt edhe për femrat, i përket grupmoshës nga 0 deri në 19 vjeç, 50 për qind e saj i përket grupmoshës nga 20 deri në 64 vjeç dhe vetëm 10 për qind e popullsisë vlerësohet të jetë mbi 65 vjeç. Kjo shpërndarje e popullsisë sipas grupmoshave, përputhet me piramidën e rregullt të popullsisë, e cila nuk ka pësuar ndryshime të dukshme gjatë dy viteve të fundit. Deformimin më të dukshëm të saj ajo e pësoi gjatë periudhës 1993-1995, në grupmoshën 20-30 vjeç, kryesisht për meshkujt, fakt që u shpjegua me përmasat e larta të emigracionit në këtë periudhë⁷.

Edhe viti 1997, ndikoi disi formën e rregullt të piramidës së popullsisë, sepse fenomenet jo të zakonshme, që shoqëruan krizën që kaloi vendi në pranverën e këtij viti, përkeqësuan strukturën e popullsisë, duke ulur peshën e saj, kryesisht, në grupmoshat e reja. Në njëfarë mase, fenomeni i emigracionit si edhe pasojat e krizës së pranverës së vitit 1997, trashëgohen edhe sot, megjithëse jo në të njëjtat përmasa. Kështu, nëse do t'i referohemi projeksioneve të kryera për popullsinë për vitin 2000, grupmosha 15–19 vjeç, ka shënuar rritje të konsiderueshme, krahasuar me vitin 1998. Kjo grupmoshë e popullsisë përbën edhe atë pjesë të rëndësishme të saj, që vlerësohet të jetë më realja dhe më potencialja, për gjykimin dhe për tendencat e ardhme të tregut të punës.

1.2.3.2. FORCA E PUNËS.

Oferta në tregun e punës, pra forca e punës gjithsej, shënoi rënie këtë fundviti krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në masë absolute kjo rënie shënoi shifrën 40 mijë persona, gjë që do të thotë se në fund të vitit 2000 oferta për punë ra në masën rreth 3.03 për qind krahasuar me fundin e vitit 1999. Megjithë konsideratat pozitive për një forcë pune në rritje, nisur nga parashikimet optimiste në strukturën moshore të popullsisë për vitin 2000, faktet dëshmojnë të kundërtën: jo vetëm ka një ulje të forcës e punës, por për më tepër kjo ulje përbën edhe tendencën përgjatë gjithë vitit 2000.

⁶ Burimi i të dhënave INSTAT.

⁷ Femrat dhe meshkujt në Shqipëri faqe 4, 1998; vjetari i treguesve socialë, faqe 6 tabela 2, botim i INSTAT.

1.2.3.3. PUNËSIMI.

Në fund të vitit 2000 numri i të punësuarve gjithsej ishte rreth 1.1 milionë persona. Gjatë vitit pati ecuri pothuajse konstante, me rënie dhe me ngritje të lehta për treguesit e të punësuarve gjithsej, duke arritur nivelin më të ulët në tremujorin e katërt. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kjo shifër ra me rreth 17 mijë vetë ose 1.5 për qind. Rënia më e madhe e numrit të të punësuarve u evidentua në sektorin shtetëror me 15 mijë vetë. Ndërkohë, punësimi në sektorin privat jobujqësor është rritur nga një tremujor në tjetrin gjatë vitit 2000, por është reduktuar me 2 mijë vetë krahasuar me një vit më parë. Ndërsa, sektori privat bujqësor paraqitet në gjendje të pandryshuar për gjithë vitin 2000, po ashtu krahasuar edhe me vitin 1999.

Në fakt, ulja e konsiderueshme e të punësuarve në sektorin shtetëror këtë vit pritej të kishte një kompensim më të drejtë, apo një shpërndarje që do të çonte në rritjen e të punësuarve në sektorët privatë bujqësorë dhe jobujqësorë. Faktet dhe shifrat flasin për të kundërtën. Në tërësi, gjykohet që numri i të punësuarve është reduktuar si pasojë e vazhimit të reformave në administratën shtetërore, e privatizimit dhe ndoshta edhe për shkak të tkurrjes së aktivitetit privat, në tremujorin e katërt të vitit, si pasojë e krizës energjitike në vend.

1.2.3.4. PAPUNËSIA.

Shkalla e papunësisë⁸ në fund të vitit arriti nivelin 16.9 për qind, vetëm 1.1 pikë përqindjeje më të ulët se viti i mëparshëm. Interesant është fakti se numri i të papunëve ishte më i lartë tek meshkujt se sa tek femrat, fenomen që u shfaq në mënyrë më evidente në pjesën e dytë të vitit 2000 (52–54 për qind i përket meshkujve, ndërkohë që pjesa tjetër i takon femrave të papuna). Shkalla e papunësisë, si sintezë e situatës në tregun shqiptar të punës, ka njohur një tendencë rënëse të vazhdueshme gjatë gjithë vitit 2000.

Siç vërehet situata e treguesve të punësimit dhe të papunësisë lejon shpesh kryerjen e supozimeve apo të hipotezave, duke mos mundësuar dhe lehtësuar studimin dhe analizën e qartë nëpërmjet shifrave. Vetë prirjet demografike pozitive në drejtim të rritjes së ofertës në tregun e punës, dhe ulja e forcës së punës gjatë vitit 2000, janë dy tendenca të kundërta, që kërkojnë një shpjegim sa më të qartë nga organet përkatëse të prodhimit dhe të publikimit të këtyre shifrave.

Ndoshta, vlerësimi i tregut joformal të punës dhe i emigracionit duhet të mbeten si prioritet në punën e këtyre institucioneve. Kjo do t'i shërbente drejtpërdrejt vlerësimit real të tregut të punës në Shqipëri si edhe do të ndihmonte me të dhëna vlerësimet e tërthorta në studimet me natyrë ekonomiko-sociale.

⁸ Rreth 23 mijë të papunë më pak në fund të vitit 2000, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rreth dy mijë persona më pak që përfitojnë pagesë papunësie për të njëjtat periudha reference.

Tabela 4. Treguesit e punësimit dhe të papunësisë.


	Viti 1999	Trem.I Viti 2000	Trem.II Viti 2000	Trem.III Viti 2000	Trem.IV Viti 2000
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1321	1306	1293	1289	1281
A) Të punësuar gjithsej	1081	1065	1065	1066	1064
a) në sektorin shtetëror	209	201	201	198	194
b) në sektorin privat jobujqësor	111	103	103	107	109
c) në sektorin privat bujqësor	761	761	761	761	761
B) Papunësia					
të papunë gjithsej	240	241	228	219.2	217.2
përfitojnë pagesë papunësie	23	21	22	21.9	21.3
Shkalla e papunësisë (në %)	18.0	18.4	17.6	17.01	16.95

Box 3. Situata e tregut të punës në disa vende të Europës Lindore.

Pavarësisht nga rimëkëmbja e dukshme e ekonomive në tranzicion, punësimi ka vazhduar të bjerë në shumë vende gjatë gjysmës së parë të vitit 2000, sidomos në Europën Lindore. Gjithashtu, duhet thënë se shifrat e papunësisë mbetën të larta gjatë tetë muajve të parë të vitit 2000. Arsyeja kryesore për ekzistencën e këtyre shifrave të papunësisë, gjatë vitit 2000, duket të ketë qenë thellimi i procesit të ristrukturimit të ndërmarrjeve, i cili shpeshherë shoqërohet me shkurtime të vendeve të punës. Arsye të tjera për kërkesën e ulët për krahë pune në shumë ekonomi në tranzicion, janë kufijtë e gjerë të kapacitetit të tepërt të kombinuar me fitimet nga produktiviteti i punës.

Në fund të muajit gusht 2000, numri i përgjithshëm i personave të regjistruar si të papunë në ekonominë në tranzicion pranë Komisionit Ekonomik të Europës ishte 17 milionë (7.6 milionë në Europën Lindore, 350.000 në shtetet Balltike dhe 9.1 milionë në vendet e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura). Ulja e totalit të të papunëve që nga gushti i vitit 1999 (me rreth 5 për qind) reflekton kryesisht përmirësimin në Rusi, pasi numri i të papunëve u rrit me 7 për qind në Europën Lindore dhe me më shumë se 14 për qind në shtetet Balltike.

Në shumë nga vendet e Europës Lindore papunësia vazhdoi të rritej gjatë tetë muajve të parë të vitit 2000 dhe gjatë dimrit pesë vende (Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Rumania dhe Sllovakia) raportuan shifrat më të larta të papunësisë që prej fillimit të tranzicionit në vitin 1989. Gjatë pranverës dhe verës u vërejtën përmirësime të vogla në disa vende, ndërkohë që në disa të tjera situata vazhdoi të përkeqësohej.

**Grafiku 4. Përqindja e papunësisë (gusht 2000).**

1.2.3.5. TË ARDHURAT.

Treguesi më domethënës i nivelit të jetesës së popullsisë janë të ardhurat. Viti 2000 krahasuar me vitin 1999 shënoi rritje të lehta të këtij treguesi. Kështu, paga mesatare mujore në sektorin shtetëror, në tremujorin e katërt të vitit 2000, ishte rreth 14,891 mijë lekë. Ajo u rrit në masë absolute mesatarisht me 2384 lekë ose me rreth 19.06 për qind. Ndërkohë, paga minimale e miratuar, në fund të vitit 2000, ishte shtatë mijë lekë. Krahasuar me një vit më parë ajo u rrit me afro 1200 lekë ose me rreth 20.7 për qind. Përgjatë tremujorëve të vitit 2000, këta tregues pësuan rritje të lehta ndërkohë që, për periudha të veçanta nuk njohën ndryshime. Do të theksojmë se pagesa e papunësisë dhe e ardhura minimale për familje me katër persona nuk kanë ndryshuar edhe për këtë vit, madje ndryshime nuk vërehen që prej fillimit të vitit 1999.

Sidoqoftë, ndryshimet e vërejtura, sado të vogla që ishin, morën parasysh zhvillimet e mëparshme në inflacion, parashikimet e tij për vitin 2000 si edhe politikën e të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore për vitin e kaluar.

Mund të vlerësohet se ndryshimet në paga sipas sektorëve, tregojnë se sektori privat konkurren në mënyrë të ndjeshme sektorin shtetëror. Kjo bën që nga njëra anë shpesh të punësuarit në sektorin shtetëror të jenë të punësuar edhe në atë privat, në të shumtën e rasteve, duke rritur numrin e të punësuarve në tregun joformal të punës. Nga ana tjetër, ky grup përbën kontigjentin e të pamotivuarve për punë nga pikëpamja financiare.

Po kështu diferenca vihen re edhe sipas aktiviteteve ekonomike të ushtruara. Në sektorë të rëndësishëm dhe të vështirë pagat janë ndjeshëm më të larta se në sektorë të tjerë. Edhe vendndodhja gjeografike është një faktor, që ndikon në përcaktimin e diferencave në paga.

Box 4. Vlerësimi i varfërisë në Shqipëri.

Varfëria në Shqipëri është një fenomen shumëdimensional, i cili shprehet në nivelin e ulët të të ardhurave dhe të konsumit, në nivelin e ulët arsimor të popullsisë, në nivelet e larta të papunësisë etj..

Për matjen e varfërisë njihen tregues të ndryshëm si: niveli i ulët i PBB-së për frymë, jetëgjatësia mesatare, cilësia e shërbimit shëndetësor dhe mundësia e përdorimit të këtij shërbimi, niveli i ulët arsimor, papunësia e lartë etj..

Vlerësimi i varfërisë kërkon disponimin e një numri të konsiderueshëm të dhënash, mungesa e të cilave e vështirëson mjaft dhënien e një përgjigjeje të saktë lidhur me vlerësimin e nivelit të varfërisë në Shqipëri.

Koncepti relativ i varfërisë i përdorur nga INSTAT-i jep të dhëna më tepër lidhur me pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave se sa lidhur me varfërinë⁹. Vendet europiane, zakonisht, përdorin si masë relative të varfërisë 50 për qind të medianës së të ardhurave për frymë ose për njësi konsumi, ose masën që i takon kuartilit të parë, të këtyre të ardhurave. INSTAT deri tani ka përdorur këtë koncept për të bërë vlerësime lidhur me nivelin e varfërisë.

Për vitin 1999, PBB për frymë në Shqipëri ishte rreth 1129 USD, ndërsa në vendet e rajonit varion nga 1540 USD (Bullgaria) në 19710 USD (Italia).

Varfëria në Shqipëri është më tepër një fenomen rural, me rreth 90 për qind të të varfërve në fshat. Të varfërit e zonës rurale ndeshen pesë herë më shpesh në zonën veriore të vendit ku shumica e familjeve zotërojnë më pak se 0,5 ha tokë. Sipas të dhënave të vitit 1998, 27 për qind e familjeve të zonës rurale nuk shesin produkte në treg dhe vetëm 50 për qind përdorin makineri bujqësore.

Në vjetarin social të INSTAT-it raportohen tregues të varfërisë subjektive:

- ☞ rreth 27,3 për qind e familjeve nuk arrijnë të paguajnë faturat e energjisë elektrike dhe të ujit në shkallë vendi;
- ☞ shkalla e pajisjes me pajisje elektroshtëpiake e familjeve shqiptare është e ulët, kështu: rreth 45 për qind e familjeve, në zonat me më pak se 10000 banorë, nuk kanë televizor me ngjyra, ndërsa për qytetet me mbi 10000 banorë ky tregues është rreth 13 për qind; 40 për qind e familjeve në zonën rurale nuk disponojnë frigorifer dhe 87 për qind nuk disponojnë makinë larëse.

Treguesit e mësipërm paraqiten disi më të lartë për zonën urbane, por në shkallë vendi shkalla e pajisjes me pajisje me afat të gjatë përdorimi është e ulët.

- ☞ varfëria është më e ndjeshme në familjet me 5 apo më shumë fëmijë. Treguesit e varfërisë janë, gjithashtu, të korreluar edhe me gjininë e kryefamiljarit. Kështu, nga familjet, që nuk janë në gjendje të paguajnë faturat e ujit dhe të energjisë elektrike, rreth 28, 4 për qind drejtohen nga femra dhe rreth 27,2 për qind nga meshkuj;
- ☞ varfëria në Shqipëri është një fenomen, që ndeshet më shpesh në familjet ku kryefamiljari është i papunë, rreth 32 për qind të rasteve të familjeve, që nuk mund të përballojnë faturat e ujit dhe të energjisë elektrike;
- ☞ mundësia e përfitimit nga shërbimet shëndetsore është e kufizuar dhe mbi të gjitha shërbimi është i një cilësie të ulët. Shpenzimet buxhetore për shëndetin, në vitin 2000, arrinin në vetëm 2,2 për qind të PBB-së, shifër kjo që është nga më të ultat e rajonit. Niveli i vdekshmërisë foshnjore është shumë i lartë, rreth 40 për 1000 lindje të gjalla;


⁹ Të ardhurat medianë për njësi konsumi janë përdorur nga INSTAT për të llogaritur popullsinë apo familjet, që jetojnë nën një prag të caktuar të ardhurash dhe që mund të konsiderohen të varfra. Për njësinë e konsumit është përdorur shkalla e OCDE: në një familje personi i parë në moshë madhore konsiderohet një njësi konsumi, i dyti 0,7 dhe fëmija nën 14 vjeç 0,5 njësi konsumi.

- norma e regjistrimit në shkolla, gjatë periudhës 1990-1999, është ulur, veçanërisht për shkollat e mesme. Pjesa e shpenzimeve buxhetore për arsimin ka rënë nga 3,8 për qind, që ishte në vitin 1995 në 2,86 për qind e PBB-së, në vitin 2000. Shifra këto shumë më të ulta se sa ato të vendeve fqinje. Gjatë 10 viteve të fundit, rreth 3 për qind e fëmijëve kanë braktisur shkollën çdo vit;
- megjithëse niveli i elektrifikimit është i lartë në shkallë vendi, ka ndërprerje të vazhdueshme të furnizimit me energji, sidomos gjatë muajve të dimrit;
- përsa i përket mundësisë së përfitimit nga shërbimet jetësore (ujë i pijshëm, kanalizim i ujrave të zeza etj.) problemet aktuale janë shumë të mëdha. Vetëm 15 për qind e zonave rurale furnizohen me ujë të pijshëm nga tubacionet e rregullta.

Strategjia për reduktimin e varfërisë në Shqipëri duhet të përqëndrohet në një shpërndarje relativisht të barabartë të të mirave për gjithë popullatën, në mundësinë më të mirë që duhet të kenë të gjithë për përfitim nga shërbimet sociale, në institucionet shëndetësore dhe arsimore. Shqipëria, në kuadrin e Programit për Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë, ka ende shumë për të bërë, e rëndësishme është që puna për vënien në jetë të programit të jetë sa më efikase.

1.2.4. INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT DHE INFLACIONI.

Viti 2000, filloi në kushtet e një norme inflacioni negative dhe arriti në fund në nivelin 4.2 për qind. Në të vërtetë, megjithëse zhvillimet gjatë vitit 1999 ishin të jashtëzakonshme përse i takon rënies së inflacionit përtej çdo parashikimi, ato nuk patën ndonjë ndikim të veçantë në vendosjen e objektivit të inflacionit për fundvitin 2000. Më konkretisht, si objektiv final i politikës u vendos që norma e inflacionit (e matur si ndryshim dymbëdhjetëmujor) në fund të vitit 2000 të mos dilte jashtë intervalit 2 – 4 për qind. Në vendosjen e këtij objektiv (disa herë më i lartë se norma e verifikuar në fund të vitit 1999) Banka e Shqipërisë u mbështet në supozimin se inflacioni në vitin 1999, në masën më të madhe, ishte produkt¹⁰ i fenomenit *shock*, i cili më konkretisht u shfaq në formën e krizës në rajon (konflikti në Kosovë).



Grafiku 5. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (ndryshimi 12-mujor në përqindje).

Për shkak që ende të pastudjuara plotësisht¹¹ norma e inflacionit vazhdoi të jetë negative për gjatë gjithë vitit 2000, duke bërë të besoj se realizimi i objektivit do të ishte i vështirë, madje vihej në diskutim arritja e vlerës së poshtme të intervalit objektiv. Në të vërtetë kjo pritshmëri rezultoi e gabuar, sepse dy muajt e fundit (sidomos muaji dhjetor) ishin të mjaftueshëm për të përmbysur zhvillimet e mëparshme. Kështu, norma vjetore e inflacionit jo vetëm u rrit ndjeshëm, por tejkaloi me 0,2 pikë përqindjeje nivelin e sipërm të intervalit objektiv.

Edhe pse shmangia nga objektiv i ishte në masë të vogël, zhvillimet e këtij fundviti edhe një herë nxorën në pah disa të probleme, të cilat janë evidentuar dhe më parë nga ana e Bankës së Shqipërisë. Para se të ndalemi konkretisht në çdonjërin prej tyre, do të ishte me vend të theksonim se edhe gjatë vitit 2000, ekonomia shqiptare nuk arriti t'i shpëtojë ndikimit të faktorit *shock*. Duke filluar që nga muajt e verës u vu re një ngritje e fortë në çmimet e tregut të karburanteve, niveli i të cilave mbeti i lartë deri në fund të vitit.

¹⁰ Efektet e kësaj krize janë shpjeguar gjerësisht në të gjitha materialet e Bankës së Shqipërisë ashtu sikurse edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare.

¹¹ Këtu do të veçonim elemente të tilla, që kanë të bëjnë me sezonin, efektin e vonuar të krizës së lartpërmendur etj..

Më tej, sidomos në dy muajt e fundit (nëntor – dhjetor) ekonomia u përball me një tjetër krizë, atë energjitike (e cila vazhdon të jetë e pranishme dhe në fillim të vitit 2001). Ndërkohë që efekti i goditjes së parë, në njëfarë mënyre, ishte i drejtpërdrejtë dhe i matshëm (fatmirësisht apo çuditërisht çmimi i karburanteve nuk krijoi shqetësime në ekonomi) efekti i goditjes së dytë është vështirë të përcaktohet saktë, megjithatë mund të konsiderohet me të drejtë si një efekt *shock* i ofertës agregate.

Zhvillimet e fundvitit 2000, ripërsëritën, ndonëse këtë rradhë me intensitet më të lartë, zhvillimet e faktuara në çdo fundviti: rritjet spekulative të çmimeve para festave. Goditjet në fund të vitit tashmë po kthehen në traditë duke u shndërruar në një lloj rreziku të vazhdueshëm për efektivitetin e politikës monetare dhe arritjen e objektivit të inflacionit. Në të vërtetë, bëhet fjalë për një fenomen të çuditshëm, i cili gjithnjë e më shumë po merr formën e një ndikimi të sezonit. Festat e fundvitit mund të përbëjnë një shkak për rritjen e kërkesës agreeagte në muajin dhjetor. Në fakt, po të marrim parasysh ndryshimin e çmimeve të grupeve të IÇK-së, si një indikator të rritjes së kërkesës, vëmë re një rritje të fortë të çmimeve në grupin e artikujve ushqimorë, që shkaktohet, në masën 95 për qind, nga rritja e çmimit të frutave dhe perimeve. Po të neglizhojmë çmimet e këtij grupi inflacioni rezulton në vetëm 0,63 për qind, që në terma vjetorë do të thotë vetëm 0,2 për qind, nga 4,2 për qind që është aktualisht.

Tabela 6. Rritja mujore e çmimeve gjatë dhjetorit (në %).


Treguesi	1998	1999	2000
Inflacioni	2,05	2,25	4,6
Inflacioni i grupit "ushqim, pije & duhan"	2,54	2,99	6,6
Inflacioni i nëngrupit "fruta & perime"	9,13	9,98	24,8
Inflacioni (përrjashtuar grupin "fruta & perime")	0,74	0,53	0,63

Si konkluzion mund të themi se matjet e disponueshme tregojnë për një rritje të lartë të Indeksit të Çmimeve të Konsumit që në masën 87 për qind është kontribut i rritjes së kërkesës për artikuj ushqimorë, fruta dhe perime!

Nuk ka dyshim se, realisht, ka dy probleme: kompozimi relativisht i vjetër i shportës së IÇK-së dhe fenomeni i spekulimit me çmimet e artikujve ushqimorë, fruta dhe perime, fenomen i cili është me intensitet në rritje. Megjithëse, në pamje të parë, duket paradoksale, në realitet ndodh që rritjet e forta spekulative të çmimeve në 10 ditët e fundit të vitit, të frutave dhe perimeve përmbysin gjithçka në arritjen e objektivit të inflacionit. Për të shmangur praktika të kësaj natyre, sidomos në vendet ku aplikohet regjimi monetar që quhet *inflation targeting*, llogaritet një tregues inflacioni i “zhveshur” prej ndikimeve të natyrës së mësipërme, i cili më së shumti quhet inflacion bazë.

Box 5. Inflacioni bazë.

Bankat qendrore dhe inflacioni gjithnjë e më shumë po shikohen si derivate të njëra-tjetrës. Një bankë qendrore e suksesshme që arrin të mbajë çmimet të ulëta dhe stabël dhe e anasjellta një inflacioni stabël për një periudhë të gjatë kohe përbën një motiv të mjaftueshëm për të rritur kreditibilitetin dhe pavarësinë e bankës qendrore. Në të vërtetë, inflacioni siç e kemi thënë dhe më sipër nuk është në të gjitha rastet atribut i politikës monetare të ndjekur. Duke u ndalur në vetë përqindjen e inflacionit vihet re një komponent i përhershëm ose i përgjithshëm, ecuria e të cilit në mënyrë të vazhdueshme udhëhiqet nga kërkesa, ndërkohë që ekzistojnë kapërcime të përkohshme në çmimet relative, zhvillime këto që më së shumti ndodhin si pasojë e ndërveprimit të ofertës. Elementi i përhershëm, zakonisht quhet **inflacioni bazë** ose **inflacioni qendror**, dhe ai gjykohet të jetë një kontribut i drejtpërdrejtë i politikës monetare. Ndërkohë, ndikimi i zhvillimeve në çmimet relative në përgjithësi konsiderohet si “çrregullim” i përkohshëm, i cili nga këndvështrimi i politikës monetare duhet të injorohet si përsa i takon vendimmarrjes ashtu dhe analizës së vendimeve të marra në të shkuarën.



Grafiku 6. Matje të ndryshme të inflacionit në Shqipëri.
(dhjetor 1999 - dhjetor 2000; ndryshimi 12-mujor).

Në rastin e Shqipërisë, përpjekjet për ndërtimin e këtij treguesi kanë qenë të pakta për aq kohë sa dhe vetë vendimmarrësit në Shqipëri nuk e kanë ndër të domosdoshme matjen e një norme inflacioni, që shkaktohet vetëm nga rritja e parasë ose e kërkesës agregate. Ndër studjuesit që kanë trajtuar këtë çështje përmendim Doris Schiesser¹² (1995) e cila ka konkluduar se përqasja më e mirë për inflacionin bazë, në rastin e Shqipërisë, është ajo matje e cila merr për bazë mesataren e trimuar (sistemuar), në të cilën x për qind e secilit krah të shpërndarjes është eliminuar duke lënë në fuqi vetëm mesataren e ponderuar të qendrës (1-2x). Në fund, ajo ka konkluduar se varianti më i mirë është ajo matje e inflacionit e cila shmang 25 për qind të mesatares së trimuar (12,5 për qind të mallrave për secilin krah të shpërndarjes) dhe fokuson vetëm mbi mesataren e qendrës së shpërndarjes prej 75 për qind.


¹² Studimi mbulon periudhën 1993 – 1995.

Me kalimin e viteve dhe stabilizimin e inflacionit në nivele njëshifrore dhe shumë afër zeros në dy vitet e fundit, përlogaritja e një treguesi të tillë bëhet më e vështirë sidomos po të marrim në konsideratë dhe praninë e vitit 1997¹³. Në përlogaritjet e kryera është marrë në konsideratë perioda 1993 – 2000 (në disa raste është shmangur një muaj i vetëm i vitit 1997, një periudhë e caktuar e vitit 1997 dhe i gjithë viti 1997) ndërkohë që, në tentativat për të llogaritur inflacionin bazë janë shtuar edhe disa matje të tjera ku e para merr në konsideratë zvogëlimin e peshës¹⁴ së zërave më të paqëndrueshëm të shportës dhe e dyta, i cili shndërron në zero peshat e zërave më të luhatshëm. Bazuar në kriteret për vlerësimin e rezultateve - madhësia e raportit të shmangies standarde me mesataren dhe shkalla e korrelacionit midis të gjitha matjeve me vetë inflacionin aktual - si përjashe më e mirë vazhdon të mbetet matja, e cila fokuson vetëm në 75 për qind të qendrës së shpërndarjes (25 për qind mesatare e sistemuar).

1.2.4.1. INFLACIONI DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Në 5 vitet e fundit inflacioni në Shqipëri ka ndjekur një spirale të paparashikuar. Pasi arriti në nivel njëshifror, në fund të vitit 1995, u trefishua vitin e ardhshëm për të arritur një pik të ri në fund të vitit 1997, në 42 për qind. Vënia e tij nën kontroll, gjatë vitit 1998, u reflektua në arritjen e një shifre të ulët, vetëm 8,6 për qind e cila në vitin pasardhës u pasua nga një shifër tjetër e pazakontë -1,03 për qind. Kjo ecure e inflacionit, ishte mëse e mjaftueshme për të nxitur Bankën e Shqipërisë për një lehtësim të politikës së saj, gjë që u reflektua në një ulje të njëpasnjëshme të përqindjes së interesit gjatë gjithë vitit 1999 dhe atij 2000.

Politika monetare, gjatë vitit 2000, kishte të njëjtin objektiv, atë të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, i cili në terma sasiorë kuptonte një interval objektiv në kufirin nga 2 deri në 4 për qind. Në fillim të vitit, vendimet e politikës monetare ishin thjesht vazhdimësi e politikës së ndjekur një vit më parë: ulje të njëpasnjëshme të përqindjes së interesit për depozitat me afat në lekë, të vendosura në bankat me kapital shtetëror. Kundërpërgjigja ishte një normë negative inflacioni, duke shfaqur në këtë mënyrë një mungesë elasticiteti të përqindjes së interesit, e cila që prej mesit të vitit 1997, luante realisht rolin e përqindjes bazë në ekonomi.



Grafiku 7. Përqindjet e tregut (maturim 12-mujor; përqindje vjetore).

¹³ Viti 1997 shënon një vit përmbysjesh të çdo ekulibri të arritur në 3 – 4 vitet e mëparshme. Në përgjithësi, viti 1997 duhet të anashkalohej pasi shmangiet e konstatuara në këtë vit ndikojnë në sjelljen e serive statistikore gjatë gjithë periudhës 1993 – 2000.

¹⁴ Zvogëlimi i peshave bëhet nëpërmjet shumëzimit të peshës aktuale, që malli ka, me devijimin standard historik të ndryshimit të çmimeve relative të atij malli.

Kjo është e kuptueshme për faktin që nuk patëm ndonjë ekspansion të kredisë për ekonominë (kryesisht kreditohet në valutë) e cila, për gjatë gjithë kohës, mbeti në nivele pak a shumë të ulëta. Megjithëse huamarrja ishte diçka më e lirë, buxheti i shtetit, duke përfituar nga situata e favorshme që krijoi privatizimi, gjatë vitit 2000, nuk krijoi presion të madh për likuiditet. Në këtë mënyrë, *yield*-i i bonove të thesarit u zvogëlua në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit për të treja llojet e maturitetit. Duhet thënë se në kushtet e ekzistencës së një tregu monetar jo shumë efikas dhe të një tregu ndërbankar të dominuar nga Banka e Kursimeve, çmimi i këtyre të fundit, nuk është çudi që të fitojë atributet e përqindjes bazë në ekonomi.

Edhe pse diferenca midis përqindjes së depozitave me afat tremujor dhe *yield*-it të bonove të thesarit me të njëjtin afat maturimi është zvogëluar ndjeshëm, mund të thuhet se rëndësia e kësaj të fundit është zbehur ndjeshëm duke mos përbërë më motiv për investitorët dhe bankat e nivelit të dytë. Grafiku 5 ilustron diferencën midis *yield*-it të bonove dhe përqindjes së kredisë, nga njëra anë, me përqindjen e depozitave me afat në lekë, nga ana tjetër. Meqenëse inflacioni vazhdoi të ishte negativ, Banka e Shqipërisë gjykoj se përqindja administrative e interesit nuk ishte më instrumenti i duhur për të ndikuar në ekonomi. Për rrjedhim, u pa e arsyeshme heqja dorë prej tij. Ky hap shënoi shkëputjen përfundimtare nga zbatimi i instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit monetar.

Në këtë mënyrë u vendos që ndikimi i politikës monetare në ekonomi t'i besohet totalisht përqindjes së interesit për marrëveshjet e riblerjes, që Banka e Shqipërisë do të kryente me bankat e nivelit të dytë në tregun e parasë. Është ende herët të japësh një gjykim të saktë mbi efektivitetin e këtij instrumenti. Koha e shkurtër gjatë së cilës ai është përdorur, vetëm 6 muaj, nuk e krijon një mundësi të tillë. Gjithësesi, në fund të vitit 2000, tabloja e përgjithshme regjistroi norma interesi më të ulëta se fundi i vitit të mëparshëm, në të gjitha llojet dhe maturitetet e tyre.

Në të vërtetë, Banka e Shqipërisë ka kuptuar se sfida e saj mbetet përsosja e zbatimit të këtij instrumenti, përsosje e cila, para së gjithash, nënkupton një përmirësim të të gjitha kanaleve të transmisionit, ku pa dyshim spikasin tregu i parasë, kanalet e kreditit dhe ai i përcaktimit të pritjeve në ekonomi. Kjo, ndër të tjera, nënkupton: interesim më të madh të bankave private ndaj lekut, ulje të dominimit të Bankës së Kursimeve në treg, nxitjen e bankave private për të kredituar në lekë dhe për të rritur pjesëmarrjen e tyre në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë gjykon se janë krijuar premiset e para për ta zëvendësuar regjimin aktual të politikës monetare me *inflation targeting*, një lloj politike monetare shumë e preferuar, e cila megjithë kufizimet e saj, sidomos për vendet në tranzicion, po zbatohet në një numër gjithnjë e më të madh vendesh.

Box 6. A është koha për të adoptuar regjimin e *inflation targeting* në Shqipëri?

Për të adoptuar regjimin e *inflation targeting* çdo vend është e nevojshme të plotësojë disa kushte në aspektin makroekonomik dhe atë institucional. Sa i plotëson Shqipëria këto kushte? Përgjigja për këtë pyetje do të krijonte dhe një ide të qartë mbi kohën e nevojshme për ta adoptuar këtë regjim.

I. Aspekti makroekonomik**Inflacioni**

Në përgjithësi, literatura rekomandon se një periudhë 2 – 3 vjeçare me inflacion të ulët duhet t'i paraprijë adoptimit të regjimit të *inflation targeting*. Në tërësi, gjatë viteve të fundit, tendenca ka qenë ulja e normës së inflacionit. Megjithatë, në vite të ndryshme ka qenë i pranishëm faktori *shock* si për norma të larta inflacioni ashtu dhe për norma të ulëta. Mbështetur në ecurinë e deritanishme të inflacionit, megjithëse ai ka vetëm dy vjet që endet në nivele shumë të ulëta, mund të thuhet se ekzistojnë premiset që të zbatohet një regjim i *inflation targeting*.

Kursi i këmbimit

Regjimi i kursit të këmbimit është një ndër pikat e tjera të forta në adoptimin e *inflation targeting*. Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendimet, që zgjedhin dhe administrojnë llojin e politikës valutore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Nga viti 1992, zbatohet një regjim luhatës i lirë këmbimesh valutore, që përbën një nga kriteret për fillimin e zbatimit të regjimit *inflation targeting*.

Konsolidimi fiskal

Vitet e fundit kanë shënuar hapa të rëndësishëm edhe në drejtim të konsolidimit fiskal. Megjithatë, nuk mund të flitet ende për konsolidim dhe stabilitet fiskal. Parë nga ky këndvështrim, duke ditur dhe vështirësitë në veçimin e asaj pjese të inflacionit, që shkaktohet nga politika fiskale, mund të thuhet se, për aq kohë sa tregu i bonove do të jetë i vetmi treg letrash me vlerë në Shqipëri, për aq kohë sa nuk do të ndalohet me ligj huamarrja e qeverisë nga Banka e Shqipërisë, për aq kohë sa nuk do të ketë një angazhim të plotë dhe të besueshëm nga të gjitha forcat politike për një administrim rigoroz dhe transparent të të ardhurave fiskale etj., është i vështirë aplikimi i suksesshëm i regjimit *inflation targeting*.

Stabiliteti financiar

Sistemi mbrojtës i Shqipërisë ndaj krizave financiare ka probleme të shumta, të cilat edhe pse njihen prej kohësh nuk po arrijnë të eliminohen. Ky imunizim i dobët, bën që ekonomia shqiptare të ketë shkallë të lartë ekspozimi, e, për rrjedhim, një kusht shumë i rëndësishëm i *inflation targeting* mbetet pa u plotësuar.

II. Aspekti institucional**Pavarësia e bankës qendrore**

Ligji ofron një pozicion të pavarur, por, në realitet, pavarësia e bankës është larg asaj ligjore.

Transparenca e bankës qendrore

Banka e Shqipërisë nuk është plotësisht transparente në thelbin e saj: shpjegimin e procesit vendimmarrës, sidomos për çështje të politikës monetare.

Besueshmëria e bankës qendrore

Nuk mund të thuhet se Banka e Shqipërisë ka fituar besueshmëri në publik. Në Shqipëri, ku inflacioni ndikohet mjaft nga faktorët *shock* dhe ata spekulativë, mundësia e devijimit nga objektivi është e lartë.

Banka e Shqipërisë me ligj, gjithashtu, ka një nivel të konsiderueshëm përgjegjshmërie, të matur me detyrimet për raportim. Por, në realitet, vlerësohet se përgjegjshmëria duhet rritur.


Marrëdhëniet me autoritetin fiskal

Niveli i bashkërendimit midis autoritetit monetar dhe atij fiskal nuk është në nivelin që kërkon regjimi i *inflation targeting*. Pra, nëse në aspektin makroekonomik ekzistojnë faktorë, që të shtyjnë të zgjedhësh *inflation targeting* si regjim të politikës monetare, në aspektin institucional gjykohej se më tepër peshë kanë pikat e dobëta të tij.

1.2.4.2. FAKTORË TË TJERË QË NDIKOJNË NË ECURINË E INFLACIONIT.

Në hyrje të kësaj çështjeje përmendëm që inflacioni në Shqipëri është produkt edhe i faktorëve të tjerë jo të lidhur drejtpërdrejt me politikën monetare dhe treguesit monetarë. **Politika fiskale** e zbatuar nga qeveria, gjatë vitit të kaluar, u ndihmua nga realizimi i të ardhurave buxhetore, por edhe nga privatizimi i disa ndërmarrjeve të mëdha shtetërore, frut i të cilit ishte respektimi i kufijve të programuar, megjithëse gjatë vitit të kaluar u mbajtën zgjedhjet për qeverisjen lokale.

Një tjetër faktor, i cili tashmë mund të quhet tradicional, që ndikon nivelin e çmimeve të konsumit është **kursi i këmbimit të Lekut me Dollarin Amerikan dhe Euron**. Viti i kaluar regjistroi përsëri në fakt, nivelet më të larta të importeve të mallrave dhe të shërbimeve, ku një pjesë të mirë e zinin mallrat për konsum, çmimi i të cilave, në shumë raste, është faktor përcaktues i inflacionit. Në përgjithësi, vendet partnere të Shqipërisë kanë një normë të ulët inflacioni, kuptohet se kursi i këmbimit është ai faktor, që do të ndikojë çmimet e importit e për rrjedhim çmimet e konsumit në përgjithësi. Gjatë vitit të kaluar monedha europiane (natyrisht dhe të gjithë nënfishat e saj) u zhvlerësua ndjeshëm ndaj Dollarit Amerikan. Edhe Leku, ndoqi pak a shumë të njëjtin shteg, por duhet theksuar se ishte stabil kundrejt Euros. Ky fakt tregon se Euro, si monedha predominuese në tregtinë e jashtme të Shqipërisë është faktor kyç në përcaktimin e sjelljes së çmimeve të konsumit.



Grafiku 8. Kursi i këmbimit (janar 2000 - dhjetor 2000).

Pritjet në ekonomi. Edhe pse akoma nuk është ndërmarrë një studim i mirëfilltë për të përcaktuar rolin e pritjeve në ekonomi, duhet theksuar se, sidomos vitet e fundit, ato kanë filluar të jenë të pranishme dhe luajnë rolin e tyre në ekonominë shqiptare. Edhe pse të gjithë e kuptojnë se rritja e çmimeve në fund të vitit është një fenomen spekulativ, përsëri njerëzit parapërgatiten për këtë rritje thjesht duke gjykuar nga e kaluara, pavarësisht se këtë vit rritja ishte përtej asaj çka ata prisnin.

Faktorët që lidhen me rritjen e kostos së produkteve gjatë vitit 2000, ishin të pranishëm në formën e rritjes së pagës nominale në masën 8 për qind, të rritjes së çmimeve të naftës dhe të krizës energjitike.

Ndonëse rritja e pagave zyrtarisht është shpallur vetëm për sektorin shtetëror të ekonomisë, ajo duhet të ketë dhënë ndikimin e vet në sektorin privat të ekonomisë, i cili është i vështirë të matet për shkak të mungesës së të dhënave.

Siç është thënë dhe më sipër, efekti i rritjes së çmimit të karburanteve në ekonomi ishte relativisht i pakët duke të çuar në përfundimin se karburantet, në përgjithësi, nuk përbëjnë një element të rëndësishëm të kostos së prodhimit. Edhe në rastin e krizës energjitike, duke mos përjashtuar implikime të mundshme në të ardhmen, ndikimi i saj në rritjen e kostos së produkteve mbeti i ulët, falë kontrollit administrativ mbi çmimin e energjisë elektrike, duke mos përbërë faktor për rritjen e kostos së prodhimit.

Po kështu, aritmia në kryerjen e shpenzimeve buxhetore shkakton vështirësi në administrimin e likuiditetit, daljen e konsiderueshme të parasë në qarkullim në periudha të caktuara kohe dhe për pasojë në çrregullimin e nivelit të çmimeve.

1.2.5. STATISTIKAT FISKALE TË QEVERISË.

Viti 2000, u karakterizua nga përpjekjet e qeverisë për të arritur një konsolidim fiskal sa më efikas, në drejtim të vjeljes së të ardhurave në total në mënyrë sa më të rregullt dhe kryerjes nën kontroll të shpenzimeve.


1.2.5.1. TË ARDHURAT BUXHETORE.

Nga të dhëna paraprake¹⁵ dëshmohet se deri në fund të vitit 2000, të ardhurat totale u realizuan në masën 120,3 miliardë lekë, ose në rreth 97.2 për qind krahasuar me parashikimin e tyre për vitin 2000. Nëse do t'i referohemi të dhënave të të njëjtës periudhë të një viti më parë, ato kanë pësuar një rritje me rreth 12 për qind.

Niveli i realizimit të të ardhurave vjetore me rreth 3 pikë përqindjeje nën nivelin e parashikimit vjetor është ndikuar pozitivisht nga:

- tejkallimet e lehta në zërin e të ardhurave tatimore (2 pikë përqindjeje) pjesën më të madhe të të cilave e zënë ato nga tatimet dhe doganat. Vlen të theksohet se tejkallimet më të spikatura për këtë grup të ardhurash i paraqesin ato, që vijnë si rezultat i aplikimit të tatimit mbi fitimin (+30 për qind) si edhe të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale (+12 për qind);
- tejkallimet, gjithashtu, të lehta në zërin e të ardhurave nga pushteti lokal (5.2 për qind).


Ndërkohë që negativisht në mosrealizimin e të ardhurave, kanë ndikuar nivelet e ulëta të realizimit në zërin e të ardhurave jotatimore me 17.1 pikë përqindjeje nën parashikimin vjetor (të ardhura nga institucionet buxhetore). Struktura e të ardhurave, në fund të vitit 2000, na tregon se ato kanë si burim kryesor të tyre të ardhurat tatimore. Ato zunë afro 70 për qind të totalit të të ardhurave (shih grafikun 16).



Grafiku 9. Struktura e të ardhurave.

¹⁵ Analiza është kryer mbi bazën e të dhënave papaprake të siguruara nga Ministria e Financave, në mars të vitit 2001.

Duke parë se të ardhurat tatimore kanë këtë peshë të konsiderueshme në të ardhurat totale dhe për më tepër janë ato që kanë ushtruar efekt pozitiv në vlerën e realizimit të të ardhurave, do të ishte me interes studimi i strukturës së pjesës më të rëndësishme dhe njëkohësisht më të madhe të këtyre të ardhurave. Rreth 98.4 për qind të të ardhurave tatimore rrjedhin nga tatimet dhe doganat.



Grafiku 10. Struktura e të ardhurave tatimore.

Të ardhurat nga aplikimi i TVSH-së zënë rreth 46 për qind të këtyre të ardhurave. Ndërkohë që, të ardhurat doganore kanë një peshë prej rreth 16 për qind (shih grafikun 22).

Nëse do të analizojmë ecurinë e realizimit të të ardhurave në total dhe të atyre tatimore në veçanti, do të kishim pamjen e mëposhtme të ritmikës së tyre:

Tabela 7 : Ritmika e realizimit të të ardhurave (sipas tremujorëve).

Realizimi (në %)	Trem. I	Trem.II	Trem.III	Trem.IV	Viti 2000
Të ardhurave totale	23.2	22.9	24.3	26.9	97.0
Të ardhurave tatimore	22.9	22.9	26.6	28.0	100.3


Në përgjithësi, vihet re se ritmika është e rregullt si për të ardhurat në total, ashtu dhe për ato tatimore, ku bie në sy një tendencë e lehtë në rritje për muajt e fundit të vitit. Në tërësi, ka një prirje pozitive që shprehet në rritjen e realizimit të të ardhurave buxhetore, sidomos në grupin e të ardhurave tatimore dhe nga doganat.

1.2.5.2. SHPENZIMET BUXHETORE.

Konsideratat mbi situatën makroekonomike të vendit nuk mund të plotësohen pa analizuar gjendjen dhe ecurinë e kryerjes së shpenzimeve buxhetore. Një nga burimet e stabilitetit makroekonomik dhe të ruajtjes së kontrollit mbi inflacionin është edhe mënyra e kryerjes së zërave të veçantë të shpenzimeve.

Nëse do t'i referoheshim shifrave paraprake të statistikave fiskale të qeverisë, konstatohet se shpenzimet buxhetore në fund të vitit 2000, arritën shifrën 169 miliardë lekë ose krahasuar me parashikimin e fundvitit 2000, ato shënuan një mosrealizim me rreth 4 pikë përqindjeje. Krahasuar me një vit më parë ato u rritën me rreth 1.9 për qind. Nëse do t'i referoheshim shifrave paraprake të statistikave fiskale të qeverisë, konstatohet se shpenzimet buxhetore në fund të vitit 2000, arritën shifrën 169 miliardë lekë ose krahasuar me parashikimin e fundvitit 2000, ato shënuan një mosrealizim me rreth 4 pikë përqindjeje. Krahasuar me një vit më parë ato u rritën me rreth 1.9 për qind.

Duke u ndalur në dy grupimet e mëdha të shpenzimeve do të evidentonim një tejkalim të lehtë të shpenzimeve korente (shih grafikun 23). Ky tejkalim është balancuar madje nga mosrealizimi i shpenzimeve kapitale në masën 7 për qind.



Grafiku 11. Struktura e shpenzimeve.

Shpenzimet për paga dhe për personelin përbëjnë zërin më të madh të shpenzimeve korente, me rreth 25 për qind (19.6 për qind të totalit të shpenzimeve) duke i lënë vendin e dytë shpenzimeve për interesa, të cilat, në fund të vitit 2000, përbënin 21.4 për qind të totalit të shpenzimeve korente.

Vëmendje i duhet kushtuar ritmikës së kryerjes së shpenzimeve. Përvoja ka treguar se ato përqendrohen në fund të vitit dhe, bëhen pa kriter. Për më tepër, ato bëhen bartëse të presioneve inflacioniste duke u reflektuar në nivelet më të larta të inflacionit të pritshëm. Gjithashtu, nevojat për likuiditete në fund të vitit janë më evidente, për pasojë mund të vënë në vështirësi zbatimin e aspekteve të politikës monetare. Kështu, rreth 32 për qind e shpenzimeve mbeti të realizohej në tremujorin e katërt të vitit.

Pamjen më të parregullt në ritmikë e manifestuan shpenzimet kapitale, të cilat deri në fund të tremujorit të tretë u realizuan në masën 55 për qind krahasuar me parashikimin e vitit 2000. Vetëm në tremujorin të katërt të vitit ato u realizuan në masën 38 për qind.

1.2.5.3. DEFICITI BUXHETOR.

Ecuria e deficitit buxhetor dhe vlera e tij në fund të vitit, japin informacionin rezultant të situatës makroekonomike të vendit, që deri diku vlerësohet të jetë e qëndrueshme. Vendi e mbylli vitin 2000 me një deficit buxhetor prej 48.6 miliardë lekësh. Muaji korrik shënoi vlerën më të lartë të tij me rreth 5.8 miliardë lekë. Nga ana tjetër, krahasuar me parashikimin e tij për vitin 2000, ai shënoi një realizim në masën 93 për qind. Rreth 54.0 për qind u financua nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër e tij (16 për qind) nga burime të huaja. Në burimet e brendshme vlen të theksohet se të ardhurat nga privatizimi, deri në fund të vitit 2000, arritën shifrën 9 miliardë lekë, ose 28 për qind më të larta se parashikimi. Në këtë shifër, ndjehet efekti i menjëhershëm i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore të rëndësishme. Kështu, muaji gusht shënoi “bumin” e këtij efekti.

Ndërkohë, të ardhurat nga privatizimi, deri në fund të dhjetorit 2000, vlerësohen të zënë rreth 30 për qind të financimit të brendshëm të deficitit buxhetor.

Rritja e të ardhurave nga privatizimi në nivele më të larta nga ç’pritej, bëri të mundur që të mos rriteshin ndjeshëm nevojat e qeverisë për financim, nëpërmjet sistemit bankar.

Tabela 8. Treqesit fiskalë të buxhetit ndaj PBB-së¹⁶.

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Totali i të ardhurave	24.1	23.4	18.3	16.5	16.9	21.1	22.4
Nga të cilat : të ardhura tatimore	16	13.2	10.7	9.8	12.3	12.7	15.6
Totali i shpenzimeve	33.1	33.6	31.3	29.5	27.3	32.7	31.4
Nga të cilat : shpenzimet kapitale	3.4	8.3	6.3	4.4	5.3	5.8	6.5
Deficiti	-9	-10.2	-13	-13	-10.4	-11.6	-9.1
Financimi i jashtëm	0.4	3.7	2.8	1.9	3.8	6.1	4.2
Financimi i brendshëm	8.6	6.5	10.2	11.2	6.6	5.5	4.9

¹⁶ Ministria e Financave & IMF.


1.3. ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM

1.3.1. BILANCI I PAGESAVE.

Zhvillimet e bilancit të pagesave për vitin 2000 evidentojnë një rritje të madhe të transaksioneve korente, e cila është shkaktuar kryesisht nga rritja e vlerës së transaksioneve të tregtisë së shërbimeve. Në nivel viti, totali i transaksioneve korente në vitin 2000 vlerësohet rreth 3 miliardë dollarë (80 për qind e PBB-së) ose afërsisht 24 për qind më i lartë se në vitin 1999. Përveç shërbimeve, në këtë rritje kanë kontribuar dhe transfertat korente e tregtia e jashtme në mallra. Në fund të vitit, llogaria korente u mbyll me një deficit 14.3 për qind më të lartë se ai i vitit 1999. Megjithatë është e nevojshme të evidentohet se bilanci korent, përjashtuar transfertat shtetërore vlerësohet 17 për qind më i ulët se një vit më parë. Hyrjet e larta në llogarinë kapitale jo vetëm mundësuan mbulimin e plotë të deficitit korent, por ndikuan dhe në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar.

1.3.1.1. TREGTIA E JASHTME.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme në mallra për vitin 2000 u karakterizuan nga rritje të mëtejshme të importeve dhe një gjendje amullie e eksporteve të mallrave (grafikët 7,9). Totali i transaksioneve tregtare në mallra u rrit mbi 9 për qind, tërësisht si rrjedhojë e rritjes së importit të mallrave. Ky, për herë të parë kaloi shifrën prej 1 miliardë dollarësh amerikanë duke u rritur rreth 14.1 për qind, kundrejt një viti më parë. Në dallim nga importet, eksporti ka rënë afërsisht 7 për qind kundrejt vitit të kaluar. Rrjedhimisht, deficitin e tregtisë së jashtme në mallra, krahasuar me një vit më parë është thelluar më tej me 23 për qind, që në shifra absolute për gjithë vitin 2000 do të thotë 814 milionë dollarë amerikanë. Edhe gjatë vitit 2000, tregtia e jashtme kryesisht u përqëndrua në vendet tradicionale partnere fqinje, Itali, Greqi, Turqi, Maqedoni etj. (shih grafikun 8). Ndërsa tregtia me vendet e zonës së EURO-s përfaqëson rreth 75 për qind të totalit të tregtisë së jashtme.




Grafiku 12. Bilanci tregtar (në milionë USD).


Importet e mallrave, të cilat këtë vit regjistruan një shifër rekord prej 1.07 miliardë dollarësh amerikanë, kanë shfaqur tendenca rritje që nga fillimi i vitit, por janë rritur veçanërisht shumë, në tremujorin fundit, kryesisht si rezultat i importeve “të sforcuara” për energji. Ndikimi i krizës energjitike, e cila përfshiu vendin që nga fillimi i vjeshtës së vitit 2000, u reflektua në importe të larta në grupin “produkte minerale” ku përfshihen edhe importet e energjisë elektrike e ato të lëndëve djegëse dhe në grupin “makineri e pajisje mekanike e elektrike”. Importet në këto grupmallra janë rritur respektivisht 37 dhe 74 për qind kundrejt një viti më parë. Në dallim nga vitet e tjera, importet e grupmallrave ushqimorë vlerësohen 5.6 për qind më të ulëta se një vit më parë.

Megjithatë, duke mbajtur parasysh se importet e larta të vitit 1999 përfaqësojnë rritjen e konsumit për efekt të krizës kosovare, e cila e rriti popullsinë me 15 për qind dhe rrjedhimisht dhe kërkesën e brendshme, nuk është e vështirë të arrihet në përfundimin se importi i grupmallrave ushqimorë për konsumin e brendshëm nuk ka rënë nën nivelin e vitit 1999. Në grupet e tjera të importeve janë rritur importet në “mjete transporti” me 13.5 për qind dhe importet në “metale bazë dhe artikujt e tyre” me 10.5 për qind. Gjithashtu, janë rritur edhe importet e industrisë kimike dhe plastikat, respektivisht me 17.5 dhe 20.1 për qind. Ndër grupmallrat e importit, që kanë rënë kundrejt vitit 1999, vlejné të përmenden “tekstile dhe artikuj tekstile” rreth 3 për qind dhe “veshjet e këmbës dhe të kokës” rreth 21 për qind.

Të dyja këto grupe, përfaqësojnë kryesisht importe të materialeve për përpunim aktiv. Grupet e tjera, që kanë rënë nuk kanë luajtur ndonjë rol përcaktues në ecurinë e importit, rrjedhimisht, nuk vlejné të evidentohen (shih grafikun 10).




Grafiku 13. Partnerët tregtarë (në % ndaj totalit).



Grafiku 14. Bilanci tregtar (në % ndaj totalit).

Ndryshe nga parashikimet optimiste në fillim të vitit, eksporti jo vetëm që nuk mundi të realizonte nivelin e parashikuar, por nuk arriti dot as nivelin e një viti më parë duke regjistruar një rënie prej 7 për qind. Kjo rënie, është shkaktuar tërësisht prej rënies së rieksperteve nga përpunimi aktiv, të cilat përqëndrohen kryesisht në grupmallrat e tekstileve dhe të këpucëve. Eksportet nga prodhimi i brendshëm kanë ruajtur nivelin e vitit të kaluar. Në këtë grup, është vërejtur një rënie në grupmallrat e eksporteve tradicionale. Kështu, është regjistruar një rënie e ndjeshme, prej 44 për qind në eksportet e grupit “produkte minerale”, e pasuar nga një rënie, rreth 4 për qind, në eksportet e grupit “ushqim, pije, duhan”. Gjithashtu, kanë rënë edhe eksportet e grupit makineri e pajisje, 36 për qind kundrejt vitit 1999 (grafiku 10). Në grupin e eksporteve që janë rritur kundrejt vitit 1999, rritjen më të madhe e kanë regjistruar eksportet në “metale bazë e artikujt e tyre” me 47.7 për qind.



Grafiku 15. Struktura sipas grupmallrave (në milionë USD).

1.3.1.2. SHËRBIMET, TË ARDHURAT DHE TRANSFERTAT.

Statistikat e bilancit të pagesave për vitin 2000, tregojnë se tregtia e jashtme në shërbime (kryesisht shërbimet e turizmit) evidentohet si aktivitet me një rëndësi jetike për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë ky aktivitet ka gjeneruar të ardhura mbi 1.5 herë më të larta se të ardhurat nga eksporti i mallrave, ndërkohë që shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit, rreth 272 milionë dollarë amerikanë ose mbi 51 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët për vitin 2000. Rrjedhimisht, në fund të vitit, bilanci pozitiv i këtyre shërbimeve vlerësohej në 117 milionë dollarë amerikanë. Me një aktivitet të tillë, turizmi ka dominuar të gjitha zhvillimet në tregtinë e shërbimeve, e cila u mbyll me një suficit të lehtë prej 22.3 milionë dollarësh.

Box 7. Shërbimet e turizmit.

Metodika aktuale e llogaritjes së këtij zëri merr në konsideratë numrin e turistëve të huaj, që largohen nga Shqipëria dhe numrin e turistëve shqiptarë, që hyjnë në Shqipëri; kohë qëndrimin mesatar dhe shpenzimet mesatare ditore për të dyja grupet e turistëve. Statistikat për dy grupet e fundit për vitin 2000, u bazuan në rezultatet e vërtetimit statistikor për të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti turistik. Në të vërtetë, termi “ndryshimi i metodikës” i shkon më shumë metodikës së llogaritjes së shpenzimeve të turistëve shqiptarë jashtë shtetit, e cila para prezantimit të vërtetimit, bazohej në totalin e shpenzimeve të udhëtimit të kryera nga qeveria dhe agjenci të tjera publike. Ndërsa, për llogaritjen e të ardhurave nga shërbimet e turizmit, termi “ndryshim” i referohet adoptimit të rezultateve të dalta nga vërtetimi për kohëqëndrimin dhe shpenzimet mesatare ditore të turistëve të huaj, gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri.

Vërtetimi për të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti turistik, u realizua në pesë faza të shtrira gjatë gjithë vitit 2000, duke u përpjekur të mbulojë të gjitha sezonet me karakteristika të ndryshme turistike. Qëllimi i këtij vërtetimi ishte të vlerësonte kohëqëndrimin mesatar dhe shpenzimet mesatare ditore për turist.

Rezultatet e tij treguan se ka patur një rritje të ndjeshme të kohëqëndrimit mesatar dhe të shpenzimeve mesatare ditore për person për turistët e huaj që vizitojnë Shqipërinë, krahasuar me vlerësimet e përdorura më parë. Për ta ilustruar këtë, mjafton të përmendet se kohëqëndrimi mesatar në ditë, sipas vërtetimit luhet në intervalin 6 deri në 9 ditë, ndërsa shpenzimet mesatare ditore vlerësohen nga 112 deri në 73 USD në ditë. Nga vlerësimet e bëra disa vite më parë besohet se treguesit e kohëqëndrimit mesatar dhe shpenzimeve mesatare ditore ishin respektivisht 5 ditë dhe 35 USD. Për turistët shqiptarë që udhëtojnë jashtë, sipas vërtetimit ka rezultuar se kohëqëndrimi mesatar luhet në intervalin 8 deri në 9 ditë dhe shpenzimi mesatar ditë vlerësohet 33 deri në 52 dollarë në ditë. Rrjedhimisht rritja e menjëhershme e statistikave të raportuara në zërin udhëtime të bilancit të pagesave, krahas rritjes së numrit të turistëve reflekton dhe adoptimin e këtyre vlerësimeve të reja në metodikën e llogaritjes së të ardhurave dhe të shpenzimeve të këtij zëri.

Statistikat për të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti i turizmit duhet të merren në konsideratë me rezervë pasi informacionet për numrin e turistëve, që hyjnë e dalin nga territori i Shqipërisë, të cilat shërbejnë si e dhënë bazë për llogaritjen e shpenzimeve dhe të ardhurave nga ky aktivitet, mund të përmbajnë pasaktësi. Njëkohësisht, vërtetimi për vlerësimin e shpenzimeve të turistëve u prezantua për herë të parë gjatë vitit 2000. Rrjedhimisht, Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën t'i rishikojë këto statistika nëse do të ketë revizionime apo rivlerësime të treguesve statistikore bazë.

Vlerësimet shumë të larta për shërbimet e turizmit janë ndikuar nga prezantimi i metodikës së re për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga ky aktivitet¹⁷. Metodika, e cila bazohet në llogaritjen e shpenzimeve ditore mesatare dhe të kohëqëndrimit mesatar për turist sipas vërtetimeve statistikore të bëra nga Banka e Shqipërisë, ka bërë që këta tregues të rriten ndjeshëm kundrejt vlerësimeve të përdorura më parë si për turistët e huaj ashtu edhe për ata shqiptarë, që udhëtojnë jashtë shtetit. Kjo e bën të vështirë krahasimin e statistikave për të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti i turizmit me periudhat e mëparshme.

Megjithatë, mund të thuhet se gjatë vitit 2000, ka pasur një rritje të madhe në numrin e udhëtarëve që kanë vizituar Shqipërinë dhe të atyre që kanë udhëtuar jashtë, respektivisht me rreth 52 dhe 58 për qind (sipas statistikave të Ministrisë së Rendit Publik). Ky mund të konsiderohet si një tregues i mjaftueshëm, që dëshmon për rritjen e aktivitetit në këto shërbime.

¹⁷ Shih Box 1-7.

Ashtu siç pritej, rritja e vëllimit të importit ka shkatuar rritjen e importit të shërbimeve të transportit të mallrave dhe shërbimeve të sigurimit. Këto kategori shërbimesh kanë dominuar mbi transaksionet e tjera të shërbimeve në kategoritë respektive të shërbimeve të transportit (deficiti vlerësohet 2.5 për qind më i lartë se një vit më parë) dhe të atyre të sigurimit (deficiti i këtyre shërbimeve vlerësohet rreth 13 për qind më i lartë se ai i vitit 1999).

Kategoria “shërbimet e tjera” ka regjistruar një suficit prej 15.2 milionë dollarësh ose 2.2 herë më të lartë se në vitin 1999. Kjo rritje është mundësuar kryesisht prej tkurrjes së shpenzimeve në shërbimet e komunikacionit dhe rritjes së të ardhurave nga shërbimet qeveritare. Megjithatë, roli i tyre në zhvillimet e tregtisë së shërbimeve mbetet modest dhe pa ndonjë ndikim të dukshëm. Komentet e mësipërme mbi zhvillimet në tregtinë e shërbimeve tregojnë se ndoshta vëmendja e autoriteteve për përmirësimin e zhbalancimeve korente krahas synimeve për nxitjen e rritjes së eksporteve në mallra dhe ngushtimin e deficitit tregtar të mallrave, duhet, gjithashtu, të përqëndrohet më shumë në tregtinë e shërbimeve.

Bilanci pozitiv i transaksioneve të “të ardhurave”, në fund të vitit vlerësohet rreth 107 milionë dollarë amerikanë ose 42 për qind më i lartë se një vit më parë. E gjithë kjo rritje i dedikohet të ardhurave më të larta nga puna e punëtorëve sezonalë e atyre kufitarë dhe e interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente.

Dërgesat e emigranteve për vitin 2000 vlerësohen rreth 46 për qind më të larta se në vitin 1999. Rritja e menjëhershme e këtyre transfertave, vjen kryesisht si pasojë e nivelit të ulët të tyre në vitin 1999¹⁸. Kjo rritje e fluksit të transfertave hyrëse, ka qenë mëse e mjaftueshme për të mbuluar rënien në zërat e transfertave shtetërore, të cilat këtë vit vlerësohen vetëm 58 për qind e atyre të një viti më parë. Natyrisht që edhe kjo rënie, reflekton kryesisht ndikimin e krizës kosovare të vitit 1999.

Ndryshe nga viti i kaluar, kur transfertat shtetërore dominoheshin nga ndihmat në mallra, në strukturën e transfertave shtetërore në vitin 2000, kanë mbizotëruar transfertat në mjete valutore, të cilat përfaqësojnë rreth 59 për qind të totalit të këtyre transfertave. Në fund të vitit bilanci pozitiv i transfertave korente u vlerësua 533 milionë dollarë ose rreth 51 për qind më i lartë se në vitin 1999. Në shtesë të rritjes së dërgesave nga emigrantët dhe transfertave hyrëse shtetërore, rritja e suficitit në këtë kategori, i detyrohet edhe rënies së transfertave të tjera dalëse. Rritja e transfertave korente është shoqëruar, gjithashtu, nga rritje e transfertave kapitale.

¹⁸ Gjatë vitit 1999 prurjet e larta në mjete valutore të injektuara në ekonomi nga popullsia kosovare gjatë qëndrimit në Shqipëri, reduktuan nevojat për dërgesa nga emigrantët duke luajtur njëkohësisht një rol zëvendësues për këto transfertat dhe njëkohësisht u shoqëruan nga transfertat të larta për Qeverinë Shqiptare. Efektet e krizës kosovare u shtrinë vetëm gjatë vitit 1999, rrjedhimisht, statistikisht për vitin 2000 pavarësisht nga ndryshimet relativisht të mëdha kundrejt vitit 1999, nuk reflektojnë ndonjë fenomen të veçantë. Ato luhaten rreth niveleve mesatare të periudhës para krizës. Kështu, megjithëse vlerësohen me një shifër rekord prej 531 milionë dollarësh amerikanë, dërgesat nga emigrantët, për vitin 2000, janë të krahasueshme me dërgesat nga emigrantët të regjistruara në vitin 1998, ndërsa niveli i transfertave shtetërore hyrëse vlerësohet rreth nivelit mesatar të transfertave shtetërore për periudhën 1994 – 1998.

Bilancet e larta pozitive, të arritura në kategorite e transfertave, të ardhurave e në tregtinë e shërbimeve nuk ishin të mjaftueshme për të përballuar rritjen e shpejtë të deficitit tregtar në mallra e për rrjedhim llogaria korente e thelloi deficitin me 19 milionë dollarë. Deficiti korent, në fund të vitit, vlerësohej 152 milionë dollarë amerikanë (grafiku 11).


1.3.1.3. LLOGARIA KAPITALE.

Mbulimi (financimi) i këtij deficiti korent është mundësuar nga flukset hyrëse të kapitaleve, të cilat kanë çuar në rritjen e detyrimeve dhe në rënien e depozitave të mjeteve valutore të bankave të nivelit të dytë në institucionet financiare jorezidente. Në fund të vitit, llogaria financiare ka regjistruar një bilanc pozitiv prej 240.7 milionë dollarësh amerikanë. Ky import kapitalesh është realizuar, kryesisht, prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe disbursimit të kredive nga jashtë, duke çuar në rritjen e detyrimeve financiare, që vlerësohet 45.5 për qind më të larta se një vit më parë.

Investimet e huaja direkte, që për këtë vit vlerësohen në 143 milionë dollarë amerikanë, për herë të parë që nga viti 1992 (vit kur këto u lejuan për herë të parë) janë shndërruar në një fenomen dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare. Deri në vitin 1999, flukset hyrëse më të larta janë regjistruar në vitin 1996, rreth 90 milionë dollarë. Në vitet që pasuan nën efektin e situatave të trazuara në vend dhe në rajon, flukset e investimeve të huaja direkte ranë rreth shifrave 45 milionë dollarë. Rritja e këtyre flukseve kapitale, në vitin 2000 rreth 3.3 herë ose 100 milionë dollarë kundrejt vitit 1999, reflekton kryesisht efektin e privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha shtetërore.

Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive nga jashtë. Këto disbursime të cilat vlerësohen rreth 100 milionë dollarë amerikanë (ose 20 për qind më të ulëta se një vit më parë) kanë shkuar, pothuajse tërësisht, në favor të sektorit “qeveria e përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve këtij sektori. Financuesi kryesor i qeverisë, ashtu sikurse edhe më parë, mbetet Banka Botërore.

Pretendimet, në fund të vitit, janë rritur vetëm me 31.1 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje e ulët, e cila vlerësohet vetëm sa 24 për qind e rritjes totale të mjeteve në vitin 1999, përfaqëson kryesisht rritjen e zotërimeve në mjete valutore të publikut. Në të kundërt, depozitat e sistemit bankar, pas rritjes vitin e kaluar me rreth 89 milionë dollarë, janë rritur këtë vit vetëm me 19 milionë dollarë.



Grafiku 16. Bilanci i Pagesave (në milionë USD).

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe “përdorimi i kredive dhe huave nga FMN”) dhe të transfertave korente në *cash* u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me 141.5 milionë dollarë (rreth 18 milionë dollarë më shumë se në vitin 1999) për vitin 2000. Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore. Niveli i rezervave valutore, në fund të vitit, ishte i mjaftueshëm për të përballuar 6.8 muaj importe (import mallrash) kundrejt 6.1, në fund të vitit 1999.

1.3.2. REZERVA VALUTORE.

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2000, vlera e rezervës valutore bruto ka arritur në 607.8 milionë dollarë, ndërsa vlera e rezervës valutore neto në 455.2 milionë dollarë (rezerva valutore vlerësohet me kursin aktual). Që nga fillimi i vitit 2000, rritja e vlerës së rezervës valutore bruto kap shifrën 126.24 milionë dollarë, ose 26.2 për qind. Hyrjet në këtë periudhë kapin shumën 301.3 milionë dollarë, ku veçojmë : në formën e granteve (KE dhe të tjerë) 57.3 milionë dollarë, në formën e huave (FMN, IDA, KE dhe të tjerë) 91.4 milionë dollarë, në formën e blerjeve (nga bankat, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të tjerë) 113.3 milionë dollarë, në formën e të ardhurave nga investimi 24.9 milionë dollarë, etj..

Daljet në këtë periudhë kapin shifrën 159.6 milionë dollarë, ku veçojmë : në formën e pagesave të shërbimit të borxhit të jashtëm (të Bankës së Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë) 20.2 milionë dollarë, në formën e transferimeve (Qeveria e Republikës së Shqipërisë, bankat dhe të tjerë) 123.4 milionë dollarë, në formën e shitjeve (për bankat dhe për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë) 15.8 milionë dollarë etj..

Përsa i takon mënyrës së administrimit të rezervës valutore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar me vendimin nr. 70, datë 02.08.2000 “Politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”, dokument i cili përcakton objektivat që ka procesi i investimit të rezervës, limitet për investim sipas monedhave dhe instrumenteve të veçanta etj..

Dokumenti i ri, parashikon shtimin e instrumenteve të investimit të rezervës valutore, duke ruajtur cilësi të larta të sigurisë dhe të likuiditetit. Për t'i paraprirë nevojës për njohje më të mirë të rreziqeve, dokumenti i ri parashikon krijimin e Komitetit të Investimit dhe të Sektorit të Vlerësimit të Rreziqeve (*middle-office*). I pari, do të rrisë aftësinë analizuese dhe vendimmarrëse, brenda treguesve bazë të përcaktuar në dokument nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. I dyti, do të jetë një formë e organizimit brenda departamentit përgjegjës për administrimin e rezervës valutore, e specializuar për identifikimin dhe për vlerësimin e rreziqeve financiare, si ai i tregut, i kreditit, operacional etj..

Kapitulli 2 Politikadheinstrumen tmonetare

2.1. ZHVILLIMET NË POLITIKËN MONETARE


Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për zbatimin e politikës monetare. Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” përcakton qartë fushën e veprimit të politikës monetare; ajo është **arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve**. Objektivat e tjerë të politikës monetare janë të kushtëzuar nga plotësimi i këtij objektivi, ose në funksion të plotësimit të objektivit kryesor.

Stabiliteti i çmimeve konsiderohet si një ndër karakteristikat thelbësore të një ambienti makroekonomik të shëndoshë, i aftë për të garantuar rritje të qëndrueshme ekonomike për periudha afatgjata. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë nuk mund të shikohet e ndarë nga kushtet konkrete dhe masat makroekonomike, që kanë lidhje me politikën fiskale dhe me reformën strukturore të ekonomisë. Ajo është pjesë e një programi të gjerë makroekonomik afatmesëm, i cili parashikon edhe mbështetjen e organizmave financiarë ndërkombëtarë.

Për vitin 2000 objektivi për inflacionin ka qenë kufizimi i rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit, IÇK, në kufijtë 2 deri në 4 për qind. Përcaktimi i objektivit të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve, në formën e një bande të ngushtë dhe në nivele të ulëta, reflektonte jo vetëm synimin e Bankës së Shqipërisë për një nivel të ulët inflacioni, por ai mbante parasysh situatën makroekonomike të fillimvitit si dhe atë të periudhës 1998 – 1999, një periudhë dyvjeçare rritjeje ekonomike dhe inflacioni të ulët.

Banka e Shqipërisë ka synuar kontrollin e rritjes së ofertës monetare në një nivel të diktuar nga nevojat për rritje ekonomike dhe objektivi për inflacionin. Niveli i ofertës monetare përbën edhe objektivin e ndërmjetëm të politikës monetare. Inflacioni konsiderohet, si rregull i përgjithshëm, si një fenomen monetar dhe ekzistenca e tij në periudha afatgjata bëhet e mundur vetëm në kushtet e ekzistencës së bilanceve më të mëdha të parasë reale se ato të kërkuara nga publiku.

Gjatë vitit 2000, oferta monetare dhe treguesit më të rëndësishëm makroekonomikë ishin, përgjithësisht, sipas vlerave të programuara. Po kështu, edhe indeksi i çmimeve të konsumit ishte poshtë vlerave të parashikuara gjatë gjithë muajve të vitit 2000, me përjashtim të muajit dhjetor.



Grafiku 17. Oferta e parasë (ndryshimi vjetor në përqindje).

Ky indeks, në muajin nëntor, shënonte një rritje prej 1.8 për qind mbi baza vjetore, ndërkohë që në dhjetor ai kërceu në 4.2 për qind. Në këto kushte, arsyet e kësaj rritjeje duhen kërkuar, ndër të tjera, edhe te motivet spekulative të rritjes së çmimeve në prag të festave të fundvitit dhe jo vetëm te rritja e ofertës monetare.

Megjithëse është e vërtetë se oferta monetare nuk ka patur një rritje lineare gjatë vitit 2000, përsëri karakteri i luhatshëm i saj nuk mund të shpjegojë plotësisht rritjen e menjëhershme të IÇK-së në dhjetor. Për më tepër, rritja e ofertës monetare ka qenë, përgjithësisht, në nivelet e parashikuara.

2.1.1. PROGRAMI MONETAR DHE OBJEKTIVAT SASIORË.

Ekonomia shqiptare po lëviz në përputhje me direktivat e programit afatmesëm trevjeçar të zhvillimit makroekonomik të vendit. Ky program gëzon dhe mbështetjen e institucioneve financiare ndërkombëtare, formalizimi i të cilës është arritur me nënshkrimin e një marrëveshjeje të re të mbështetjes, në dhjetor të vitit 1999, midis autoriteteve monetare dhe përfaqësuesve të organizatave financiare ndërkombëtare, FMN dhe BB.

Kjo marrëveshje e re është vazhdim i marrëveshjes ESAF-2, që funksionoi gjatë periudhës 1998 – 1999, dhe quhet Marrëveshje për Reduktimin e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike (PRGF). Viti 2000 përfaqëson vitin e fundit për të cilin është nënshkruar programi.

Ky program, duke qenë një plan masash veprimi dhe vendimmarrjesh për një periudhë trevjeçare nëpër të cilin duhet të kalojë ekonomia e Shqipërisë, ka parashikuar një kuadër të plotë reformash të thella strukturore, përfshirë dhe drejtimet kryesore të konsolidimit fiskal të vendit dhe të përmirësimit të pozicionit të jashtëm të tij.

Edhe politika monetare ka rolin e saj në këtë program, konkretizimi i tij do të arrihet në qoftë se respektohen tre objektivat sasiorë të mëposhtëm:

- kufiri i poshtëm për nivelin e rezervës ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë,
- kufiri i sipërm për nivelin e mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë,
- kufiri i sipërm për nivelin e kredisë neto të sistemit bankar për qeverinë.

2.1.1.1. REZERVA NDËRKOMBËTARE NETO E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Një ndër objektivat kryesorë në hartimin dhe në zbatimin e politikës monetare dhe të programit monetar të Bankës së Shqipërisë është ruajtja e një pozicioni të ekuilibruar valutor të vendit. Për të garantuar ruajtjen e një pozicioni të arsyeshëm valutor, Banka e Shqipërisë përcakton një objektiv për rezervën ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë në formën e kufirit të poshtëm.

Me qëllim që të kemi një bazë të qëndrueshme për të vlerësuar arritjet e Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, në vlerësimin e nivelit të rezervës valutore, kursi i dollarit amerikan kundrejt lekut mbahet konstant, në nivelin e regjistruar në muajin dhjetor të vitit 1999.

Niveli i rezervave valutore neto, gjatë vitit 2000, ka qenë mbi kufirin e vendosur për to. Rritja mbi baza vjetore e këtyre rezervave është e ndjeshme, rreth 174 milionë USD, ndërkohë që objektivi për rritjen e tyre ishte afërsisht 79 milionë USD. Në dhjetor, niveli i rezervës arriti në 445.9 milionë USD ose 94.3 milionë USD mbi objektivin.

Rritja më e madhe e rezervës ka ndodhur në gjashtëmujorin e dytë. Gjatë kësaj periudhe ajo është rritur me 138.7 milionë USD ndërkohë që në gjashtëmujorin e parë, rritja e saj ishte më “modeste”, 35.4 milionë USD.

Shkaku kryesor i rritjes së rezervës mund të identifikohet në hyrjet e mëdha të valutës gjatë kësaj periudhe në formën e granteve dhe të kredive të huaja si dhe në blerjet e valutës nga ana e Bankës së Shqipërisë sidomos gjatë gjashtëmujorit të dytë.

Megjithëse Banka e Shqipërisë zbaton një regjim luhatës të lirë të kursit të këmbimit, ajo përsëri ruan të drejtën të shesë dhe të blejë në tregun valutor, sidomos në përgjigje të lëvizjeve spekulative afatshkurtra ose për të ndikuar mbi nivelin ose përbërjen e rezervës valutore.

Në transaksionet valutore që Banka e Shqipërisë ka kryer gjatë vitit 2000, ka patur si partner kryesor Ministrinë e Financave, ndërkohë që nuk kanë munguar dhe transaksionet me bankat tregtare. Transaksionet me bankat e nivelit të dytë kanë patur një peshë më të vogël dhe duhet theksuar se në gjysmën e parë të vitit ato kanë qenë të orientuara nga shitja e valutës.

2.1.1.2. MJETET E BRENDSHME NETO TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë shprehin shumën e pretendimeve ndaj qeverisë dhe bankave të nivelit të dytë. Ato, së bashku me rezervat ndërkombëtare neto, formojnë bazën monetare. Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë, në fund të vitit 2000 rezultuan në nivelin 68 miliardë lekë ose diçka më pak se 13 miliardë lekë nën kufirin e sipërm të vendosur për to.

Ekzistenca e këtij kufizimi lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, përderisa qëllimi kryesor i tij është kontrolli i krijimit të likuiditeteve të tepërta në sistemin bankar.

Rezervat e tepërta të sistemit bankar, gjatë pjesës së parë të vitit, kanë qenë në nivele të ulëta dhe janë rritur mjaft gjatë pjesës së dytë të tij. Në mbështetje të politikës së saj për të mbajtur një sasi optimale¹⁹ të likuiditetit në sistem, Banka e Shqipërisë ka tërhequr një pjesë të këtij likuiditeti me anë të ankandeve të marrëveshjeve të riblerjes. Ky është shkaku që në fund të vitit 2000 portofoli i *repo*-ve i Bankës së Shqipërisë regjistronte mesatarisht 5,2 miliardë lekë.

Financimi i deficitit buxhetor, nga ana e Bankës së Shqipërisë, ka qenë në përputhje me parashikimin. Megjithatë, edhe gjatë vitit 2000, shpërndarja e këtij financimi në mënyrë të njëtrajtshme në harkun kohor të një viti mbeti përsëri problem.

2.1.1.3. KREDIA NETO E SISTEMIT BANKAR PËR QEVERINË.

Kredia neto e sistemit bankar për qeverinë shpreh pretendimet e sistemit bankar ndaj qeverisë. Objektivi për to, në formën e kufirit të sipërm, vendoset në përputhje me projektbuxhetin e qeverisë për vitin në fjalë.

Në fund të vitit 2000, gjendja e pretendimeve neto të sistemit bankar ndaj qeverisë rezultoi poshtë kufirit të sipërm të vendosur për të, për rreth 3 miliardë lekë.


Financimi i deficitit buxhetor nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit në tregun primar ishte 14 miliardë lekë. Pjesa tjetër e tij u mbulua nga kredia direkte e Bankës së Shqipërisë dhe të ardhurat e privatizimit të sektorëve të ekonomisë.

2.1.2. PARAJA.

Bazuar në parashikimet e fillimit të vitit 2000 për, (i) një rritje prej rreth 8 për qind të ekonomisë reale dhe, (ii) një objektiv për inflacionin në kufijtë 2 deri në 4 për qind, Banka e Shqipërisë programoi një rritje të ofertës monetare në kufijtë 12 për qind.

Oferta monetare, gjatë vitit 2000, është rritur me 12 për qind (shih grafikun 13), që në terma absolutë do të thotë 35.2 miliardë lekë. Megjithatë, duke konfirmuar një prirje të vërejtur gjatë këtyre viteve, rritja e ofertës monetare nuk ka qenë e njëtrajtshme gjatë gjithë vitit.

¹⁹ Banka e Shqipërisë bashkë me Ministrinë e Financave kanë ngritur Nënkomitetin e Administrimit të Huave të Brendshme, një funksion i të cilit është parashikimi i nivelit të rezervave të tepërta të sistemit dhe planifikimi i masave për optimizimin e tij.



Grafiku 18. Struktura e ofertës së parase (në milionë lekë).

Ajo ka qenë e dobët gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit dhe ka fituar ritëm të rritjeje gjatë gjashtëmujorit të dytë (vetëm 2.4 pikë për qind e rritjes vjetore së M3 i përket gjashtëmujorit të parë). Kjo e dhënë flet qartë për faktin, se oferta monetare nuk ka një rritje simetrike sipas tremujorëve. Një ndikim të madh në këtë sjellje të ofertës monetare ka patur përqëndrimi i financimit të deficitit buxhetor në muajt e fundit të vitit. Vetëm gjatë muajit dhjetor, është realizuar afërsisht 22 për qind e këtij financimi, ose 4.4 miliardë lekë. Ky fakt sjell edhe shmangie të raporteve të agregatëve monetarë, në fund të vitit, nga ecuria vjetore e tyre.

2.1.2.1. PËRBËRËSIT E OFERTËS SË PARASË.

Elementet përcaktuese, që kanë dhënë kontributin kryesor në rritjen e ofertës së parase (M3) gjatë këtij viti janë depozitat në valutë dhe paraja jashtë bankave (shih grafikun 12).

Tabela 9. Ndryshimet në strukturën e M3 (në %).

Treguesi	dhjetor 1999	qershor 2000	ndryshimi në M3	dhjetor 2000	ndryshimi në M3
PJB/M3	27.8	28.54	+0.74	30.30	+2.5
DL/M3	54.1	52.42	-1.68	50.30	-3.8
DV/M3	18.1	19.04	+0.94	19.40	+1.3

Prirja e paraqitur në tabelën më sipër ka mbizotëruar në gjithë vitin dhe në pjesën e dytë të tij ka qenë më e fortë. Rritjen më të madhe ndër agregatët monetarë, në terma absolutë dhe relativë, e ka patur paraja jashtë bankave me rreth 22 për qind ose afërsisht 18 miliardë lekë, duke zhvendosur raportin e saj me totalin e ofertës monetare nga 27.8 për qind, që ishte në fillim të vitit në 30.3 për qind në fund të muajit dhjetor. Ashtu si dhe vitet e kaluara, muaji me rritjen më të madhe të parase jashtë bankave mbetet muaji dhjetor, i cili në pjesën më të madhe, pasqyron nivelin e lartë të financimit të deficitit buxhetor.

Për rrjedhim, pritet që në muajt e parë të vitit 2001, një pjesë e parash jashtë bankave të kthehet në sistemin bankar, kryesisht në formën e depozitave pa afat.

Depozitat në lekë, mbi baza vjetore, shënojnë një rritje vetëm 4.4 për qind ose afërsisht 6.9 miliardë lekë në vlerë absolute. Ndërkohë, depozitat në valutë²⁰ kanë patur një rritje prej 19.5 për qind që rezulton në një rritje prej 10.4 miliardë lekësh në terma absolutë. Vlen të theksohet fakti se gjatë gjashtëmujorit të parë depozitat në lekë kanë patur ulje ndërsa depozitat në valutë kanë patur rritje të ndjeshme. Pjesa e dytë e vitit ka regjistruar rritje më modeste të depozitave në valutë dhe një rifillim të rritjes së depozitave në lekë.

2.1.2.2. NDIKIMI I SEKTORËVE TË EKONOMISË NË DINAMIKËN E OFERTËS SË PARASË.

Gjatë vitit 2000, sektorët e ndryshëm të ekonomisë kanë dhënë kontribute të ndryshme në krijimin e ofertës së parash.

Të dhënat statistikore të strukturës sektoriale të depozitave tregojnë se depozitat e individëve janë rritur ndjeshëm në krahasim me depozitat e sektorëve të tjerë, duke dhënë kontributin kryesor në rritjen e parash me 15.9 miliardë lekë. Kontributi i sektorit privat llogaritet në rritje në masën 1.4 miliardë lekë, ai i sektorit publik me rënie prej 0.9 miliardë lekësh.

Tabela 10. Shpërndarja e depozitave sipas sektorëve (në milionë lekë).

Vitet	Depozita pa afat në lekë			Depozita me afat në lekë			Depozita në valutë		
	Publik	Privat	Individ	Publik	Privat	Individ	Publik	Privat	Individ
1999	7,706	12,335	1,627	425	3,458	132,775	10,049	11,447	31,715
2000	7,184	15,161	2,460	839	720	138,897	10,025	12,823	40,756
Ndry.	- 522	+2,826	+ 833	-414	-2,738	+6,122	- 24	+1,376	+9,041

Këto zhvillime tregojnë se depozitat e individëve, të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në formimin e tendencës së ofertës së parash (M3) dhe vlerësohen si grup i qëndrueshëm, vazhdojnë të jenë përcaktuese në krijimin e M3. Ndërsa sektorët e tjerë të ekonomisë, që ndikojnë kryesisht në luhatjet e depozitave me likuiditet të lartë, kanë një kontribut më të ulët.

Motivi i individëve për rritjen e kursimeve duket se ka patur prirje si në drejtim të rritjes së kursimeve në lekë (me 6.1 miliardë lekë), ashtu edhe në valutë me (9 miliardë lekë) me një dominim të kësaj të fundit. Në ndryshim nga individët, biznesi i përdor mjetet financiare për qëllime transaksioni dhe njëkohësisht kërkon që pjesërisht nevojat e tij t'i mbulojë me kredi. Zhvillimet në depozitat²¹ e vendosura nga ky sektor²² nxjerrin në pah rolin ndërmjetësues të bankave në zhvillimin dinamik të ekonomisë. Si paraqitet gjendja duke marrë në konsideratë këtë fakt?

²⁰ Ngushtimi i intervalit midis normave të interesit të depozitave në lekë dhe në valutë ka qenë arsyeja kryesore e rritjes së raportit të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave. Ky raport kaloi nga 25.2 për qind, në fillim të vitit, në 27.8 për qind në fund të tij.

²¹ Depozitat pa afat, historikisht, kanë përbërë një grup shumë të luhatshëm, e, për rrjedhim, krahasimi i gjendjes së tyre në dy periudha të ndryshme mund të mos pasqyrojë saktësisht ecurinë e këtyre depozitave. Volumi i tyre rritet dhe ulet brenda vitit ndikuar nga zhvillimet sezonale, cikli tregtar, kalimi i veprimeve gjatë fundvitit nga buxheti i shtetit etj..

²² Sektori i biznesit, në përgjithësi, ndahet më tej në sektor privat dhe sektor publik (shtetëror).

Që në vështrim të parë duket se kemi një zhvendosje të depozitave të biznesit privat nga ato me afat në llogari korente në depozita pa afat. Për më tepër, duket se në vendimet e tij, biznesi ka preferuar kursimin në valuta të huaja, gjë që manifestohet në rritjen e gjendjes së depozitave në valutë të vendosura nga ky sektor, në masën 1,4 miliardë lekë.

Krejt ndryshe paraqiten zotërimet e sektorit shtetëror, të cilat në totalin e depozitave shënuan një rënie me afërsisht 1 miliard lekë, rënie e cila ishte e pranishme në të gjitha llojet e depozitave. Niveli i lartë i parasë jashtë bankave dhe rritja, jo shumë e lartë, e tepricës së depozitave pa afat në lekë, lënë të kuptojmë se lidhjet midis sektorit real të ekonomisë dhe sektorit bankar nuk janë të larta. Si rrjedhim, një pjesë e nevojave për transaksione në lekë të bizneseve vazhdojnë të plotësohen jashtë sistemit bankar në *cash*.

2.1.3. DEPOZITAT.

2.1.3.1. DEPOZITAT E KURSIMIT NË LEKË.

Depozitat me afat në lekë, në fund të vitit 2000, mbetën përsëri zëri me peshën më të madhe në totalin e ofertës së parasë me 49,4 për qind. Pjesa më e madhe e tyre ishte vendosur në Bankën e Kursimeve, e cila në fund të muajit dhjetor arriti 37.3 për qind të ofertës së parasë, por rreth 4 pikë përqindjeje më e ulët se viti i mëparshëm.

Në ndryshim nga vitet e mëparshme, viti 2000 në tërësi ka shënuar ritmin mesatar mujor më të ulët të rritjes së depozitave me afat në lekë. Kështu, ritmi mesatar mujor i rritjes, për vitin 2000, ishte 0.3 miliardë lekë nga 1.7 miliardë lekë, gjatë vitit 1999. Teprica e depozitave me afat në lekë është rritur nga 136.6 miliardë lekë, në muajin dhjetor 1999, në 140.4 miliardë lekë, në dhjetor 2000. Sjellja e depozitave në sistem, gjatë kësaj periudhe, reflekton ndikimin e shumë faktorëve. Një pjesë e tyre është e vështirë që të indentifikohen ose t'u matet efekti për faktin se, statistikisht për treguesit realë të ekonomisë mungojnë ose janë shumë të varfra. Pavarësisht nga këto vështirësi, Banka e Shqipërisë ka mundur të identifikojë disa nga faktorët që kanë ndikuar në rënien e ritmit të rritjes së depozitave të kursimit në lekë.

1. Ulja e vazhdueshme dhe graduale e nivelit të normave të interesave për depozitat me afat në lekë duke filluar nga viti 1998 dhe në vazhdim.


Individët për herë të parë, në traditën e vendosjes së kursimeve në bankë, u ballafaquan me nivelin më të ulët të interesave për depozitat në lekë. Në këtë mënyrë sinjalet e Bankës së Shqipërisë në drejtim të zbutjes së politikës monetare duket se kanë gjetur pasqyrimin e tyre në sjelljen²³ e investitorëve dhe veçanërisht te kursimtarët e vegjël. Megjithatë, duhet pranuar se alternativat e investimit të fondeve të lira janë të pakta dhe ekzistojnë alternativa joformale me shkallë të lartë rreziku.

²³ Siç duket dhe nga grafiku 3., sjellja e individëve në Shqipëri është e atillë që depozitimin në valutë e ruan si një alternativë të fuqishme të mbajtjes së kursimeve në ato periudha, kur kemi ulje të interesit dhe paqartësi politike.

Vlerësohet që një pjesë e fondeve të lira të drejtohet në kapitalizimin e biznesit privat, një pjesë tjetër në formë borxhi po tek biznesi privat, pa harruar të përmendim që kemi një rritje të numrit dhe të shumave që individët investojnë në bono thesari etj.. Nga ana tjetër, klima e investimit do të përmirësohej më shumë nëse ulja e kostos së fondeve për bankat do të shoqërohej dhe me uljen e pritshme të normave të kredisë.

2. Rritja e depozitave në të kaluarën ka qenë në nivele shumë të larta.

Nuk mund të thuhet me saktësi se cili është niveli optimal i rritjes së depozitave në lekë në sistem. Gjatë gjithë periudhës tetëvjeçare që lamë pas, interesat e ofruara kanë qenë shumë të larta e, për rrjedhim, edhe prurjet në formë depozitash ishin të larta. Është e kuptueshme që në rrethanat të tjera, kur inflacioni është në nivele të ulëta për një periudhë të gjatë kohe, askush nuk mund të presë rritje të tilla si ato, të verifikuara në vitet 1994, 1995, 1998 etj..



Grafiku 19. Rritja vjetore e depozitave (dhjetor 1994-nëntor 2000; ndryshimi 12-mujor në %).

3. Ndërthurja e politikës dhe efekti psikologjik mbi publikun.

Megjithëse rasti konkret është tërësisht i pamatshëm, përsëri propaganda e muajve të parë të vitit, mbi gjoja pasigurinë e depozitave në Bankën e Kursimeve, ka patur një efekt negativ të drejtpërdrejtë në motivimin e individëve për vendosjen kursimeve në lekë në bankën më të madhe në vend. Edhe pse efektin më të madh ky faktor e dha, menjëherë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2000, efekti i tij në mënyrë inerciale, u ndje edhe gjatë tremujorit të tretë.

4. Moskapitalizimi i të ardhurave nga interesi në depozita.

Ulja e normave të interesit ka bërë që të ardhurat nga interesi që kapitalizohen të vijnë duke u reduktuar dhe për pasojë kanë ulur ritmin e shtimit të depozitave.

2.1.3.2. STRUKTURA E DEPOZITAVE NË LEKË.

Struktura e depozitave të kursimit në lekë vazhdon të dominohet nga depozitat me afat maturimi tremujor. Dominimi i depozitave me afat nga ky maturitet e ul shkallën e qëndrueshmërisë së tepërisë së depozitave të kursimit.

Tabela 11. Peshë e depozitave me afat në lekë.

Treguesi	1999	2000
Njëmujor	0.5	1.3
Tremujor	53.9	52.0
Gjashtëmujor	7.0	8.4
Dymbëdhjetëmujor	38.6	38.0

Kjo lloj strukture në depozitat sipas afatit të maturimit më tepër është strukturë e trashëguar. Si pasojë e ngjarjeve të vitit 1997 dhe për të thithur depozita në sistemin bankar, Banka e Shqipërisë aplikoi një strukturë normash interesi, që favorizonte vendosjen e fondeve në depozita me afat tremujor. Pranimet e reja të depozitave, për vitin 2000, tregojnë për ndryshim të prirjes së depozituesve përse i përket afatit të vendosjes së depozitave. Megjithatë, ende nuk mund të thuhet nëse preferenca bie mbi depozitimet afatshkurtra apo ato afatgjata.

Politika e Bankës së Shqipërisë në fushën e normave të interesit për depozitat me afat në lekë, gjatë vitit 2000, ka qenë **orientimi i strukturës së normave të interesit për depozitat me afat në lekë drejt atyre me maturitet afatgjatë**, në favor të depozitave dymbëdhjetëmujore. Kjo politikë, lidhur me strukturën kohore të normave të interesit do të ndikojë në krijimin e një strukture të depozitave të dominuar nga depozitat me afat më të lartë se sa tre muaj. Si rrjedhim, do të rritet edhe qëndrueshmëria e kësaj pjese të ofertës së parasë.

2.1.3.3. KONTRIBUTI I BANKAVE TREGTARE NË RRIJTJEN E DEPOZITAVE NË SISTEM.

Kontributi i bankave tregtare në rritjen e depozitave në sistem, ndonëse në shifra të ulëta, ka njohur ndryshime gjatë vitit 2000. Bankat tregtare me kapital privat dhe të përbashkët kanë rritur pjesën e depozitave gjithsej ndaj totalit të depozitave gjithsej të sistemit bankar. Kështu, pjesa e depozitave gjithsej të bankave tregtare me kapital privat dhe të përbashkët ndaj totalit të depozitave të sistemit ka arritur në 19.26²⁴ për qind, në dhjetor të vitit 2000, nga 13.4 për qind, në dhjetor të vitit 1999.

E njëjta tendencë ruhet si për pjesën e depozitave në lekë ashtu edhe të depozitave në valutë. Konkretisht, pjesa e depozitave në lekë të bankave tregtare me kapital privat dhe të përbashkët ndaj totalit të depozitave në lekë të sistemit është rritur nga 3.75 për qind, në fund të vitit 1999, në 8.59 për qind, në dhjetor të vitit 2000. Pjesa e depozitave në valutë të këtyre bankave ndaj totalit të depozitave në valutë të sistemit ka arritur në nivelin rreth 45 për qind kundrejt 39.6 për qind, në fund të vitit 1999.

²⁴ Për efekt krahasimi Banka Kombëtare Tregtare e cila është privatizuar, është marrë në llogaritje si bankë shtetërore.

Tabela 12. Pesha e depozitave të çdo banke ndaj totalit të sistemit në vitin 2000 (në %).

Bankat	Depozitat gjithsej		Depozitat në lekë		Depozitat në valutë	
	Qershor	Dhjetor	Qershor	Dhjetor	Qershor	Dhjetor
Banka e Kursimeve	73.0	71.0	85.2	83.0	40.7	41.3
Banka Kombëtare Tregtare	9.8	9.7	8.5	8.4	13.8	13.6
Banka Italo Shqiptare	3.6	3.5	0.8	1.0	11.5	10.2
Banka Dardania	0.2	0.1	0.0	0.0	0.6	0.4
Banka arabe	0.4	0.2	0.0	0.0	1.4	0.5
Banka Kombëtare e Greqisë	2.3	2.3	1.0	1.0	2.7	2.7
Banka Tirana	4.0	4.3	2.1	2.4	9.5	9.5
Banka Tregtare Ndërkombëtare	0.3	0.4	0.1	0.2	0.9	1.0
Banka Alfa Kredit	1.7	2.1	0.8	1.2	4.2	4.8
Banka amerikane e Shqipërisë	3.6	4.6	0.8	1.6	11.6	12.6
Banka Fefad	1.2	1.4	0.6	1.0	2.9	2.3
Banka e Parë e investimeve	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.2
Banka Ndërtregtare	0.1	0.3	0.1	0.2	0.1	0.9
Totali	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Si rregull, prirja e publikut duhej të ishte e njëjtë ndaj të gjitha bankave që veprojnë në Shqipëri. Në kushtet kur në vend ende nuk ka të miratuar një skemë të sigurimit të depozitave, vendosja e parave në këtë formë investimi paraqet të njëjtin rrezik. Po kështu, edhe normat e mbikëqyrjes aplikohen në mënyrë uniforme në të gjitha bankat duke mos krijuar kosto apo përfitime shtesë për asnjë prej tyre. Nëse merren parasysh normat e interesit, atëherë mund të thuhet se publiku duhej të ishte më i prirur që të depozitonte në bankat private dhe me kapital të përbashkët, normat e të cilave janë diçka më të larta. Megjithatë, publiku ende është i prirur për të depozituar në Bankën e Kursimeve. Është e vështirë të besosh se kjo sjellje diktohet nga parimi “shumë e madhe për të falimentuar”. Besojmë se sjelljen e publikut shqiptar ende e drejton fakti që Banka e Kursimeve është pronë shtetërore si dhe shtrirja e saj e gjerë në të gjithë vendin.

2.1.4. ECURIA E KËRKESËS PËR PARA.

Pjesa më e madhe e rritjes së ofertës monetare, gjatë vitit 2000, ishte në formën e rritjes së mjeteve valutore neto të sistemit bankar, duke pasqyruar rritjen e madhe si të depozitave në valutë të sistemit bankar ashtu dhe të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë. Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë u rritën rreth 25 miliardë lekë, gjatë vitit 2000, duke përbërë rreth 82 për qind të rritjes totale të mjeteve valutore neto. Hyrjet e valutës gjatë kësaj periudhe i kanë kaluar parashikimet. Ato kanë ardhur si pasojë e ndihmave dhe e kredive të huaja si dhe e blerjes neto të valutave nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Faktori tjetër, që ndikon në rritjen e ofertës monetare shfaqet në formën e rritjes së mjeteve të brendshme neto të sistemit bankar, e cila gjatë vitit 2000, shënoi një nivel rritjeje në masën 26.1 miliardë lekë.

Ndryshe nga vitet e mëparshme kemi një përmirësim të raportit të përdorimit të kredisë sipas sektorëve. Megjithatë, parë nga këndvështrimi i nevojave të rritjes ekonomike, një peshë specifike prej 76.7 për qind e kredisë për sektorin publik ndaj totalit të kredisë së brendshme nuk mund të konsiderohet e kënaqshme. Në këtë drejtim, ka vend për të punuar në plan afatmesëm si në drejtim të nxitjes së kreditimit të ekonomisë, ashtu edhe në drejtim të uljes së deficitit buxhetor.

Deficiti buxhetor i financuar me burime të brendshme, gjatë vitit 2000, arriti në 26.4 miliardë lekë (ose 4.9 për qind e PBB-së) në krahasim me 27.8 miliardë lekë (ose 5.5 për qind e PBB-së) në fund të vitit 1999. Kjo shifër përbën një ulje prej 22.3 për qind në krahasim me nivelin e deficitit një vit më parë.

Financimi i deficitit, nga ana e sistemit bankar, ishte afërsisht 20 miliardë lekë ose 3.7 për qind e PBB-së krahasuar me 4.9 për qind një vit më parë. Kjo ulje e deficitit buxhetor, gjatë vitit 2000, është pasojë e përmirësimit të administrimit fiskal dhe të ardhurave të siguruara nga procesi i privatizimit.

Ecuria e kreditimit për ekonominë shënoi një progres të ndjeshëm në krahasim me një vit më parë, por, sidoqoftë, niveli i saj nuk i arriti vlerat e parashikuara për vitin 2000. Stoku i kredisë u rrit me 6.1 miliardë lekë nga 7.5 miliardë lekë të parashikuara. Madje, në ndryshim nga vitet e kaluara, në tremujorin e fundit, kredia nuk u rrit ndjeshëm. Një ndër shkaqet, që mendohet të ketë ndikuar, është edhe kriza energjitike gjatë kësaj periudhe, e cila ka bërë që të pezullohen vendimet për zgjerim aktiviteti ose madje edhe të tkurret aktiviteti ekzistues. Karakteristikë tjetër e procesit të kredidhënies ka qenë fakti se raporti i kredisë në lekë ndaj totalit të tepricës së kredisë ka ardhur vazhdimisht në ulje, duke u zhvendosur nga 53.4 për qind, në fillim të vitit, në 39.8 për qind në fund të tij.

2.1.5. ECURIA E KREDISË.

Rritja e kreditimit rrit investimet dhe prodhimin, rrit zënien me punë, rrit të ardhurat e buxhetit të shtetit nga të gjitha burimet e formimit të tyre dhe, duke siguruar rritjen ekonomike, në fund të fundit siguron stabilitetin e çmimeve të konsumit në një shoqëri ku të gjithë janë konsumatorë.

Kjo arsye madhore, bën që në vëmendjen e Bankës së Shqipërisë të jetë aktiviteti kreditues i sistemit bankar.

Box 8. Biznesi bankar dhe të gjitha llojet e tjera të biznesit.

Ky titull intrigoi Bankën e Shqipërisë, veç të tjerash, për të inicuar gjatë vitit 2000 një aktivitet të rëndësishëm që mori emrin “fushata e kreditimit”.

Duke synuar që të gjejë shkaqet e zhvillimit me ritme jo të dëshirueshme të kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar, Banka e Shqipërisë, në një ballafaqim në formën e tryezës së hapur për diskutime, grumbulloi përfaqësuesit e bankave të nivelit të dytë, përfaqësues të bizneseve, të projekteve të ndryshme të kreditimit, përfaqësues nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ dhe përfaqësues të medias.

Një gjë e rëndësishme u bë e qartë që në fillim – aktiviteti i bankave është biznes i organizuar mbi bazën e parimeve të tregut dhe kërkon që të zgjerojë aktivitetin e tij kreditues për të arritur fitime sa më të mëdha. “Malli” që shet është në përdorim të tij nga mobilizimi i parave të individëve, të familjeve e shoqërive dhe, në këtë mënyrë, është një detyrim me rrezik. Për këtë arsye, zbatimi i kërkesave të bankave në marrëdhëniet e kreditimit është domosdoshmëri që vjen nga burimi i fondeve.

Pjesa tjetër e biznesit që i drejtohet bankave për kredi duhet të respektojë kërkesat formale të domosdoshme, duke filluar nga më e rëndësishmja – formimin e bindjes për përfitueshmërinë e aktivitetit duke realizuar në këtë mënyrë kthimin e borxhit. Kredi do të thotë besim dhe kjo marrëdhënie besimi, e vendosur midis palëve, mund të realizohet në kuadrin e transparencës së plotë.

Bankat tregtare në kontaktet e përditshme të punonjësve të tyre me kërkues të kredive, vënë re mangësi në dokumentacionin bazë që fillojnë që nga bilanci.

Në fillimet e tij, sistemi bankar me kapital joshtetëror tregoi një ecuri të ngadaltë të procesit kreditues. Shkak për këtë ishte mungesa e marrëdhënieve të rregullta bankë-klient dhe krijimi i historisë së këtyre marrëdhënieve. Nga ana tjetër, transparenca duhet të ofrohet më parë se të kërkohet dhe bankat tregtare e kanë në dorë të shkruajnë sa më shumë për produktet e tyre, të shpjegojnë qartë të gjitha pjesët përbërëse të kërkesës për kredi (pse jo edhe formatin që kërkohet për planin e biznesit) dhe të ofrojnë të dhëna edhe për gjendjen e tyre financiare.

Çdo klient di të bëjë llogari të thjeshta për leverdisshmërinë e aktivitetit dhe, në njëfarë mënyre, klienti bën edhe “llogaritjen” e fitimit të bankave duke zbritur thjesht interesat e depozitave nga ato të kredive.

Problemeve të mungesës së transparencës në marrëdhëniet biznes bankar- pjesa tjetër e biznesit, u shtohen problemet ligjore që lidhen jo vetëm me mungesën në elementet që plotësojnë marrëdhëniet kontraktore të kreditit, por edhe me garancitë, vendosjen e tyre, çertifikimin dhe ekzekutimin e ndryshimit të pronësisë në rast të pamundësisë për kthimin e borxhit etj..

Kjo është një përmbledhje e diskutimeve dhe e konkluzioneve të nxjerra nga takimet e zhvilluara në kuadrin e fushatës së kreditimit.

Zgjidhja e pikave, që quhen si probleme, nuk mund të jetë e menjëhershme, por rritja e transparencës së marrëdhënieve është në dorën dhe në vullnetin e palëve që hyjnë në biznes kredie. Ndërkohë që realizimet gjatë vitit 2000, kanë treguar se po rritet vazhdimisht bashkëpunimi, bazë për rritjen e aktivitetit në të dyja anët.

Për herë të parë në vitin 2000, niveli i kredisë së re të akorduar nga sistemi bankar është dyshifror, 24 miliardë lekë. Gjendja e kredive, e cila në fillim të vitit 2000 ishte 19,9 miliardë lekë, u rrit mesatarisht çdo muaj me 0,5 miliardë lekë, ndërkohë që kredia e re u akordua me ritme mesatare mujore 2 miliardë lekë. Në terma relativë, gjendja e kredive në sistemin bankar u rrit me rreth 31 për qind në krahasim me vitin 1999.

Kjo rritje bën që pjesa e kredisë për ekonominë në kredinë e brendshme të jetë rritur në 9,9 për qind, në fund të vitit 2000, nga 8 për qind që ishte në fund të vitit 1999.

Tabela 13. Ecuria e treguesve të kreditit (në miliardë lekë).

Treguesit	Dhjetor 1999	Trem. I	Trem. II	Trem. III	Viti 200 Trem. IV
Teprica kredisë në sistemin bankar	19.9	21.4	22.7	25.2	26.1
Nga kjo:					
për sektorin publik	1.7	1.6	1.6	1.6	1.5
për sektorin privat	18.2	19.8	21.1	23.5	24.6
- në lekë	10.6	10.6	10.6	10.6	9.5
- në valutë	9.3	10.8	12.1	14.5	15.1
Kredia e re e sistemit bankar	8.0	3.4	6.9	6.8	6.9
Kredia e re në lekë e sistemit bankar		0.6	1.1	1.0	1.7
Kredia e re në valutë e sistemit bankar		2.8	5.9	5.8	5.2
Pesha (në %) e kredisë në valutë		82.0	85.5	85.0	75.0

Përsëri, gjatë vitit 2000, u kreditua më shumë në valutë dhe kjo ndër të tjera, shpjegohet me normat më të ulëta të interesit të kredisë në valutë.

Tabela 14. Interesi mesatar i ponderuar në lekë (në përqindje).

	dhjetor'99	mars'00	qershor'00	shtator'00	dhjetor'00
Për depozitat e pranuar	9.44	8.32	7.98	7.56	7.09
Për kreditë e akorduara	25.46	25.48	19.78	26.13	23.56

Ndërsa kredia në valutë jepet me norma interesi:

- për dollarin amerikan nga 6.5 në 12 për qind;
- për liritën italiane dhe dhrahminë greke nga 9 deri në 12 për qind.

Çdo llogaritje e thjeshtë arithmetike do të vërtetonte faktin e dukshëm të shpenzimeve më të vogla të biznesit po të marrë kredi në valutë, ndërkohë që bankat, që lejohen të japin kredi, kanë një bazë më të madhe pasivesh në valutë dhe detyrimet që kanë në lekë i investojnë në kredi për financimin e deficitit buxhetor, të garantuara me bono thesari.

Nga tabela e mësipërme e treguesve të kreditit shihet se, njëlloj si në vitin 1999, tremujori i parë karakterizohet nga një aktivitet më i vogël kreditues i bankave, në krahasim me tre tremujorët e tjerë të vitit.

Tabela 15. Pesha specifike e bankave në kredinë e re të akorduar (në %).

Treguesi	Viti '99	Mars '00	Qershor '00	Shtator '00	Dhjetor '00	Totali '00
Si sistem bankar	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Banka Italo Shqiptare	28.5	23.2	44.9	34.8	33.9	36.0
Banka Tirana	32.4	29.4	12.3	14.5	19.5	17.5
Banka Fefad	11.9	14.7	19.7	16.8	16.9	17.5
Banka Alfa Kredit	7.0	23.5	11.6	8.7	10.3	12.0
Banka Amerikane	5.0	2.9	8.7	18.8	11.1	11.4
Banka Tregtare Ndërkombëtare	11.3	5.9	1.4	2.9	3.2	2.9
Banka Kombëtare Greke	0.5	0.3	0.6	1.4	0.7	0.8
Banka Ndërtregtare	-	-	0.4	0.3	1.3	0.6
Banka Arabe Islamike	-	-	-	0.3	0.6	0.2
Banka Dardania	-	-	0.3	1.3	-	0.5
Banka e Kursimeve	1.0	-	-	0.1	2.4	0.7
Banka Kombëtare Tregtare	2.5	-	-	-	-	-

Këtë vit kanë filluar të japin kredi edhe tre banka, që nuk e kanë ushtruar këtë aktivitet gjatë vitit 1999. Aktiviteti kreditues gjatë vitit 2000 është drejtuar disi më shumë në kredi afatmesme dhe afatgjata, duke arritur si gjendje në fund të vitit në:

- ✍ kredi afatshkurtër 11,7 miliardë lekë;
- ✍ kredi afatmesme 8,1 miliardë lekë;
- ✍ kredi afatgjatë 6,4 miliardë lekë.

Kredia e re, e dhënë gjatë vitit 2000, ka mbështetur, thuajse tërësisht, sektorin privat të ekonomisë, duke evidentuar vetëm pak raste për sektorin publik. Aktivitetet që regjistrohen si më të kredituarat pasqyrohen në bilancet e bankave tregtare në fund të vitit 2000 si:

- ✍ tregti, riparim automjesh dhe artikuj shtëpiakë 26,71 për qind;
- ✍ ndërtim (lëndë e parë ndihmëse, aktivitet) 25,05 për qind;
- ✍ industri përpunuese 16,87 për qind;
- ✍ prodhim, shpërndarje energjie, gazi dhe uji 9,00 për qind;
- ✍ etj. 22,37 për qind.

Box 9. Vrojtimi për aktivitetin kreditues, dhjetor 2000.

Banka e Shqipërisë²⁵, në vijim të ndjekjes së aktivitetit kreditues, të nivelit të kreditimit si edhe rëndësisë që ai paraqet për zhvillimin në tërësi të vendit, realizoi një vrojtım, pranë specialistëve të kreditit në bankat e nivelit të dytë. Me anë të tij u mundësua vjelja e opinioneve, cilësisht profesionale të tyre mbi aktivitetin kreditues.

Opinionet e specialistëve janë të konsoliduara mbi shkallën e rrezikut në procesin e kredidhënies. Kështu, rreziku vlerësohet nga specialistët të luhatet në kufijtë mesatarë deri të lartë.

Si i tillë, ai identifikohet ndër faktorët kryesorë që ndikon në:

- nivelin e normës së interesit për kredinë;
- strukturën e kredidhënies sipas maturimit, madhësisë së bizneseve, llojit të monedhave dhe aktiviteteve ekonomike.

Rreth 70 për qind e specialistëve shprehen se nivelet e larta të rrezikut në kredidhënie lidhen, kryesisht:

- me situatën e brishtë politiko-ekonomike në të cilën gjendet vendi;
- me mungesat në kuadrin ligjor dhe moszbatimin e sanksioneve mbi kolateralin;
- me ekzistencën e konkurrencës së pandershme, të kontrabandës dhe të korrupsionit.

Nga opinionet e specialistëve dalin qartë preferencat e tyre për:

- kredinë afatshkurtër dhe afatmesme: përkatësisht 83 për qind dhe 72 për qind e të intervistuarve shprehen për këto dy lloje kredish. Ndërkohë, rezulton se kredia afatgjatë akordohet nga bankat në nivel më të lartë se sa ato do të donin, për shkak të presionit që ushtron kërkesa për këtë lloj kredie. Preferenca drejt kredive afatshkurtra arsyetohet me mundësinë më të madhe për ndjekje të vazhdueshme dhe operative të tyre;

- kredinë në monedhë të huaj (100 për qind e të intervistuarve). Deklarohet se 71 për qind e bankave akordojnë kredi në dollarë amerikanë dhe 53 për qind e tyre në marka. Preferohen kreditë në monedhë të huaj, për shkak të qëndrueshmërisë së konsiderueshme krahasuar me lekun. Gjithashtu, tendenca e theksuar drejt monedhave të huaja në kredidhënie kushtëzohet edhe nga preferenca e klientëve dhe ekzistenca e pasiveve (depozita e kapital) në valutë;

- kredinë në sektorët e: tregtisë (100 për qind e të intervistuarve), industrisë (61 për qind e të intervistuarve), ndërtimit (30 për qind e të intervistuarve). Këta sektorë preferohen për shkak të intensitetit dhe të rendimentit të kënaqshëm që paraqesin. Vlen të theksohet se bujqësia, në një numër të konsideruar rastesh (7 raste) nuk kreditohet fare, megjithë peshën e madhe në PBB.

Specialistët e kreditit shprehen se, në tërësi, janë realizuar planet e bankave për kreditim.

- Në vitin 2000, krahasuar me vitin 1999 është ulur pesha e bankave, që nuk akordojnë kredi me 7 për qind (nga 33 në 26 për qind).
- Për të njëjtën periudhë, konstatohet të jetë rritur pesha e bankave, që kanë realizuar dhe tejkaluar planin e kredisë me 19 për qind.
- Shpesh mosrealizimet në planet e kredive, sidomos në rrethe, janë arsyetuar me mungesat e theksuara të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, edhe tejkalimet do të kishin qenë më të spikatura, nëse furnizimi me energji elektrike do të bëhej normal.
- Norma e interesit për kredinë, sipas specialistëve, është përfaqësuese e tregut në 63.2 për qind të të intervistuarve, megjithatë, ajo shfaq tendencë për të arritur nivele më të ulëta.

²⁵ Vrojtimi është realizuar nga Banka e Shqipërisë me specialistë të kreditit të bankave të nivelit të dytë gjatë muajit dhjetor 2000. Për rezultatet e plota të vrojtimit shih : Buletini Ekonomik, vëllimi 4, numër 1, mars 2001.

Bizneset, gjatë procesit të kërimit të kredive pranë bankave, paraqesin një varg problemesh dhe mangësish, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndikojnë në uljen e nivelit të kreditimit. Kështu, specialistët janë të konsoliduar në opinionin e tyre se,

- mungesa e traditës në marrëdhëniet me bankat;
- bilancet joreale;
- argumentimi i pamjaftueshëm i planeve të biznesit;
- mosnjohja e plotë e kërkesave të bankës;
- mosnjohja e legjislacionit;
- mungesa e aftësive administrative tek bizneset;

janë pikat më të dobëta të bizneseve. Ndër to, ata vlerësojnë si më të rëndësishmen, traditën e varfër në marrëdhëniet bankë-biznes si edhe bilancet joreale që ata paraqesin.

E ardhmja e afërt e procesit kreditues në këndvështrimin e specialistëve, vlerësohet të jetë optimiste. Ata shprehen se më shumë të kredituar do të jenë aktiviteti i industrisë dhe i ndërtimit, ndërsa tregtia do të kreditohet me ritme më të ulëta. Dy sektorë shumë të rëndësishëm për ekonominë, bujqësia dhe transporti, do të vazhdojnë të qëndrojnë në hije të këtij procesi.

2.2. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

2.2.1. NORMAT E INTERESIT.

Viti 2000 konsiderohet si një vit tranzitor përse i përket përdorimit të instrumenteve për zbatimin e politikës monetare që ka ndjekur Banka e Shqipërisë. Gjatë këtij viti Banka e Shqipërisë realizoi gradualisht kalimin e plotë nga përdorimi i instrumenteve direkte të politikës monetare në instrumente të tregut. Konkretisht, banka qendrore, gjatë vitit 2000, pas katër uljeve të nivelit dysHEME të interesave të depozitave me afat në lekë për bankat me kapital tërësisht shtetëror, hoqi dorë nga përcaktimi i mëtejshëm i këtyre niveleve, duke realizuar liberalizimin e plotë të tyre.

Norma e parë që u liberalizua (në muajin maj 2000) ishte ajo e depozitave gjashtëmujore. Vendimi për liberalizimin e kësaj norme, përpara asaj të depozitave dymbëdhjetëmujore, u mor për arsye të peshës së vogël që zinin këto depozita në treg. Pësha jo e konsiderueshme e këtyre depozitave u vlerësua se nuk do të ndihmonte përhapjen e efekteve negative, që mund të rezultojnë si pasojë e kësaj strategjie. Pas këtij testimi që iu bë tregut, Banka e Shqipërisë, duke analizuar ecurinë e treguesve më të rëndësishëm makroekonomikë dhe financiarë në vend, vazhdoi të ulte nivelin minimal të normës së interesit për dy llojet e tjera të depozitave. Për pasojë, në muajin qershor ky nivel rezultoi 6.5 për qind për depozitat tremujore dhe 7.75 për qind për depozitat dymbëdhjetëmujore. Në muajt korrik dhe shtator, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, u hoqën përkatësisht niveli minimal i normës së interesit për depozitat me afat dymbëdhjetëmujor dhe tremujor.

Liberalizimi i interesave për depozitat me afat në lekë për bankat me kapital tërësisht shtetëror, u vlerësua se nuk do të krijonte shqetësime në treg, për shkak të përshpejtimit të reformës financiare në vend sidomos në drejtim të masave të mëposhtme:

- ✍ ristrukturimi i shpejtë i sistemit bankar shqiptar duke synuar fuqizimin dhe rritjen e kapacitetit administrues të bankave dhe një konkurrencë sa më të drejtë në treg. Këtu përfshihet, gjithashtu, puna e kujdesshme, e bërë nga Banka e Shqipërisë, për të krijuar një sistem të shëndoshë, nga njëra anë, përmes hapjes së bankave të reja dhe zgjerimit të tyre dhe, nga ana tjetër, nëpërmjet privatizimit të bankave me kapital shtetëror;
- ✍ forcimi i aftësive të mbikëqyrjes bankare dhe plotësimi i kuadrit rregullativ, të cilët përbëjnë një mbështetje të fuqishme për përdorimin e instrumenteve indirekte në treg me kosto të ulët. Kështu, kërkesa për kapitalin minimal, standardet për provigjonet e huave të dyshimta, kufijtë në përqëndrimin e huave dhe mekanizma të tjerë detyrues janë konsideruar si elemente që e mbështesin procesin e liberalizimit;
- ✍ përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të pagesave dhe shlyerjeve, i kuadrit ligjor dhe rregullativ të tregut, i futjes së instrumenteve dhe teknikave të tregut, si repo-t dhe marrëveshjet e anasjellta të repo-ve, dhe së fundi ankandet e marrëveshjeve të riblerjes, të gjitha këto si pjesë të infrastrukturës së tregut;

- ✍ realizimi i ankandeve të marrëveshjeve të riblerjes për letrat me vlerë të qeverisë përbën fillimin e zhvillimit të tregjeve financiare. Ky aktivitet i jep Bankës së Shqipërisë më shumë fleksibilitet në administrimin e operacioneve monetare, duke ndihmuar në zhvillimin e tregjeve dhe të kontrollit monetar;
- ✍ rritjes së transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut, të bankave dhe të tregjeve duke rritur nivelin e komunikimit të Bankës së Shqipërisë me to.

Analizat dhe vërtetimet e bëra gjatë vitit 2000 treguan se, uljet e njëpasnjëshme të nivelit minimal të interesave për depozitat me afat në lekë, nga ana e Bankës së Shqipërisë nuk gjetën pasqyrimin e duhur në interesat e tjera të tregut. Ky fakt vërtetoi se niveli i interesave për depozitat me afat në lekë nuk ishte më efektiv në drejtim të lëvizjes së normave të tjera në tregun bankar. Për pasojë, pavarësisht nga veprimet e matura dhe kujdesi, që u tregua nga Banka e Shqipërisë në ndryshimin e normave të interesit për depozitat me afat në lekë, doli si domosdoshmëri kalimi në një normë tjetër interesi, që do të shërbente si bazë për rregullimin e normave të tjera të tregut.

Operacionet e tregut të hapur në formën e ankandeve të letrave me vlerë të qeverisë synojnë të rrisin shkallën e fleksibilitetit të normave të interesit. Në hapin e parë, ankandet e marrëveshjeve të riblerjes tentojnë të sigurojnë një formë efektive për të injektuar ose për të thithur shumën e dëshiruar të fondeve në rrugën e tregut, duke rritur efektivitetin e ndërmjetësimit financiar. Gjithashtu, ndërhyrja në treg e Bankës së Shqipërisë, përmes normës së përcaktuar në ankandet e repo-ve duke filluar që nga muaji korrik 2000, ka synuar uljen e nivelit të interesave të tregut në përputhje me lëvizjen e inflacionit dhe të zhvillimeve të tjera monetare dhe ekonomike. Për këtë arsye, analiza e mëposhtme krahason ecurinë e normave të interesit të depozitave, të bonove të thesarit dhe të kredive me ecurinë e normave të repo-ve me maturim njëjavor gjatë periudhës shtator-dhjetor 2000.


Nga një vështrim mbi ecurinë e normave të interesit në ekonomi arrihet në përfundimin që, gjatë vitit 2000, tendenca në përgjithësi ka qenë reduktimi i tyre. Pra, është arritur që nga ana e Bankës së Shqipërisë të përçohen në treg sinjalet për politikën e saj mbi normat e interesit dhe kjo politikë të gjejë zbatim. Nëse analizohet, më në detaje, ndryshimi i normave të interesit nga një muaj në tjetrin vërehet se tendenca rënëse nuk është e pastër. Ajo shfaqet më e fortë në disa lloje normash dhe më e dobët në të tjerat dhe rëniet e normave të interesit në ekonomi kanë ndjekur vendimet apo reagimet e Bankës së Shqipërisë në periudha kohore nga më të ndryshmet.

Duhet theksuar që kur flasim për norma interesi në ekonomi, në fakt, vëmendja përqëndrohet në një grup të vogël normash të përbëra nga norma për depozitat me afat, *yield*-i i bonove të thesarit, i repo-ve dhe norma për kreditë. Gjithashtu, këto norma i referohen kryesisht afateve të shkurtra (deri në një vit). Vetëm për aktivitetin kreditues deklarohen norma mbi një vit. Është theksuar disa herë që mungesa e tregjeve në Shqipëri bën që të mos kemi një mekanizëm eficient transmissiion të vendimeve për politikën monetare.

Por, kjo mungesë tregjesh kufizon edhe “lëndën e parë”, domethënë shumëllojshmërinë e normave, e cila është e nevojshme për të analizuar reagimin e ekonomisë në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë, pritshmërinë apo shkallën e rrezikut të aktiviteteve ekonomike. Një tjetër mangësi, që krijohet në kryerjen e një analize reale të sjelljes së normave të interesit në ekonomi, është edhe ekzistenca e një tregu bankar të dominuar nga një bankë shtetërore. Kjo deformon këtë sjellje dhe nuk lejon zbulimin e normës së vërtetë të tregut.

2.2.1.1. NORMA E INTERESIT PËR DEPOZITAT ME AFAT NË LEKË.

Niveli i normës së interesit për depozitat përcakton koston e burimeve (pasiveve) të një banke apo të sistemit bankar. Në vitin 2000, si rregull, kjo kosto ka ardhur duke u reduktuar sepse dhe norma përkatëse ka ardhur në rënie për të tre maturimet (shih grafikun 15).



Grafiku 20. Përqindja e interesit për depozitat në lekë (përqindje vjetore).

Nga krahasimi i niveleve të normës mesatare të interesit në fillim dhe në fund të vitit reduktimi është i lehtë me 1.2, 2 dhe 2.1 pikë përqindjeje përkatësisht për depozitat me afate maturimi dymbëdhjetë, gjashtë dhe tremujore. Reduktimi më i lartë në normat më afatshkurtra ka bërë që të ndryshojë edhe struktura e normave që ofron tregu bankar për depozitat. Nëse në fillim të vitit norma më e lartë ishte për depozitat me afat gjashtëmujor dhe më e ulët për ato me maturim njëvjeçar, në fund të vitit është depozita njëvjeçare, që ka normën më të lartë dhe ajo tremujore, që ka normën më të ulët.


Kjo tregon që normat e interesit për depozitat janë orientuar më mirë për të pasqyruar më saktë dhe kompensuar rrezikun që shtohet në çdo investim, pra edhe në vendosjen e depozitave, me rritjen e afatit të maturimit.

Tabela 16. Interesi mesatar i depozitave me afat në lekë të pranuar gjatë vitit 2000 (në %).

Muajt	12-mujore	6-mujore	3-mujore
Janar	8.9	9.5	9.0
Shkurt	8.6	8.9	8.2
Mars	8.6	8.8	8.1
Prill	8.6	8.9	8.1
Mai	8.6	8.8	8.1
Qershor	8.3	8.2	7.8
Korrik	7.8	8.2	7.4
Gusht	7.8	8.2	7.4
Shtator	8.2	8.2	7.3
Tetor	8.1	7.9	7.2
Nëntor	7.8	7.8	6.9
Dhjetor	7.7	7.5	6.9

2.2.1.2. YIELD-I I BONOVE TË THESARIT.

Ecuria e *yield*-it të bonove të thesarit shfaq disa karakteristika të ngjashme me ecurinë e normës së depozitave me afat në lekë. Pavarësisht, se kur flasim për *yield*-in jemi zhvendosur në anën e aktivitetit të bilancit, pra në një tregues të të ardhurave të sistemit bankar, analizimi i tij në krahasim me normën e depozitave merr rëndësi në rastin e sistemit bankar shqiptar sepse:



Grafiku 21. Diferenca midis *yield*-it të bonove dhe normave të depozitave me afat (janar 2000 - dhjetor 2000)

- bonot e thesarit përfaqësojnë të vetmin lloj të letrës me vlerë ku mund të investojnë bankat në Shqipëri, sidomos pasivët e tyre në lekë;
- bonot e thesarit përfaqësojnë aktualisht grupin kryesor të aktiveve të sistemit bankar.

Në këtë mënyrë ato përbënë dhe burimin kryesor për sigurimin e të ardhurave të nevojshme në lekë për të mbuluar koston e depozitave. Kështu, njësoj si norma e interesit për depozitat, edhe *yield*-i i bonove të thesarit ka shfaqur tendencë rënëse për të treja maturitetet. Tendenca është më e theksuar për bonot me maturim tremujor. Por, në ndryshim nga normat e depozitave, tendenca rënëse e *yield*-it është më e fortë, me 3.4, 3.9 dhe 7.1 pikë përqindjeje përkatësisht për bonot me afat maturimi dymbëdhjetë, gjashtë dhe tremujor.

Tabela 17. *Yield*-i mesatar i bonove të thesarit gjatë vitit 2000 (në %).

<i>Muajt</i>	12-mujore	6-mujore	3-mujore
Janar	15.7	15.2	14.9
Shkurt	15.5	14.7	13.4
Mars	15.5	14.2	13.0
Prill	15.2	14.1	12.8
Maj	14.2	13.6	12.0
Oershor	14.0	13.1	10.7
Korrik	13.8	12.2	10.2
Gusht	13.5	12.3	9.6
Shtator	13.4	11.8	8.6
Tetor	12.6	11.4	8.0
Nëntor	12.3	11.3	7.8
Dhjetor	12.3	11.3	7.8

Kjo ka çuar në reduktimin e diferencës midis dy normave përkatëse. Madje, për normat tremujore, në fund të vitit 2000, diferenca është vetëm 0.9 pikë përqindjeje. Këto të dhëna sugjerojnë që sistemi bankar po ballafaqohet me një ngushtim të hapësirës për të krijuar fitim “të lehtë” dhe do t’i duhet të gjejë të tjera investime për pasivet në lekë.

Arsyeja kryesore për këtë veçanti, të manifestuar nga *yield*-i në krahasim me normën e depozitës është konkurrenca më e lartë në tregun e bonove të thesarit. Nëse në tregun e depozitave “ekskluzivitetin” e kanë bankat tregtare, në tregun e bonove të thesarit marrin pjesë institucione financiare apo individë. E pranishme në këtë treg është edhe Banka e Shqipërisë (shih grafikun 14).

Tabela 18. Diferenca midis *yield*-it të bonove të thesarit me interesin e depozitave (në pikë përqindjeje).

<i>Muajt</i>	12-mujore	6-mujore	3-mujore
Janar 2000	6.8	5.7	5.9
Dhjetor 2000	4.6	3.8	0.9

2.2.1.3. NORMA MESATARE E INTERESIT TË PRANUAR NË ANKANDET E REPO-VE.

Kjo lloj norme u shfaq në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2000, por për shkak të rolit të normës së referimit, ajo gjithmonë e më tepër do të tërheqë vëmendjen për analiza. Tendanca e saj ka qenë e ndryshueshme në pasqyrim të nivelit të rezervave të tepërta në tregun bankar.

Tabela 19. Yield-i ankandit për vitin 2000 (në %).

<i>Muajt</i>	<i>Yield-i</i>
Gusht	6.7
Shtator	5.3
Tetor	4.6
Nëntor	6.2
Dhjetor	6.5

Banka e Shqipërisë i ka dhënë sinjalet në treg nëpërmjet normës maksimale të ofruar nëpër ankande. Kjo normë ka shfaqur tendencë të pastër zbritëse për të arritur në fund të vitit në 6.5 për qind ose 2.5 pikë përqindjeje më pak se norma e ofruar në ankandin e datës 27 korrik.

Tabela 20. Norma maksimale e ofruar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2000 (në %).

<i>Data e ankandit</i>	<i>Yield-i i ofruar</i>
27 korrik	9.0
3 gusht	7.5
10 gusht	7.45
17 gusht	7.3
31 gusht	7.0
7 shtator	6.9
14 shtator	6.9
28 shtator	6.9
5 tetor	6.5
12 tetor	6.5
19 tetor	6.5
26 tetor	6.5
2 nëntor	6.5
9 nëntor	6.5
16 nëntor	6.5
23 nëntor	6.5
30 nëntor	6.5
7 dhjetor	6.5
14 dhjetor	6.5
21 dhjetor	6.5
28 dhjetor	6.5

Siç shihet, norma maksimale e ofruar ka qenë konstante nga fillimi i tetorit dhe është reduktuar ndjeshëm gjatë periudhës njëmuajore, 27 korrik-31 gusht. Praktikisht, 80 për qind e reduktimit i takon këtij muaji. Kjo nuk është tregues i ndonjë ndryshimi drastik të situatës në tregun bankar shqiptar. Ajo pasqyron faktin që ky instrument u përdor për herë të parë në vitin 2000 dhe muaji i parë, mbi të gjithë muajt e tjerë, ishte periudha e testimit të reagimit të tregut nga ana e Bankës së Shqipërisë.

2.2.1.4. NORMA E INTERESIT PËR KREDITË.

Norma e interesit për kredinë, normalisht, është më e lartë se sa për normat e përshkruara më sipër, për shkak të shtimit të rrezikut në këtë aktivitet. Por, gjatë vitit 2000, kjo normë ka qenë tepër më e lartë. Në këtë mënyrë, kreditë në lekë të ofruara nga bankat kanë patur një kosto të konsiderueshme. Ecuria e kësaj norme nuk ndjek ndonjë rregullsi. Nëse krahasohen fillimi dhe fundi i vitit vërejmë që interesi për kreditë është reduktuar për periudhat e maturimit 6 muaj deri në një vit dhe një deri në tre vjet me përkatësisht 2.5 dhe 2.8 pikë përqindjeje.

Ndërsa për kreditë me afat më të shkurtër maturimi, deri në gjashtë muaj, dhe me afat më të gjatë maturimi, mbi 3 vjet, norma e interesit është rritur me përkatësisht 1 dhe 5.3 pikë përqindjeje.

Tabela 21. Interesi mesatar i kredive të reja të dhëna qatë vitit 2000 (në %).

Muajt	Mbi tre vjet	1-3 vjet	6-12 muaj	deri 6 muaj
Janar	21.69	26.60	26.20	20.16
Shkurt	20.64	26.80	26.70	18.57
Mars	20.00	26.46	26.78	19.44
Prill	24.74	27.64	28.30	19.21
Mai	26.90	23.27	29.00	22.58
Qershor	27.00	27.90	28.70	16.07
Korrik		28.30	27.30	27.80
Gusht	13.20	23.31	29.10	27.95
Shtator	16.15	27.10	27.00	27.00
Tetor	28.70	25.89	19.27	26.56
Nëntor	25.76	23.83	21.46	19.38
Dhjetor	27.00	23.76	23.74	21.17

Më tepër se pasqyrim i kërkesës së shtuar për kredi apo i shtimit të rrezikut për afate të caktuara maturimi, norma e interesit të kredive pasqyron mungesën e konkurrencës në tregun e kredive dhe ofertën e ulët të saj. Oferta e ulët për kredi bën që kjo normë të luhatet edhe nën ndikimin e një banke të vetme, e cila ka vendosur “të ndëshkojë” apo “të gëzojë” klientin e saj me normën e interesit që i ofron apo edhe të një kontrate të vetme kredie. Ndërkohë, mungesa e konkurrencës ndikon në mbajtjen e normave të larta të kredisë nëse i krahasojmë me normat e tjera në ekonomi. Pra, është tepër e qartë që tregu i kredive ka lidhje të dobët me tregjet e tjera që ekzistojnë duke shkëputur funksionimin normal të mekanizmit të transmisionit.

Tabela 22. Diferenca midis përqindje të ndryshme të interesit (në pikë përqindjeje).

Muajt	12-mujore		6-mujore	
	Janar 2000	Dhjetor 2000	Janar 2000	Dhjetor 2000
Kredi-Bono	10.5	11.4	5.0	9.9
Kredi-Depozita	17.3	16.0	10.7	13.7

Box 10. Vrojtim mbi normat e interesit për depozitat.

Duke parë se efekti i politikës së Bankës Shqipërisë në drejtim të uljes së normave të interesit, nuk ishte në nivelin e pritur, u organizuan dy vrojtme me bankat e nivelit të dytë.

Vrojtimi i parë kishte si objektiv të vinte në dukje efektet e politikës së bankës qendrore si edhe të grumbullonte opinionet e bankave tregtare lidhur me politikën e mëtejshme të saj në këtë drejtim. Nga ky vrojtım rezultoi se të gjitha bankat reagojnë në të njëjtin drejtim me vendimet e bankës qendrore për uljen e normave të interesit të depozitave. Me uljen e normave të interesit nga Banka e Shqipërisë, edhe bankat e nivelit të dytë ulin normat përkatëse, por koha e reagimit të bankave është e ndryshme: nga 1 deri në 44 ditë. Ecuria e normës mesatare të interesit për depozitat shfaq tendencë në rënie gjatë gjithë periudhës 1999 - 2000. Norma e interesit e tregut për depozitat në lekë (pa bankat shtetërore) ka qenë, vazhdimisht, më e lartë se minimumi i miratuar nga Banka e Shqipërisë. Në vrojtimin e parë, rreth 58 për qind e bankave u përgjigjën se nuk ka vend për ulje të mëtejshme të normave të interesit. Në 6 shtator të vitit 2000, Banka e Shqipërisë mori vendimin për liberalizimin e plotë të normës së interesit për depozitat me afat në lekë. Vrojtimi i dytë u krye në fillim të muajit nëntor 2000 dhe kishte për qëllim të tregonte efektet e politikës së Bankës së Shqipërisë lidhur me normat e interesit të repo-ve. Rreth 62 për qind e bankave të nivelit të dytë mendojnë se norma e interesit për depozitat ndikohet nga norma mesatare e ankandëve të repo-ve. Nga ky vrojtım rezulton një rritje, prej 4 pikë përqindjeje, në pjesën e bankave që shprehin opinionin se nuk ka vend për ulje të mëtejshme të normës së interesit. Nga 58 për qind në vrojtimin e parë janë rreth 62 për qind e tyre, që shprehin këtë opinion.

2.2.2. REPO, RIFINANCIMI, KREDIA LOMBARD, REZERVA E DETYRUESHME.**2.2.2.1. OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR.**

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2000 marrëveshjet e riblerjeve midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë janë ekzekutuar me procedura dypalëshe. Për t'u përmendur është se ato, kryesisht, janë inicuar nga bankat e nivelit të dytë me qëllim rregullimin e nivelit të likuiditeteve. Duke patur parasysh se sistemi bankar, kryesisht, ka patur likuiditete të tepërta, ato kanë synuar investimin e rezervave të lira për periudha të shkurtra, deri në shtatë ditë, ose thënë ndryshe deri në ankandin më të afërt të rradhës të tregut primar. *Yield*-i i repove ka reflektuar ecurinë e *yield*-it në tregun primar të bonove të thesarit duke dhënë një ndikim pothuajse të pandjeshëm në normat e tjera të tregut të parasë.

Në muajin prill të vitit 2000, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin për kryerjen e marrëveshjeve të riblerjeve me ankande. Në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2000, duke filluar në fund të muajit korrik, Banka e Shqipërisë ka operuar në tregun e parasë me ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe jo më me marrëveshje riblerjeje dypalëshe. Qëllimi i ndryshimit teknik të realizimit praktik të tyre, nga procedura dypalëshe në ankande, ishte krijimi i një norme interesi fleksibël ndaj kushteve të tregut dhe transmetimi eficient i sinjaleve të politikës monetare. Me anë të ankandëve të repove synohej, që nëpërmjet administrimit të rezervave të tepërta të sistemit, të ndërhyhej në normat e interesit të tregut të parasë si dhe në aktivizimin e bankave në treg. Ky instrument i parapriu, njëkohësisht, edhe heqjes së kufizimeve për normat e interesit të depozitave të njoftuara nga Banka e Shqipërisë.

Maturimi i marrëveshjeve të riblerjeve me ankande është shtatë ditë. Ankandet janë zhvilluar të tipit ankande me shumë çmime. Norma dhe shuma e ofruar nga Banka e Shqipërisë është përcaktuar çdo javë, në varësi të situatës së likuiditeteve në sistemin bankar dhe të nevojave të buxhetit të shtetit për likuiditete.

Deri në fund të muajit dhjetor janë kryer 22 ankande të tilla, në të cilat janë ofruar gjithsej 77.6 miliardë lekë. Ankandet e zhvilluara kanë synuar tërheqjen e likuiditetit nga sistemi, duke patur si synim “pilotimin” e normave afatshkurtra të tregut të parasë. Nëpërmjet njoftimit të normës maksimale të interesit të ankandit, Banka e Shqipërisë ka transmetuar në treg sinjale të qarta në lidhje me politikën e saj për normat e interesit dhe rritjen e presionit të saj për uljen e interesave në tregun e parasë.

Vlen të përmendet fakti se, gjatë vitit 2000, normat e interesit në tregun primar të bonove të thesarit janë ulur ndjeshëm. Kështu, në fund të vitit 2000 këto norma ishin në nivelet 7.83 për qind, 11.34 për qind dhe 12.32 për qind respektivisht për afatet e maturimit tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë mujore, krahasuar me nivelet respektive 14.86 për qind, 15.39 për qind dhe 15.73 për qind të fillimvitit.

2.2.2.2. KREDIA E RIFINANCIMIT DHE LOMBARD.

Rifinancimi dhe kredia lombard nënkuptojnë huadhënien nga Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë, duke e garantuar me mjetet për sigurimin e detyrimit. Gjatë vitit 2000 ato nuk janë aplikuar asnjëherë nga Banka e Shqipërisë.

2.2.3. PËRSOSJA E INSTRUMENTEVE TË POLITIKËS MONETARE GJATË VITIT 2000.

Bazuar në përvojën e fituar gjatë vitit 2000 në lidhje me instrumentet e politikës monetare dhe për të përsosur përdorimin e tyre në vitin 2001, në muajin dhjetor, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi një paketë rregulloresh për kuadrin e këtyre instrumenteve. Zbatimi i rregulloreve të reja vlerësohet të rrisë efikasitetin dhe fleksibilitetin në zbatimin e politikës monetare në të ardhmen.

2.3. TREGJET

2.3.1. TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE.

Gjatë vitit 2000, pjesa më e madhe e lëvizjeve në kursin e këmbimit të lekut, është ndikuar nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të këmbimit, si shenjë e ndërveprimit të zhvillimeve të tregut të brendshëm të këmbimeve valutore me zhvillimet ndërkombëtare. Në përgjithësi, kjo mund të interpretohet si tregues i rritjes së ndjeshmërisë së bankave ndaj zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare, dhe rritje e shpejtësisë së reagimit të tyre, për mbylljen e diferencave që mund të ekzistojnë në kurset e këmbimit.

Kundrejt Euro-s, Leku është mbiçmuar. Vlera nominale e raportit EUR/LEK u çel, në fillim të vitit, në nivelin 137.3 (DEM/LEK=70.2) dhe u mbyll, në fund të muajit dhjetor në nivelin 131.2 (DEM/LEK=67.1). I shprehur në terma relativë, mbiçmimi i Lekut ishte 4.6 për qind. Siç mund të kuptohet, në të njëjtën masë Leku është mbiçmuar ndaj të gjithë nënfishave të tjerë të Euro-s. Kundrejt Dhrahmisë Greke (GRD), e cila me anëtarësimin e Greqisë në Bashkimin Monetar European duke filluar nga data 1 janar 2001, është shndërruar në një nënfish të Euro-s, Leku është mbiçmuar në masën 7.1 për qind. Kundrejt USD, Leku u nënçmua. Në fillim të vitit vlera nominale e raportit USD/LEK ishte në nivelin 135.2, ndërsa në fund të muajit dhjetor, ky raport ishte 143.5. Në terma relativë, Leku është nënçmuar në këmbimin me USD, në masën 6.1 për qind.

Mbiçmimi i Lekut ndaj Euro-s dhe nënçmimi i njëkohshëm ndaj dollarit amerikanë, ka reflektuar ecurinë e këtyre dy monedhave në tregjet ndërkombëtare të këmbimit, gjatë vitit 2000. Deri në fund të muajit dhjetor, vlerësohet që monedha europiane të ketë humbur rreth 10.6 për qind të vlerës së saj në këmbimin me dollarin amerikanë. Lëvizjet në kursin e këmbimit të Lekut, gjatë vitit 2000, kanë qenë graduale dhe të balancuara. Për të siguruar një gjë të tillë, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në treg, veçanërisht në periudhën korrik - tetor, kur ndikimet sezonale me efekte mbiçmuese në kursin e këmbimit të Lekut, janë të pritshme. Gjatë kësaj periudhe, janë blerë nga sistemi bankar, rreth 35.36 milionë dollarë, ose afërsisht 97 për qind e të gjithë sasisë së blerë gjatë vitit 2000 prej 36.48 milionë dollarësh. Për vitin 2001, presim që kursi i këmbimit të Lekut të vazhdojë të jetë i qëndrueshëm, me lëvizje të balancuara që do të përthithen lehtë nga ekonomia. Banka e Shqipërisë do të jetë e gatshme që të sigurojë këtë ecuri.

2.3.2. TREGU I PARASË.


Nëpërmjet këtyre operacioneve, Banka e Shqipërisë disponon një instrument i cili i lejon një banke qendrore të ndikojë mbi situatën e likuiditetit në treg, në varësi të objektivave të saj monetarë. Këto operacione, përdoren si një instrument standard nga të gjitha bankat qendrore në vendet me ekonomi të zhvilluara. Operacionet e tregut të hapur të Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2000, u përqëndruan në përdorimin e instrumentit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltës të riblerjes me marrëdhënie dypalëshe (në gjysmën e parë të vitit) dhe në formën e ankandeve (në gjysmën e dytë të tij).

Miratimi i rregullores për ankandet e marrëveshjeve të riblerjes, në prill të vitit 2000, dhe organizimi e zhvillimi i tyre, për herë të parë, në fund të muajit korrik 2000, i parapriu liberalizimit të plotë të normave të interesit për depozitat në bankat me kapital tërësisht shtetëror dhe përgatitjes për kalimin nga instrumentet direkte në ato indirekte të politikës monetare.

Kalimi në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes ka si qëllim të realizojë:

1. transmetimin e vendimeve të Bankës së Shqipërisë në sferën e politikës monetare, në mënyrë të plotë, të njëkohëshme dhe të njëtrajtshme, tek të gjithë operatorët e tregut ndërbankar dhe më gjerë;
2. ndikimin mbi normën e interesit në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe nëpërmjet saj, ndikimin mbi normën e interesit të depozitave në sistemin bankar;
3. zhvillimin e tregut ndërbankar të parasë.

Duke patur parasysh objektivat e mësipërm, Banka e Shqipërisë ka shfrytëzuar ankandet e marrëveshjeve të riblerjes për të ndikuar mbi nivelin e likuiditetit në tregun ndërbankar.



Grafiku 22. Përqindja në ankandet e repove (numri i ankandëve në boshtin e X-ve).

Ndonëse deri tani, ankandi ka shfaqur një mundësi për investimin nga bankat tregtare të rezervave të tyre likuide, Banka e Shqipërisë ka ndryshuar shumë e pranuar për pjesëmarrje nga bankat, duke bërë që efekti neto i ankandit të jetë në shtim ose në pakësim të gjendjes së likuiditetit të tregut ndërbankar, sipas situatës së krijuar.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2000, janë zhvilluar marrëveshje riblerjeje (në të cilat Banka e Shqipërisë ka dhënë hua bono thesari kundrejt fondeve në Lekë) në masën 117,958 milionë lekë. 40,658 milionë lekë përfaqësojnë marrëveshje riblerjeje të zhvilluara me bankat e nivelit të dytë në marrëdhënie dypalëshe. Sasia prej 77,300 milionë lekësh përfaqëson marrëveshje riblerjeje të zhvilluara përmes ankandit (në gjashtëmujorin e dytë). Pjesëmarrëse në marrëveshjet e riblerjes, në të dyja format, kanë qenë pothuaj të gjitha bankat tregtare, që operojnë në vendin tonë. Banka e Kursimeve, ka patur peshën më të madhe në të gjitha këto transaksione. Më poshtë është paraqitur shuma e transaksioneve të riblerjes sipas muajve dhe pesha e Bankës së Kursimeve për secilin muaj.

Tabela 23. Operacionet e marrëveshjeve të riblerjes për vitin 2000 (në miliardë lekë).

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Shuma	9.94	4.81	8.60	7.03	5.57	4.71	40.66

**-me ankand*

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Shuma	1.00	4.30	7.00	5.00	36.50	23.50	77.3

**- me marrëdhënie dypalëshe.*

Tabela 24. Pesha e Bankës së Kursimeve në marrëveshjet e riblerjes sipas muajve (në miliardë lekë).


Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
BK	7.15	3.8	7.00	3.50	0.60	2.50	24.55
Në %	71.92	79.00	81.40	49.80	10.77	53.10	60.38

**- me ankand.*

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
BK	0.65	2.53	5.16	3.58	34.06	22.78	68.77
Në %	65.00	58.84	73.73	71.65	93.32	96.96	88.97

**- me marrëdhënie dypalëshe.*

Pesha mesatare e pjesëmarrjes së BK, për vitin 2000, është 79.11 për qind.



Grafiku 23. Shuma e shpallur nga Banka e Shqipërisë (në miliardë lekë).

Duke vështuar më në hollësi ecurinë e ankandeve të riblerjes, vëmë re që në çdo ankand kanë marrë pjesë mesatarisht 5 banka tregtare. Interesi i ofruar nga Banka e Shqipërisë për shumën e pranuar në ankand, ka ardhur në rënie. Fillimisht ai ishte 9 për qind, ndërsa në tremujorin e fundit të vitit është stabilizuar në 6.5 për qind. Në mënyrë grafike, ecuria e normës së interesit të ofruar nga Banka e Shqipërisë, si dhe e normës mesatare të interesit, sipas ankandeve, jepen në grafikun 18. Është bërë kujdes, që sasia e likuiditetit në tregun ndërbankar të jetë e mjaftueshme për realizimin e çdo ankandi, në mënyrë që të ruhej rivaliteti mes bankave tregtare për pjesëmarrje në ankand. Në të njëjtën kohë, shuma e shpallur nga Banka e Shqipërisë për pjesëmarrje ka ardhur në rritje dhe grafikisht ajo paraqitet në grafikun 17.

2.3.3. TREGU NDËRBANKAR.

Në këtë treg, bankat realizojnë marrëveshjet për huamarrjen ose huadhënien e fondeve, për periudha kohore të shkurtra. Gjatë vitit 2000, u vërejt një prirje e bankave për t'iu drejtuar më shumë njëra-tjetrës në plotësimin e nevojave të tyre për likuiditet. Në mënyrë indirekte, kjo nënkupton një rritje të vëllimit të aktivitetit dhe, njëkohësisht, një qëndrim më aktiv në administrimin e portofolit të aseteve të tyre. Të dhënat i referohen periudhës tetor-dhjetor 2000, kur bankave tregtare i është kërkuar të raportojnë veprimet e kryera në këtë treg pranë Bankës së Shqipërisë. Sipas këtyre raportimeve, në këtë periudhë janë kryer 34 transaksione të tregut ndërbankar, në formën e huamarrjes afatshkurtër.

Në 17 raste, Banka e Kursimeve ka qenë huadhënëse e fondeve, pa qenë në asnjë rast huamarrëse. Në 28 raste, Banka Tirana ka qenë huamarrëse e fondeve, pa qenë në asnjë rast huadhënëse. Banka të tjera të pozicionuara si huamarrëse kanë qenë : Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Italo-Shqiptare dhe Banka Amerikane.

Në rolin e huadhënësit, janë pozicionuar të paktën një herë, pothuaj të gjitha bankat. Kohëzgjatja mesatare e këtyre transaksioneve ka qenë 12 ditë, kohëzgjatja minimale ka qenë 1 ditë dhe ajo maksimale 35 ditë. Norma mesatare e interesit të huasë në tregun ndërbankar, ka qenë 6.3 për qind. Kjo vlerë, është mbi nivelin mesatar të normës së interesit të realizuar në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes, prej 5.72 për qind. (Diferenca përfaqëson kthimin e dëshiruar nga Banka e Kursimeve për investimin e fondeve të saj të tepërta, në tregun ndërbankar.) Norma minimale e interesit ka qenë 5 për qind, ndërsa ajo maksimale 9 për qind. Fondet që kanë lëvizur, kapin vlerën 4,655 milionë lekë. Shuma më e madhe për një transaksion të vetëm është 900 milionë lekë, ndërsa më e vogla, 5 milionë lekë. Vlera mesatare për transaksionet e kryera, është 136.9 milionë lekë.

2.3.4. TREGU SEKONDAR.

Në tregun sekondar të bonove të thesarit, ku realizohen blerjet ose shitjet e tyre nga bankat, veprimet kanë qenë tepër të kufizuara në numër dhe në pjesëmarrës. Nëse përjashtojmë nga llogaritjet veprimet në të cilat Banka e Shqipërisë ka qenë palë (3 raste), gjatë vitit 2000 janë zhvilluar 6 transaksione në tregun sekondar. Banka e Kursimeve ka qenë palë në të gjitha këto transaksione, duke u pozicionuar në blerje të bonove të thesarit. Në të gjitha rastet, partneri i Bankës së Kursimeve ka qenë Banka Tirana, e pozicionuar në shitje të letrave me vlerë. Një nivel likuiditeti i bollshëm në Bankën e Kursimeve, si rezultat i zhvillimeve strukturore që kufizojnë mënyrën e investimit të saj, e ka shtyrë atë të kërkojë investimin kryesisht në bono thesari.

Ndërkohë, bankat më të vogla tregtare, me një mënyrë ndërtimi dhe funksionimi më fleksibël dhe me dëshirën për të qenë aktive në tregun e brendshëm të parasë, kanë patur nevojë për fonde likuide në një moment të caktuar. Në të njëjtën kohë, ky numër i ulët i transaksioneve reflekton vlerësimin, që i bëjnë bankat bonove të thesarit, si investime përfundimtare (të cilat preferohen të mbahen deri në maturim).

Kredia e rifinancimit dhe ajo lombard nuk janë përdorur gjatë vitit 2000. Në përgjithësi, situata e likuiditetit të tregut ka qenë e mjaftueshme dhe nevojat e papritura për likuiditet, që mund të jenë shfaqur në një moment të caktuar, janë plotësuar përmes marrëveshjeve, që kanë realizuar bankat mes tyre në formën e huadhënies së kolateralizuar.

Për vitin e ardhshëm, fokusi i aktivitetit do të mbetet në drejtim të zgjerimit të instrumenteve indirekte të politikës monetare dhe të plotësimit të kuadrit rregullator të tyre. Mendojmë se vetëm në këtë mënyrë, do të përmirësohet mekanizmi i transmetimit të vendimeve të politikës monetare në drejtim të zhvillimeve në normën e interesit të tregut si dhe do të rritet aktiviteti i tregut ndërbankar.

2.3.5. TREGU I KAPITALEVE.

2.3.5.1 AKTIVITETI OPERATIV I BURSËS SË TIRANËS.

Viti 2000, për Bursën e Tiranës, shënon vitin e parë nga krijimi, që në sesionet e saj nuk regjistrohet asnjë tregtim. Një fakt i tillë nuk jep mundësi të nxirren tregues dhe të vlerësohet tendenca dhe zhvillimet në të ardhmen në tregun sekondar të bonove të thesarit. Pavarësisht se rregullorja e re mbi procedurën e tregtimit në Bursën e Tiranës është komode për bankat dhe praktikisht e lehtëson dhe e thjeshton këtë procedurë për to, tregu primar ende konkurren fuqishëm tregun e Bursës dhe bankat e preferojnë më shumë atë. Praktikisht, në këtë treg janë ekzekutuar, vetëm për periudhën 14.06.2000 - 07.11.2000, transaksione në vlerën 1,153,374,000 lekë, nga të cilat dy janë transaksione të Bankës së Shqipërisë me Bankën Kombëtare Tregtare, në shumën 103,374,000 lekë. Por, përveç ekzistencës së alternativës së tregut sekondar për shitjen dhe blerjen direkte të bonove të thesarit midis bankave, si shkaqe të tjera për mosfunksionimin e tregut sekondar të bonove të thesarit në Bursën e Tiranës përmendim:

- i. monopolizimi i pronësisë së bonove të thesarit nga një subjekt i vetëm. Sot, Banka e Kursimeve zotëron rreth 75 për qind të totalit të bonove të thesarit të emetuara dhe të pamaturuara;
- ii. niveli i lartë i likuiditeteve në treg. Kjo ka bërë që të gjitha bankat të jenë, pothuaj gjithnjë, të vendosura vetëm në pozicion blerësi pa palë shitëse;
- iii. moskryerja e transaksioneve nga ana e subjekteve jobanka. Pavarësisht nga fakti i licencimit nga Komisioni i Letrave me Vlerë, të një shoqërie private për të operuar si *dealer*, kjo shoqëri nuk ka ekzekutuar asnjë transaksion në Bursën e Tiranës gjatë vitit 2000.

Gjatë vitit 2000, për të tretin vit rresht, nuk u krye asnjë transaksion me obligacionet qeveritare. Shkaqet e një mungese të tillë tregtimi vazhdojnë të mbeten përsëri termat e pafavorshëm të këtyre obligacioneve (konkretisht kuponi i tyre).

Nga ana tjetër, në Bursën e Tiranës ende nuk është kuotuar asnjë aksion i ndonjë shoqërie aksionere. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve cilësorë të kuotimit në bursë, si: aftësi të spikatura në administrim e prodhim raportesh financiare cilësore e transparente; mosekzistencës, në shumë raste, të një pozite të shëndoshë financiare të ndërmarrjeve; apo mosinteresimit të këtyre të fundit për të listuar aksionet e tyre në listën zyrtare të Bursës së Tiranës dhe rrjedhimisht, i mosdëshirës së tyre për t'u kthyer në shoqëri aksionere publike e për të ngritur kapital nëpërmjet Bursës së Tiranës.

2.3.5.1. REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË VENDOSUR.

Pavarësisht nga situata në të cilën ndodhet Bursa e Tiranës dhe niveli inekzistent i operacioneve në të, për krejt vitin 2000, duhet të theksohet se gjatë këtij viti:

- ✍ U kompletua kuadri bazë rregullator që administron aktivitetin e Bursës së Tiranës, nëpërmjet miratimit nga Bordi Mbikëqyrës i Bursës së Tiranës edhe të disa rregulloreve të tjera (shih box 2-5) si:
 1. rregullorja e komitetit disiplinor të anëtarësimit;
 2. rregullorja e komitetit të listimit; dhe
 3. rregullorja e procedurës së tregtimit në Bursën e Tiranës.
- ✍ Filloi fushata marketing e Bursës së Tiranës, me qëllim promovimin e Bursës së Tiranës dhe njohjen me instrumentet financiare. Konkretisht, u organizuan seminare me punonjësit e Bankës së Shqipërisë, me gazetarët ekonomikë dhe me përfaqësues të biznesit.
- ✍ U organizua takim-diskutimi “Ringjallja e Bursës së Tiranës”, me iniciativën e Bankës së Shqipërisë. Organizimi i këtij takimi diskutimi përbën, pa dyshim, përpjekjen dhe lëvizjen më të rëndësishme në drejtim të bërjes funksionale të Bursës së Tiranës dhe shpërndarjes së kësaj të fundit nga Banka e Shqipërisë. Në fund, takimi i diskutimit doli me disa konkluzione të rëndësishme¹.
- ✍ U organizua takim-diskutimi “Shoqëritë aksionere drejt Bursës së Tiranës”, një bashkëpunim midis Bankës së Shqipërisë dhe Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Në fund takimi i diskutimit doli me disa konkluzione të rëndësishme².
- ✍ U miratua, nga Këshilli i Ministrave, projektligji i ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8080, datë 01.03.1996 “Për letrat me vlerë”, duke i hapur kështu rrugën miratimit të tij nga Kuvendi. Miratimi i këtij projektligji do të çojë në shpërndarjen faktike (juridike) të Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë³.
- ✍ U hartua pyetësori “Biznesi Shqiptar përkundrejt Bursës së Tiranës” dhe u volën të dhënat respektive nga bizneset shqiptare. Qëllimi i këtij pyetësori është kryerja e një vrojtimi mbi gjendjen e biznesit shqiptar, me synim gjetjen e rrugëve dhe të mundësive për tërheqjen e shoqërive shqiptare në tregun e kapitaleve, si një nga alternativat e pashfrytëzuara për rritjen, zgjerimin e aktivitetit dhe efektivitetit të tyre ekonomik.
- ✍ U kryen disa publikime si:
 1. broshura “Bursa e Tiranës dhe Letrat me Vlerë”;
 2. përmbledhja në shqip e rregulloreve të Bursës së Tiranës: “Rregulloret e Bursës së Tiranës”;
 3. përmbledhja dygjuhëshe (shqip-anglisht) e rregulloreve të Bursës së Tiranës: “Rregulloret e Bursës së Tiranës – Rules of Tirana Stock Exchange.

²⁶ Dokumenti i plotë i konkluzioneve të këtij takimi diskutimi paraqitet në aneksin 1 të Raportit Vjetor të Bursës së Tiranës 2000, botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë nr.1, mars 2001.

²⁷ Dokumenti i plotë i konkluzioneve të këtij takimi diskutimi paraqitet në aneksin 2 të Raportit Vjetor të Bursës së Tiranës 2000, botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë nr.1, mars 2001.

²⁸ Në fillim të vitit 2001 ky projektligj u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Të gjithë hapat e ndërmarrë gjatë vitit 2000 si dhe ata, që priten të ndërmerren në të ardhmen do të synojnë arritjen e objektivave finalë madhorë, që janë vitalizimi i aktivitetit të Bursës së Tiranës me produktin bazë, aksionet dhe shkëputjen e saj nga Banka e Shqipërisë e funksionimin si institucion i pavarur.

Kapitulli 3. Mbikëqyrja Bankare

3.1. LICENCIMI DHE RREGULLAT E MBIKËQYRJES

3.1.1. LICENCIMI.

Në vitin 2000 Banka e Shqipërisë nuk ka dhënë licenca për të kryer veprimtari bankare. Numri i bankave që veprojnë në Shqipëri mbeti 13, por është shtuar numri i degëve të këtyre bankave brenda vendit. Gjatë vitit 2000 është paraqitur vetëm një kërkesë për t'u pajisur me licencë për të kryer aktivitet bankar, e cila është në procesin e shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur.

Mbështetur në kuadrin rregullativ, të miratuar për licencimin e subjekteve financiare jobanka në Republikën e Shqipërisë, është licencuar si subjekt financiar jobankë shoqëria Diners Club Albania për kryerjen e ndërmjetësimit për transaksione monetare (përfshi edhe valutat).

Subjekte të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë janë dhe zyrat e këmbimeve valutore, të cilat si edhe bankat marrin licencë të përhershme dhe veprojnë mbështetur në rregulloren "Për veprimtarinë valutore" dhe udhëzimet e saj. Gjatë vitit 2000 janë licencuar 10 zyra të këmbimeve valutore të reja.

Gjatë vitit 2000 në Shqipëri kanë patur licencë për të operuar subjektet e mëposhtme:

- * Banka tregtare - 13.
- * Zyra këmbimi valutor - 20.
- * Subjekte financiare jobanka - 2.

Box 11. Shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK).

Aktualisht, në gjithë vendin, ushtrojnë veprimtarinë e tyre 36 shoqëri kursim-krediti. Shtrirja e aktivitetit të tyre si dhe shqetësimi i vazhdueshëm i Bankës së Shqipërisë për të mos lejuar shfaqjen e fenomeneve të vitit 1997, bëri që të angazhoheshim, së bashku me ekspertët e Bankës Botërore, në ndryshimin e ligjit ekzistues për të përcaktuar qartë pozicionin e Bankës së Shqipërisë. Në bazë të ligjit ekzistues, Banka e Shqipërisë, ka të drejtën të marrë informacione dhe raporte nga këto institucione, por nuk mund t'i mbikëqyrë ato.

Për të eliminuar këtë mangësi, në projektin e ri të ligjit është parashikuar që Banka e Shqipërisë të mbikëqyrë SHKK dhe unionet e tyre në të gjitha aspektet: licencim, rregullim, raportim dhe inspektim në vend.

3.1.2. RREGULLAT E MBIKËQYRJES.

Kuadri rregullativ i mbikëqyrjes bankare është përgjithësisht i plotësuar dhe gjatë vitit 2000 është synuar të përmirësohet nëpërmjet rregullimeve e saktësimeve me qëllimin kryesor, përafrimin me standardet ndërkombëtare për mbikëqyrjen bankare.

Udhëzimi “Për likuiditetin e bankave”. Ky udhëzim zëvendësoi rregulloren përkatëse, e cila u gjykua si shumë e shtrënguar. Udhëzimi u lë më shumë liri gjykimi bankave në drejtim të administrimit të likuiditetit të tyre.

Udhëzimi “Për menaxhimin e riskut të normës së interesit”. U hartua me qëllim që të plotësojë kuadrin rregullativ dhe administrues, duke dhënë edhe disa elemente për mbikëqyrjen e rrezikut të normës së interesit.

Rregullorja “Për normat e mbikëqyrjes të subjekteve jobanka, që ushtrojnë veprimtari financiare”. Vendos disa rregulla mbikëqyrëse në drejtim të mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilësisë së aktiveve, përqendrimit dhe cilësisë së portofolit të kredive dhe likuiditetit.

Rregullorja “Për bankat kooperativë”. Detajon kërkesat e nenit 64 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe trajton procedurat e licencimit dhe të rregullimit të bankave kooperativë.

Ndryshimet në rregulloren “Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja”, që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurave të marrjes së lejes së qëndrimit dhe të punës për administratorët e huaj. Ky ndryshim u bë i domosdoshëm për shkak të vonësive në paraqitjen e dokumentacionit përkatës nga ana e institucioneve përkatëse. Për të anashkaluar këto pengesa, Banka e Shqipërisë, ka të drejtë të japë miratim të përkohshëm, deri në paraqitjen e dokumentit të lejes së punës dhe të qëndrimit. Në rast të kundërt ajo anulon miratimin paraprak.

Vendimi nr.26, datë 29.03.2000 “Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.” Në mbështetje të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë, jo të gjitha subjektet, që kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 26 të tij, i vendos në mbikëqyrjen e saj. Subjektet financiare, që kryejnë aktivitet kredidhënës, origjina e burimeve financiare të cilave rrjedh nga organizata ndërkombëtare apo qeveri të vendeve të tjera në formë ndihme falas, me qëllim zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm në Shqipëri, dhe që nuk zhvillojnë aktivitetin e grumbullimit të depozitave, nuk licencohen dhe nuk mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, por ato vetëm raportojnë lidhur me ecurinë e aktivitetit të tyre. Kështu është vepruar me Fondin e Financimit Rural, që ndihmon ngritjen dhe funksionimin e shoqërive të kursim-kredive, për mbështetjen me kredi të sektorit rural.

Një shtesë në rregulloren “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë” me vendimin nr.43, datë 17.05.2000, lidhur me kriteret për të miratuar hapjen e një dege apo të një filiali të bankës jashtë vendit. Në rregulloren ekzistuese nuk ishin parashikuar kriteret kur Banka e Shqipërisë e jep një miratim të tillë. Interesimi i disa bankave, që veprojnë në Shqipëri për të hapur degë jashtë vendit, bëri të nevojshme shtesat përkatëse në rregullore.

Përmirësimet e kuadrit rregullativ kanë patur për qëllim zbatimin e Parimeve të Komitetit të Bazelit për një mbikëqyrje efektive. Shkalla e zbatimit të këtyre parimeve është vlerësuar disa herë nga misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar për asistencën teknike dhe nga vetë Banka e Shqipërisë. Nga këto vlerësime rezulton se, teknikisht dhe teorikisht, janë zbatuar plotësisht 20 parime ndërsa 5 prej tyre, nga pikëpamja teknike, janë zbatuar pjesërisht ose janë të pazbatueshme. Kjo situatë është pasojë e nivelit aktual të zhvillimit të sistemit bankar në Shqipëri dhe ka të bëjë kryesisht me:

- * aktivitetin e kredidhënies. Bankat që veprojnë në Shqipëri mund t'u japin kredi vetëm klientëve shqiptarë dhe investimet janë të kufizuara në bono thesari të qeverisë. Kështu, deri më sot, nuk është parë e nevojshme të nxirret një rregullore për mbikëqyrjen dhe kontrollin e rrezikut të vendit;
- * aktivitetin e pakonsoliduar. Sistemi ynë bankar përbëhet nga banka dhe degë bankash, të cilat deri më sot nuk kanë krijuar filiale të tyre. Bilanci i tyre është ndërtuar mbi baza individuale dhe, për pasojë, nuk mund të zbatohet parimi i një mbikëqyrjeje të konsoliduar.

3.2. ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Gjendja e përgjithshme e sistemit bankar, gjatë vitit 2000, vlerësohet të jetë relativisht e shëndoshë. Në tërësi, treguesit e sistemit bankar për fundin e vitit janë përmirësuar. Në mënyrë sintetike, këtë ecuri e jep fitimi i realizuar prej 5.4 miliardë lekësh nga 1.2 miliardë lekë që ishte në fund të vitit 1999. Sistemi bankar rezulton me fitim për të dytin vit rradhazi, pas një periudhe katërvjeçare humbjesh (shih grafikun 19).

Ndikimin më të konsiderueshëm në rezultatin financiar të vitit 2000 e ka dhënë grupi i të ardhurave neto nga interesat. Këto të ardhura për vitin 2000 arritën në 8.7 miliardë lekë (nga 5,1 miliardë lekë rezultuar në fundvitin '99 apo 39,3 milionë lekë me humbje, të rezultuar në fundvitin '98). Rritja e ndjeshme e të ardhurave neto nga interesat është rrjedhojë e veprimit të disa faktorëve, ndër të cilët përmendim:

- * Ulja e normave të interesave në ekonomi, si pasojë e politikës së zbatuar nga Banka e Shqipërisë, është pasqyruar me një reduktim më të madh të normave të interesit në pasiv të bilancit se sa normat e interesit në aktiv të tij.
- * Sistemi bankar shqiptar paraqitet me konkurrencë relativisht të dobët gjë që krijon mundësi për mbajtjen e marzheve të larta midis nivelit të normave të interesave.

Megjithatë, në rezultatin financiar kanë ndikuar edhe:

- të ardhurat nga komisionet (neto), që për vitin 2000 arritën në 1,5 miliardë lekë duke zënë 5 për qind të totalit të të ardhurave;
- shpenzimet e veprimtarisë, që përbëjnë rreth 15,8 për qind të shpenzimeve financiare të sistemit bankar. Krahasuar me vitin '99 këto shpenzime janë rritur për 778,8 milionë lekë (24,6 për qind). Vetëm për punonjësit e tij, sistemi bankar ka shpenzuar rreth 1,5 miliardë lekë ose rreth 39,8 për qind të shpenzimeve të veprimtarisë. Për vitin 2000, shpenzimet e personelit janë rritur për 217,4 milionë lekë (16,1 për qind) krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2000, struktura e sistemit bankar pësoi ndryshime. Kështu, bankave me kapital privat ju shtua edhe Banka Kombëtare Tregtare si rezultat i privatizimit të saj. Po në këtë fundviti, Ministria e Financave, në kuadër të masave përgatitore për privatizimin e Bankës së Kursimeve, mbylli humbjat e trashëguara nga vitet e kaluara të kësaj banke, duke bërë të mundur jo vetëm kapitalizimin e saj, por edhe përmirësimin e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit për krejt sistemin bankar. Veprimi i këtij faktori dhe i rritjes së kapitalit të paguar për bankat ekzistuese në 700 milionë lekë brenda muajit mars 2001, ka përmirësuar pozicionin e kapitalit të sistemit bankar.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar rezulton 41,8 për qind nga 8,2 për qind në fundvitin '99. Kapitalizimi është i lartë edhe në grupet e veçanta të bankave dhe konkretisht: 43,4 për qind për grupin e bankave shtetërore, 39,5 për qind për grupin e bankave me kapital të përbashkët dhe 41,8 për qind për grupin e bankave të tjera.

Krahas rritjes së kapitalit, në raportin e mjaftueshmërisë ka ndikuar edhe struktura e aktiveve të sistemit bankar klasifikuar sipas rrezikut. Sistemi bankar edhe në këtë vit paraqitet me investim të përqendruar në aktive pa risk apo me risk të ulët.

Tabela 25. Struktura e aktiveve të klasifikuara sipas shkallës së rrezikut (në përqindje ndaj totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të korrektuara sipas rrezikut).

Treqesi në % ndaj	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Aktive pa rrezik	66.3	82.9	15.1	39.5
Aktive me rrezik të ulët	23.1	13.4	34.6	42.5
Aktive me rrezik të mesëm	1.3	0.1	14.1	1.0
Aktive me rrezik të lartë	9.4	3.5	36.2	17.0

Niveli relativisht i lartë i mjaftueshmërisë së kapitalit (norma e mjaftueshmërisë është 12 për qind) si edhe përqëndrimi i investimeve në aktive pa rrezik ose me rrezik të ulët krijon mundësinë që bankat të zgjerojnë më tej aktivitetin e tyre, sidomos huadhënien.

Dukuri pozitive vërehen edhe në aktivitetin kredidhënës, kryesisht nën ndikimin e aktivitetit të bankave private dhe të përbashkëta. Teprica e kredisë (vlëra neto e saj) në bankat me kapital të përbashkët dhe privat ka pësuar një rritje prej rreth 6,4 miliardë lekësh (krahasuar me fundvitin 1999) dhe kjo, tërësisht, në sektorin privat, përfshi individët. Gjithashtu, në këtë fundviti ndërsa teprica e kredisë rritet rreth 56 për qind (krahasuar me fundvitin 1999) llogaritë dhe depozitat e klientëve janë rritur vetëm 9,7 për qind. Rritja e kredidhënies ka shtuar nivelin e kredive të klasifikuara si të rregullta në 56,2 për qind nga 42,4 për qind që ky tregues rezultonte në vitin 1999 apo 44,5 për qind në vitin 1998.

Tabela 26. Tregues të portofolit të huave (në përqindje ndaj huave të klasifikuara).

Treqesi	G1	G2	G3	Sistemi bankar
1. Huatë e klasifikuara*	100.0	100.0	100.0	100.0
- standarde	12.6	69.3	90.1	58.9
- në ndjekje	1.5	16.0	5.3	7.4
- nënstandarde	4.8	4.0	1.4	3.3
- të dyshimta	2.7	9.1	1.2	4.1
- të humbura	78.4	1.6	2.0	26.2
2. Mbulimi me provigjone	80.9	8.5	5.1	30.3

* Kreditë standarte dhe ato në ndjekje klasifikohen si kredi të rregullta, ndërkohë që tre grupet e tjera të kredive trajtohen si kredi me probleme.

Gjatë vitit 2000, struktura e sistemit bankar pësoi ndryshime në favor të bankave me kapital privat (rezultat i privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare) duke ndikuar disi në zbutjen e dominimit të sistemit bankar nga bankat me kapital tërësisht shtetëror. Ndonëse vazhdon dukuria e segmentimit të aktiviteteve ato paraqiten disi më të zbutura si rezultat i "agresivitetit" që po tregojnë bankat private në zgjerimin e aktivitetit të tyre.

Tabela 27. Pesha e grupeve bankare sipas disa treqesve ndaj totalit të sistemit bankar (në përqindje).

Treqesi	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3
1. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	69,1	4,6	26,3
2. Kapitali aksioner	17,9	13,0	69,1
3. Kredia neto	8,7	40,5	50,7
4. Bono thesari	84,2	1,0	14,8
5. Vendosjet në banka	37,9	9,9	52,2

Tabela 28. Treqes të rentabilitetit në përqindje (viti 2000).

Treqesi	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Sistemi bankar
ROA*	2,9	0,7	0,8	2,1
ROE**	93,7***	3,1	3,6	21,1***
Të ardhurat neto nga interesat / aktiveve mesatare gjithsej	3,6	4,5	2,8	3,4
Shpenzime të veprimtarisë / aktiveve mesatare gjithsej	1,0	2,7	2,4	1,5
Shpenzime për provigjone / aktiveve mesatare gjithsej	-1,7	2,8	0,9	- 0,6

* Kthyeshmëria nga aktivet gjithsej

** Kthyeshmëria nga fondet e veta

*** Treguesi nuk është llogaritur mbi baza mesatare të kapitalit aksioner vetëm për Bankën e Kursimeve për të shmangur vlerën negative e tij. Kjo ka ndikuar edhe në treguesin e sistemit bankar. (Bankës së Kursimeve i janë mbuluar humbjet e viteve të kaluara dhe, për rrjedhojë, kapitali aksioner është në vlera pozitive.)


**Grafiku 24. Tregues të rentabilitetit (në përqindje).**

Tabela 29. Tregues për sistemin bankar.

Bankat ²⁹	Nr. i degëve	Kapitali i paguar/Totali i bilancit (%)	depozitave/Totali i bilancit (%)	Totali i Totali i kredive (neto)/ Totali i bilancit (%)	Kredi me probleme/ Totali i kredive (%)	Bono thesari në % ndaj sistemit bankar
Grupi i parë						
1. Banka e Kursimeve	26	2,8	69,3	27,1	87,7	84,2
Grupi i dytë						
2. Banka Italo Shqiptare	Agjensi 1	11,3	4,2	18,3	8,9	1,0
3. Banka Arabo Islamike		9,3	0,3	1,9	0,0	0,0
Grupi i tretë						
4. Banka Kombëtare Tregtare	10	27,1	9,7	10,3	0,0	7,3
5. Banka Dardania		3,3	0,6	2,1	1,3	0,0
6. Banka Tirana	3	6,9	4,1	9,7	1,7	3,3
7. Banka Kombëtare Greke	Agjensi 2	5,5	2,5	4,8	0,0	0,8
8. Banka Tregtare Ndërkomb.		3,8	0,4	1,7	0,0	0,1
9. Banka Alfa Kredit	2	9,4	2,4	6,9	0,0	1,2
10. Banka Amenikane		4,2	4,6	9,6	0,2	1,1
11. Banka FEFAD	4	4,6	1,5	3,9	0,2	0,7
	Agjensi 1					
12. Banka e Parë e Investim.		4,6	0,04	1,9	0,0	0,0
13. Banka Ndërtregtare		7,2	0,3	1,7	0,0	0,1

²⁹ Nderja e bankave në grupe bëhet sipas kriterit të pronësisë së kapitalit. Në grupin e parë përfshihen bankat me kapital tërësisht shtetëror, në grupin e dytë përfshihen bankat me kapital të përbashkët, vendas dhe të huaj, dhe në grupin e tretë përfshihen bankat e tjera.

3.3. INSPEKTIVE NË VEND

Një ndër objektivat strategjike të mbikëqyrjes bankare është “forcimi i kapacitetit të inspektiveve në vend dhe reduktimi i kohës midis dy inspektiveve në një bankë tregtare, nga 18 në 12 muaj”. Nëse forcimi i kapacitetit inspektues është një proces i vazhdueshëm, që kërkon një periudhë kohe të konsiderueshme, reduktimi i kohës midis dy inspektiveve përfaqëson një objektiv më të drejtpërdrejtë. Ky objektiv, megjithëse si afat maksimal përmbushjeje ishte caktuar viti 2001, u bë e mundur të realizohej brenda vitit 2000. Në këtë mënyrë është krijuar hapësira që t’i kushtohet më tepër vëmendje rritjes së cilësisë së inspektiveve.

Gjatë vitit 2000 u kryen 11 inspektive të plota për 11 banka të nivelit të dytë, që përfaqësojnë 84 për qind të tregut bankar dhe 5 inspektive të pjesshme. Në to morën pjesë 14 inspektorë të Departamentit të Mbikëqyrjes.

Këto inspektive kanë patur për qëllim:

- i. të evidentojnë se sa e sigurt dhe e qëndrueshme ka qenë veprimtaria e bankave të nivelit të dytë;
- ii. të identifikojnë bankat apo veprimtaritë bankare të veçanta, që kërkojnë vëmendjen e autoritetit të mbikëqyrjes;
- iii. të kontrollojnë plotësimin, respektimin dhe mbikëqyrjen, nga këshillat drejtues të këtyre bankave, të akteve të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e secilës bankë, përsa i përket:
 - * politikave dhe procedurave të veprimtarisë bankare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë kredituese, administrimin e aktiveve dhe pasiveve të bankës, likuiditetin, administrimin e rrezikut, kontrollin e brendshëm etj.;
 - * strukturave të bankës me personel që t’i përgjigjet zhvillimit të veprimtarisë së bankës, sidomos në fushën e kredithënies;
 - * krijimit të komitetit të administrimit të aktiveve dhe pasiveve të bankës;
 - * shqyrtimit, nga këshillat drejtues, të raporteve periodike të administratorëve dhe të komitetit të kontrollit;
 - * funksionimit të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - * zbatimit të manualit të kontabilitetit bankar;
 - * përputhjes me ligjin dhe me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;
 - * komunikimit të drejtpërdrejtë me këshillat drejtues të bankave;
 - * familjarizimit të administratorëve të lartë, me sistemin që përdor mbikëqyrja për vlerësimin e gjendjes së përgjithshme financiare të institucionit financiar (sistemi i klasifikimit “ CAMELS”).

Në veçanti, inspektimet e pjesshme kanë patur për qëllim të evidentojnë sa edhe si është zbatuar:

- (i) rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja”;
- (ii) programi i paraqitur dhe i miratuar nga Banka e Shqipërisë për çështjet që kanë dalë nga inspektimet e plota.

3.3.1. ÇËSHTJE TË DALA NGA INSPEKTIMET.

Problemet më të spikatura, që dalin nga inspektimet janë:

- * Mungesa e politikave të huadhënies në disa banka dhe pamjaftueshmëria e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë.
- * Shkelja, në ndonjë rast, e normave të mbikëqyrjes për një huamarrës ose për grup huamarrësish të lidhur.
- * Shkelje të rregullores së Bankës së Shqipërisë për kërkesat, që duhet të plotësojnë administratorët e bankave të nivelit të dytë. Janë emëruar administratorë pa marrë më parë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.
- * Mosfunksionim, në disa banka, i komitetit të administrimit të aktiveve dhe pasiveve, dhe mungesa e politikave të shkruara të këmbimeve valutore.
- * Shmangie nga planet e biznesit të bankave.

Në varësi të problemeve të rezultuara në bankat e nivelit të dytë, Banka e Shqipërisë ka njoftuar e kërkuar angazhimin e këshillave drejtues dhe të komiteteteve të kontrollit, për të dhënë zgjidhjet përkatëse me afate të përcaktuara.

U vu re se komunikimi i drejtpërdrejtë me këshillat drejtues të bankave, ka ndikuar në mënyrë pozitive në rritjen e përgjegjësisë së administratorëve për zbatimin e akteve ligjore dhe të rekomandimeve të saj.

3.3.2. MASAT KORREKTUESE.

Banka e Shqipërisë, në zbatim të nenit 44 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” ka urdhëruar bankat e inspektuara të paraqesin programe të pranueshme për rregullimin e shkeljeve të konstatuara. Banka e Shqipërisë i ka konsideruar këto programe si të përshtatshme dhe ndjek vazhdimisht zbatimin e tyre.

3.4. PRIVATIZIMI I BANKËS SË KURSIMEVE

Viti 2000 konsiderohet si një vit relativisht i mbarë për ecurinë e privatizimit të bankave me kapital shtetëror. Kështu, përfundoi privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare ku aksionerët e rinj paguan kapitalin prej 10 milionë dollarësh amerikanë si dhe u bënë hapa të rëndësishëm në drejtim të përgatitjes për privatizim të Bankës së Kursimeve, banka më e madhe e sistemit bankar shqiptar.

3.4.1. PLOTËSIMET NË KUADRIN LIGJOR.

Privatizimi i Bankës së Kursimeve është një proces, që kërkon edhe mjaft rregullime ligjore.

Më 27.07.2000, u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 407 “Për miratimin e strategjisë së ristrukturimit të Bankës së Kursimeve sh.a”. Në këtë strategji parashikohen hapat për një strukturim tekniko – administrativ dhe ekonomiko-financiar të bankës.

Më 26.12.2000, u miratua ligji nr.8726, “Për mbulimin me bono thesari të detyrimeve të shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve dhe rikapitalizimin e saj me bono thesari”.

Ndërsa, më 28.12.2000 u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr.737 “Për përcaktimin e termave dhe kushteve të bonove të thesarit për detyrimet e shtetit dhe për rikapitalizimin e Bankës së Kursimeve sh.a” që ka të bëjë me mbulimin faktik të detyrimeve të shtetit dhe rikapitalizon bankën me bono thesari, në shumën prej 17.2 miliardë lekësh. Kjo shumë siguron **respektimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit**.

Siç shihet, të dyja këto akte kanë mjaft rëndësi për ecurinë e mëtejshme të procesit të privatizimit. Banka e Kursimeve përmirëson pozicionin e saj të kapitalit duke rritur vlerën e saj në treg dhe duke u bërë më tërheqëse për investitorët e huaj.

3.4.2. ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË.

Banka e Kursimeve është bankë shtetërore. Përfaqësimi i shtetit realizohet nëpërmjet Ministrit të Financave. Kështu, janë Ministria e Financave dhe Qeveria të angazhuarit e drejtpërdrejtë në procesin e privatizimit të Bankës së Kursimeve. Banka e Shqipërisë ka ndjekur nga afër dhe me mjaft interes ecurinë e procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a., pasi në bazë të ligjit të bankës qendrore:

- * Banka e Shqipërisë ka për detyrë të nxisë dhe të mbështesë krijimin e një sistemi bankar të shëndoshë dhe të qëndrueshëm.
- * Banka e Shqipërisë është këshilltare e Qeverisë Shqiptare për çështje të natyrës ekonomike e financiare.

Për më tepër, Banka e Kursimeve ka peshën kryesore në sistemin bankar shqiptar. Pozita dominuese e kësaj banke e bën mjaft delikat procesin e privatizimit. Prej suksesit të këtij procesi dhe ecurisë së bankës pas privatizimit, varet dhe vetë zhvillimi i sistemit bankar në Shqipëri.

Box 12. Banka e Kursimeve dominon sistemin bankar shqiptar.

Banka e Kursimeve sh.a. ka shtrirjen më të gjerë të rrjetit në vend me 223 zyra dhe është e pranishme në 37 rrethe si më poshtë:

	Degë.....26
	Agjenci.....87
	Zyra bankare.....110

Totali i aktiveve të Bankës së Kursimeve sh.a. zë 62.6 për qind të sistemit bankar, ndërsa në totalin e depozitave të pranuar dhe depozitat e individëve zë përkatësisht 69.3 dhe 62.8 për qind të totalit të sistemit bankar. Banka e Kursimeve zotëron rreth 84.2 për qind të depozitave në lekë dhe rreth 43.4 për qind të stokut të kredisë gjithsej. Pozicioni dominues i kësaj banke vihet re edhe te bonot e thesarit me 84.2 për qind të totalit për sistemin bankar. Totali i aktivitetit të Bankës së Kursimeve për njëqindmijë banorë, për muajin dhjetor 2000, ishte 5.18 miliardë lekë.

Përsa i përket vëllimit të pagesave, pozicioni i Bankës së Kursimeve paraqitet, gjithashtu, dominues me 39 për qind të aktivitetit të kleringut, 38 për qind në urdhërpagesat dhe 39 për qind të totalit të sistemit për çeqet bankare.

Kapitulli 4. Bilanci Kontabël i Bankës së Shqipërisë

4.1. BILANCI KONTABËL

	Shënim No.	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
AKTIVET			
Aktive të huaja			
Ari	3	970	954
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4	21,808	21,559
Depozita në bankat e huaja	5	57,094	41,382
Letra me vlerë	6	19,712	13,791
Aktive të tjera të huaja	7	196	431
Totali i aktiveve të huaja		99,780	78,117
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	3	69	61
Kredi tranzite	8	6,549	6,686
Kredi ndaj qeverisë	9	9,429	32,258
Investime në letra me vlerë	10	72,117	40,938
Aktive të tjera vendase	11	2,408	2,277
Totali i aktiveve vendase		90,572	82,220
Totali i aktiveve		190,352	160,337
DETYRIMET			
Detyrime të huaja			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	12	22,883	21,434
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	13	7,894	8,118
Detyrime të tjera të huaja		31	19
Totali i detyrimeve të huaja		30,808	29,571
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	14	101,409	82,946
Detyrime ndaj bankave vendase	15	32,571	27,137
Detyrime ndaj qeverisë	16	3,935	3,559
Detyrime të tjera vendase	17	110	67
Totali i detyrimeve vendase		138,025	113,709
KAPITALI I VET			
Kapitali themeltar		750	750
Rezerva ligjore		3,750	3,750
Rezerva e rivlerësimit		5,281	2,917
Rezerva të tjera		7,426	7,407
Fitimi i mbartur		4,312	2,233
Totali i kapitalit të vet		21,519	17,057
Totali i detyrimeve dhe kapitali i vet		190,352	160,337

Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

4.2. PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

	Shënim No.	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Shërbime ndaj jorezidentëve			
Të ardhura nga interesa dhe komisione		3,699	2,584
Shpenzime interesi dhe komisioni		<u>196</u>	<u>197</u>
Totali neto i interesave dhe komisioneve nga shërbimet ndaj jorezidentëve		<u>3,503</u>	<u>2,387</u>
Shërbime ndaj rezidentëve			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	18	7,570	14,902
Shpenzime interesi dhe komisioni		<u>305</u>	<u>162</u>
Totali neto i interesave dhe komisioneve nga shërbime ndaj rezidentëve		<u>7,265</u>	<u>14,740</u>
Të ardhura operative të tjera, neto	19	<u>77</u>	<u>18</u>
Totali neto i të ardhurave operative		<u>10,845</u>	<u>17,145</u>
Shpenzime të tjera jooperative			
Shpenzime personeli	20	180	142
Shpenzime amortizimi		90	66
Shpenzime amortizimi të shtypjes dhe prerjes së parasë		59	244
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		59	48
Shpenzime të tjera		<u>62</u>	<u>50</u>
Totali i shpenzimeve të tjera jooperative		<u>450</u>	<u>550</u>
FITIMI NETO		<u>10,395</u>	<u>16,595</u>
Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare			

4.3. PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET

Në (mln) Lekë	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Sipas 31 dhjetor 1999 (e paaudituar)	750	3,750	6,906	7,223	2,233	20,862
Fitimi neto	-	-	-	-	16,595	16,595
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	-	-	(3,989)	-	-	(3,989)
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	184	(16,595)	(16,411)
31 dhjetor 1999	750	3,750	2,917	7,407	2,233	17,057
Fitimi neto	-	-	-	-	10,395	10,395
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	-	-	1,036	-	-	1,036
Rivlerësimi i bonove të thesarit vendase	-	-	191	-	-	191
Rivlerësimi i bonove të thesarit amerikan	-	-	17	-	-	17
Rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	1,143	-	-	1,143
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	(23)	-	23	-
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	19	(8,339)	(8,320)
31 dhjetor 2000	750	3,750	5,281	7,426	4,312	21,519

Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

4.4. SHËNIME SHPJEGUESE

4.4.1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME.

Banka e Shqipërisë ("Banka") është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe u themelua sipas ligjit "Mbi Bankën e Shqipërisë" më 1992. Sipas termave të këtij akti përgjegjësitë kryesore të Bankës janë:

- * arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- * mbështetja e zhvillimit të një regjimi të këmbimeve valutore;
- * administrimi i parasë në qarkullim;
- * administrimi i normave të interesit;
- * parashikimet dhe analizat e treguesve të zhvillimeve ekonomike dhe sociale brenda Republikës së Shqipërisë;
- * mbikëqyrja e aktiviteteve të bankave të nivelit të dytë përfshirë dhënien e licencave të të gjitha bankave;
- * dhënia e licencave për ushtrimin e aktivitetit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të institucioneve bankare ndërkombëtare.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Mbi Bankën e Shqipërisë".

4.4.2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL.

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin". Parimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë aplikuar vetëm në ato raste që është parë e arsyeshme dhe e aplikueshme kundrejt veprimtarisë specifike të bankës qendrore kombëtare. Pasqyra e fluksit të rrjedhës së parasë, si një nga kërkesat e Parimit no.1 të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nuk është përgatitur sepse likuiditeti dhe gjendja e fluksit të arkës nuk përbën qëllimin kryesor të përdoruesve të pasqyrave financiare. Gjithashtu, metodologjia e aplikuar për rivlerësimin e ndërtesës qendrore siç është detajuar në shënimin 11 nuk u bë në përputhje me kërkesat e SNK 16 mbi aktivet fikse për faktin se rivlerësimi nuk u krye nga vlerësues të pavarur profesionalë, flukset e ardhshme të parasë nuk u skontuan dhe të gjitha njësitë përbërëse të kategorisë së ndërtesave nuk u rivlerësuan.

Parimet kontabël më të rëndësishme, të përdorura nga Banka në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë detajuar si më poshtë:

4.4.3. BAZAT E PARAQITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE.

Pasqyrat financiare të paraqitura përfshijnë llogaritë e Bankës përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike të modifikuar duke përfshirë rivlerësimin e valutave të huaja dhe arit.

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase të Republikës së Shqipërisë, Lek Shqiptar ("LEK").

Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës, një njësi biznesi e cila merret me shtypshkrimin e materialeve të qeverisë, që përmbajnë elemente të sigurisë së lartë dhe prerjen e monedhave prej pesë dhe dhjetë lekë. Aktiviteti financiar i Shtypshkronjës nuk është konsoliduar me atë të Bankës për shkak se aftësia e Shtypshkronjës për të shpërndarë fitimet e saj ndaj Bankës është ende e papërcaktuar. Situata financiare e Shtypshkronjës, më 31 dhjetor 2000 është paraqitur e detajuar në shënimin 21.

Interesa dhe komisione

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat regjistrohen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

Të ardhura nga komisione regjistrohen kur të ardhurat janë marrë.

Shpenzime komisioni regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

Konvertimi i valutave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit.

Aktivet dhe pasivet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e bilancit. Fitimi ose humbja e përcaktuar nga konvertimi i kurseve të këmbimit regjistrohen tek llogaria "Rivlerësimi i rezervës".

Kursi zyrtar i këmbimit, i aplikuar nga Banka (njësi e monedhës së huaj përkatëse e shprehur në LEK) për monedhat e huaja më kryesore më 31 dhjetor paraqitet si më poshtë :

	2000	1999
Dollari Amerikan ("USD")	142.64	135.12
Marka Gjermane ("DEM")	67.78	69.43
Lireta Italiane ("ITL")	0.07	0.07
Monedha Europiane ("Euro")	132.57	135.80
Sterlina Angleze ("GBP")	212.23	218.22
Franga Zvicerane ("SFR")	87.15	84.66
Drahamia Greke ("GRD")	0.3895	0.498
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("SDR")	185.76	185.25

Investimet

Bonot e thesarit vendase për mbulimin e buxhetit të shtetit shprehen me çmimin e blerjes plus skonton e amortizuar. Bonot e thesarit të Shtetit Amerikan dhe bonot e thesarit afatshkurtra vendase shprehen me vlerën e tregut.

Marrëveshjet e riblerjes

Letrat me vlerë të blera dhe të shitura me marrëveshje riblerjeje konsiderohen si hua e kolateralizuar.

Aktivët e qëndrueshme

Aktivët e qëndrueshme shprehen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar me përjashtim të ndërtesës qëndrore të Bankës, e cila është vlerësuar më 29 mars 2000 (shënimi 11).

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi hiqet me vlerën e tregut.

Fitimet ose humbjet nga heqja e aktiveve të qëndrueshme regjistrohen në llogarinë humbje/fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivët fikse bazuar në koston historike. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivit. Jetëgjatësitë, të vlerësuara sipas llojit të aktivit të aplikuar janë:

ndërtesa – godina qëndrore	50 vjet
ndërtesat – në degë	33 vjet
mjete transporti	5 vjet
pajisje zyre	10 vjet
programe kompjuteri	3 vjet

Gjatë vitit 1999, jetëgjatësia e vlerësuar e ndërtesave ishte 33 vjet. Pas vlerësimit të godinës qëndrore (shënimi 11), jetëgjatësia e kësaj ndërtese u vlerësua në 50 vjet. Efekti mbi pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të këtij ndryshimi në vlerësimin kontabël, më 31 dhjetor 2000, u pasua me një zvogëlim të shpenzimit të amortizimit më 31 dhjetor 2000 prej 11 milionë lekësh.

Kosto të shtypjes dhe prerjes së parasë

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave kapitalizohen dhe amortizohen respektivisht për mbi dy dhe dhjetë vjet.

Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit “Mbi Bankën e Shqipërisë” dhe kërkohet me ligj që 100 për qind e fitimit të kalojë direkt në buxhetin e shtetit pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Rezerva ligjore

Në përputhje me legjislacionin bankar shqiptar, Banka ka krijuar një rezervë ligjore në të cilën, 25 për qind e fitimit neto të vitit transferohet derisa shuma e rezervës arrin 500 për qind të kapitalit themeltar.

Përdorimi i parashikimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga Drejtimi i Bankës që të bëhen parashikime dhe supozime, që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe pajisjeve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve llogaritur për ngjarje të paparashikuara në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportuar. Ky parashikim bëhet, sepse rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

Aktive të menaxhuara

Më 31 dhjetor 2000, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra të emetuara nga Ministria e Financave si edhe ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të qeverisë. Meqë Banka luan rolin e një kujdestari për këto aktive, ajo nuk ka asnjë lloj rreziku krediti.

Këto aktive janë përjashtuar nga bilanci i Bankës.

1. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

Më 31 dhjetor 2000, vlera e rezervave të arit të standardizuar, pronë e Bankës, ishte 970 milionë lekë (1999 – 954 milionë lekë) nga e cila 16,923.778 onz ar të vlerësuar në 658 milionë lekë (1999 – 16,302.056 onz ar të vlerësuar në 640 milionë lekë) të vendosur në depozita ari me afat dhe 8,007.88 onz ar të vlerësuar prej 312 milionë lekësh (1999 – 8,007.88 onz ar të vlerësuar në 314 milionë lekë) në kasafortë në vend.

Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferencat, që rezultojnë nga rivlerësimi i arit janë regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 dhjetor 2000, një onz ar u vlerësua me 272.65 USD (1999 – USD 290.85).

Ari dhe metale të çmuara, gjithashtu, përfshin gjendjet e platinit dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit, me një shumë totale prej 35 milionë lekësh më 31 dhjetor 2000 (1999-24 milionë lekë) si edhe ar i pastandardizuar në 34 milionë lekë (1999-37 milionë lekë).

2. DEPOZITA TEK FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

Në depozitat e Fondit Monetar Ndërkombëtar përfshihen:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Fondi Monetar Ndërkombëtar	10,972	11,173
Të drejta të veçanta të tërheqjes (SDR)	10,836	10,386
Totali	21,808	21,559

Të arkëtueshmet nga FMN-ja rezultojnë prej anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë në FMN dhe kjo shumë është e garantuar me një notë premtimi emetuar nga qeveria. Depozitat në SDR janë të barabarta me kuotën e anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë paguar FMN-së në SDR dhe Lekë, e cila ka si kundërparti huatë e dhëna nga FMN Republikës së Shqipërisë, siç paraqitet në shënimin 12.

3. DEPOZITA NË BANKAT E HUAJA

Depozitat në bankat e huaja përbëhen nga:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Llogari rrjedhëse	10,776	9,688
Depozita afatshkurtra	46,318	31,694
Totali	57,094	41,382

Depozitat në bankat e huaja janë kryesisht në EURO, USD dhe DEM, të cilat sipas çdo monedhe të huaj iu përgjigjen gjëndjeve të mëposhtme:

	2000 (në mln)	1999 (në mln)
EURO	183	103
USD	137	112
DEM	118	113

4. LETRAT ME VLERË

Më 31 dhjetor 2000, në letrat me vlerë përfshihen:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Bono thesari të Qeverisë Amerikane	19,064	13,158
Investime të tjera	648	633
Totali	19,712	13,791

Maturimi i bonove të thesarit të Qeverisë Amerikane varion midis marsit dhe dhjetorit 2001 dhe të ardhurat e fituara nga këto bono vijnë si rezultat i diferencës midis vlerës nominale dhe vlerës së blerjes me skonto, e cila amortizohet në të ardhura gjatë jetëgjatësisë së këtyre bonove.

Zëri “Investime të tjera” përfshin pjesëmarrjen në Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në Bankën Botërore dhe në organizata të tjera si dhe në Bankën Arabe të Zhvillimit.

5. AKTIVE TË TJERA TË HUAJA

Më 31 dhjetor 2000, aktive të tjera të huaja përbëhen nga arka në valutë me një vlerë prej 14 milionë lekësh (1999 – 206 milionë lekë) dhe interesi i përllogaritur mbi depozitat në bankat e huaja me një vlerë prej 182 milionë lekësh (1999 - 225 milionë lekë).

6. KREDI TRANZITE

Kreditë tranzite, sipas sektorëve të industrisë, ndahen si më poshtë:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Bujqësi	1,405	1,437
Industri	4,144	4,245
Sektori i shërbimeve dhe të tjera	1,000	1,004
Totali	6,549	6,686

Kreditë tranzite përfaqësojnë shërbime krediti pa interes, akorduar institucioneve të kreditit për t’iu shpërndarë huamarrësve me qëllim mbështetjeje të programeve qeveritare të zhvillimit (shënimi 13). Të gjitha huatë janë të garantuara nga Qeveria Shqiptare.

7. KREDI NDAJ QEVERISË

Në totalin e kredive ndaj qeverisë më 31 dhjetor 1999, nga shuma prej 22,829 milionë lekësh merret interes me një normë mesatare prej 5.5 për qind për vitin 1999, ndërsa 9,429 milionë lekë janë pa interes. Gjatë vitit 2000 huatë me interes u shndërruan në bono thesari, pronësi e Bankës. Gjendja më 31 dhjetor 2000 prej 9,429 milionë lekësh mbetet përsëri hua pa interes.

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË - VENDASE

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Bono thesari për mbulimin e buxhetit të shtetit	6,006	24,592
Bono thesari afatshkurtra	62,782	13,240
Obligacione për ish-kooperativat bujqësore	1,958	1,958
Obligacione zero kupon për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare (“BKT”)	1,290	1,148
Bono thesari marrëveshje riblerjeje	81	-
Totali	72,117	40,938

Bonot e thesarit për mbulimin e buxhetit të shtetit, më 31 dhjetor, 2000 lidhen me bono thesari afatshkurtra që maturohen më 11 janar 2001 me interes prej 11.28 për qind.

Bonot e thesarit për mbulimin e buxhetit të shtetit, më 31 dhjetor 1999, në lidhje me huatë e dhëna qeverisë nga viti 1994 deri në vitin 1999 u shndërruan në bono thesari afatshkurtra. Norma e interesit është vendosur për 6 muaj, bazuar mbi normën e skontos së bonove të thesarit afatshkurtra, të cilat më 31 dhjetor 1999 varionin nga 15.4 për qind deri në 19.5 për qind. Maturiteti i këtyre bonove ishte 6 muaj dhe këto bono në maturitet riinvestoheshin me të njëjtat terma.

Bono thesari afatshkurtra, më 31 dhjetor 2000, lidhen kryesisht me bono thesari që maturohen në periudhën janar - qershor 2001. Këto bono fitojnë interes që nga 7.8 për qind deri në 12.5 për qind.

Letrat me vlerë për kooperativat kanë lidhje me një kredi ndaj kooperativave bujqësore shtetërore para vitit 1992. Qeveria ka emetuar letra me vlerë me shumën e kredisë. Këto letra me vlerë fitojnë një normë interesi prej 1.5 për qind.

Letrat me vlerë për kapitalizimin e BKT-së kanë të bëjnë me obligacione zero kupon, të cilat janë lëshuar nga qeveria për të zëvendësuar pjesëmarrjen në kapital në BKT. Letrat me vlerë fitojnë një interes prej 6 për qind në vit dhe maturohen në vitin 2006.

9. AKTIVE TË TJERA VENDASE

Në aktive të tjera vendase përfshihen:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Interes i përlogaritur	-	1,027
Debitorë të tjerë	46	352
Kredi punonjësve	392	350
Aktive fikse neto	1,399	292
Inventari	16	13
Aktive të paqëndrueshme, neto	550	235
Të tjera	5	8
Totali	2,408	2,277

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme	Pajisje teknike	Mjete transporti	Pajisje zyre dhe kompjuterike	Totali i aktiveve fikse të qëndrueshme
<u>Kosto/Vlerësimi</u>					
Gjendja më 1 janar 1999	131	179	94	99	503
Rivlerësim	1,143	-	-	-	1,143
Shtesat	17	14	9	14	54
Pakësimet	(7)	-	-	-	(7)
Gjendja më 31 dhjetor 2000	1,284	193	103	113	1,693
<u>Amortizimi i akumuluar</u>					
Gjendja më 1 janar 1999	30	77	62	42	211
Shpenzimi vjetor	34	29	12	15	90
Pakësimet	(7)	-	-	-	(7)
Gjendja më 31 dhjetor 2000	57	106	74	57	294
<u>Vlera kontabël neto</u>					
Gjendja më 31 dhjetor 2000	1,227	87	29	56	1,399
Gjendja më 31 dhjetor 1999	101	102	32	57	292

Sipas ligjit shqiptar, titulli i pronësisë së ndërtesës së Bankës është i paqartësuar. Drejtuesit e Bankës janë të mendimit që kjo çështje do të zgjidhet me Ministrinë e Financave në një të ardhme të afërt në favor të Bankës.

Ndërtesa qendrore e Bankës e përfshirë në kategorinë “Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme” është rivlerësuar gjatë vitit 2000 në shumën 1,413 milionë lekë nga kostoja historike plotësisht e amortizuar prej 7 milionë lekësh. Rivlerësimi u bë më 29 mars 2000, me datë valute 1 janar 2000, nga një komision i brendshëm vlerësuesish. Vlerësimi nuk u bë mbi bazën e skontimit të flukseve të ardhshme të parasë, por bazuar mbi vlerën e përafërt të tregut të dhënie/marrje me qira të pronësisë së patundshme mbi jetëgjatësinë prej 50 vjet. Ndërtesa të tjera të Bankës nuk u rivlerësuan. Teprica e rivlerësimit prej 1,143 milionë lekësh u kreditua tek rivlerësimi i rezervës.

Totali neto i aktiveve të patrupëzuara përbëhet si më poshtë:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Programe kompjuterike dhe të tjera	10	8
Kartëmonedha dhe monedha të shtypura	1,874	1,501
Amortizimi i akumuluar	(1,334)	(1,274)
Totali	550	235

10. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

Detyrimi ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar përbëhet nga:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Shërbime ndihmëse për rregullime strukturale ("ESAF")	12,533	10,882
Letra me vlerë tek FMN	8,525	8,727
Llogari e FMN-së në Lekë	1,825	1,825
Totali	22.883	21.434

Huatë e ESAF-it janë të lidhura me kuotizacionin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat makroekonomike. Këto hua përbëhen nga këta tre komponentë:

- ✍ Huaja fillestare e ESAF-it, e tërhequr në vitin 1993, e cila pritet të shlyhet brenda 10 vjetëve duke filluar që nga viti 1999. Gjendja e kësaj huaje, më 31 dhjetor 2000, ishte 23,013,000 SDR (1999 – 28,519,000) dhe kjo hua do të shlyhet çdo gjashtë muaj me interes 0.5 për qind.
- ✍ Një hua shtesë nën këtë marrëveshje (e njohur si Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit) u tërhoq pjesërisht në vitet 1999 dhe 2000. Gjendja, më 31 dhjetor 2000, ishte 35,630,000 SDR (1999 – 21,348,000 SDR). Kjo, gjithashtu, është një hua 10-vjeçare e kthyeshme deri në vitin 2009, në 10 këste çdo gjashtë muaj duke filluar që nga viti 2004. Norma e interesit për t'u paguar pas periudhës pa interes është 0.5 për qind dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.
- ✍ Huaja për Shqipërinë 'Asistenca për Emergjencën Pas Konfliktit': shuma prej 8,825,000 SDR akorduar në vitin 1997 e pagueshme me 8 këste, brenda 5 vjetëve pas një periudhe trevjeçare pa interes. Norma e interesit përcaktohet sipas normave të tregut, e cila më 31 dhjetor 2000 ishte 5.6 për qind.

11. DETYRIMI NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOVENDASE

Detyrimi ndaj institucioneve financiare jovendase përfshin:

	2000 Lekë (mln)	1999 Lekë (mln)
Hua tranzite (shënimi 8)	6,552	6.689
Hua e Bankës së Greqisë	1,169	1,237
Detyrim ndaj Bankës Botërore	173	192
Totali	7.894	8.118

Huaja për zhvillim është dhënë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau 5,891 milionë lekë (1999 – 6,032 milionë lekë) dhe Banka Europiane e Investimeve 661 milionë lekë (1999 – 657 milionë lekë). Interesi paguhet nga bankat dhe kompanitë vendase drejtpërsëdrejti ndaj investitorëve.

Huaja e Bankës së Greqisë (hua e Republikës Helenike) është dhënë me qëllim të financimit të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma e interesit është caktuar 4 për qind në vit dhe është e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

12. PARAJA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka. Më 31 dhjetor 2000, struktura e mëposhtme e monedhave dhe e kartëmonedhave në qarkullim ishte:

Vlera nominale	31 dhjetor 2000		31 dhjetor 1999	
	Numri në mijë	Vlera Lekë (në mln)	Numri në mijë	Vlera Lekë (në mln)
1	20,999	21	21,016	21
3	6,479	19	6,489	20
5	6,323	32	6,373	32
10	7,615	76	7,684	77
50	-	-	749	38
100	19,495	1,949	17,831	1,783
200	26,924	5,385	27,706	5,541
500	68,713	34,356	64,048	32,024
1,000	48,181	48,181	40,298	40,298
5,000	2,023	10,113	476	2,380
Monedha		1,277		732
Totali		101,409		82,946

13. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

Më 31 dhjetor 2000, detyrimi ndaj bankave vendase përfshin:

	2000 Lekë (në mln)	1999 Lekë (në mln)
Në monedha të huaja		
Llogari të bankave të nivelit të dytë	71	84
Rezervë e detyrueshme e bankave të nivelit të dytë	6,609	5,684
	6.680	5.768
Në monedhe vendase (Lek)		
Llogari të bankave të nivelit të dytë	20,656	20,584
Bono thesari shitur me marrëveshje riblerieje	5,235	785
	25,891	21,369
Totali	32,571	27,137

Banka ka filluar të paguajë interes mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme në shtator 2000. Interesi llogaritet si më poshtë:

- ✍ gjendjet në lekë: një e treta e normës së interesit të bonove të thesarit tremujore (2.6 për qind më 31 dhjetor 2000);
- ✍ gjendjet në USD: një e treta e normës së USD LIBOR njëmuajore (2.2 për qind më 31 dhjetor 2000);
- ✍ gjendjet në EURO: një e treta e normës së EURO LIBOR njëmuajore (1.6 për qind më 31 dhjetor 2000);
- ✍ gjendjet në GRD: një e treta e normës së ATHIBOR njëmuajore (1.6 për qind më 31 dhjetor 2000).

Banka nuk paguan interes mbi llogaritë rrjedhëse të bankave të nivelit të dytë.

Bonot e thesarit me marrëveshje riblerjeje maturohen më 4 janar 2001 me norma interesi, që variojnë nga 6.2 për qind në 6.45 për qind.

14. DETYRIMI NDAJ QEVERISË

Detyrimi ndaj qeverisë përfshinte :

	2000 Lekë (në mln)	1999 Lekë (në mln)
Depozita në emër të qeverisë	3,850	1,562
Fitimi për t'iu dhënë qeverisë	-	1,903
Të tjera	85	94
Totali	3,935	3,559

Depozita në emër të qeverisë përfaqësojnë fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Organizata Ndërkombëtare për Zhvillim Ekonomik.

15. DETYRIME TË TJERA VENDASE

Nga totali i detyrimeve të tjera vendase prej 110 milionë lekësh, shuma prej 84 milionë lekësh lidhet me detyrimin ndaj Shtypshkronjës së kontrolluar nga Banka (shënimi 21).

16. TË ARDHURA NGA INTERESAT DHE KOMISIONET (REZIDENTËT)

Të ardhurat nga interesat dhe komisionet përbëhen si më poshtë:

	2000 Lekë (në mln)	1999 Lekë (në mln)
Interesa nga huatë qeveritare	1,378	4,330
Të ardhura nga letrat me vlerë	6,006	10,565
Të ardhura të tjera	186	7
Totali	7,570	14,902

17. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

Të ardhura të tjera operative përfshijnë:

	2000 Lekë (në mln)	1999 Lekë (në mln)
Humbje neto nga shitja e investimeve	(2)	(1)
E ardhur neto nga traktimi i monedhave të huaia dhe metaleve të çmuara	1	3
Të ardhura të tjera	78	16
Totali	77	18

18. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, shpenzimet sociale dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet sociale përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore, Fondit Shtetëror të Punësimit dhe shpenzime të tjera. Më 31 dhjetor 2000, Banka ka patur 334 punonjës (1999 – 272 punonjës).

19. SHTYPSHKRONJA

Siç është e detajuar në shënimin 2, Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës. Pozicioni financiar i Shtypshkronjës, më 31 dhjetor 2000, paraqitet si më poshtë:

	2000 Lekë (në mln)
AKTIVET	
Aktivitet fikse	41
Inventari	62
Klientë	1
Banka llogari likuiduese (shënimi 17)	84
Totali i aktiveve	188
KAPITALI I VET	
Kapitali themeltar	52
Rezerva ligjore	19
Rezerva e investimit	24
Rezerva të tjera	6
Fitimi i pashpërndarë	87
Totali i kapitalit të vet	188

20. ANGAZHIME PËR NGJARJE TË PAPARASHIKUARA

Banka është e përfshirë në një numër çështjesh gjyqësore dhe procedurash ligjore, të ngritura gjatë aktivitetit të zakonshëm të biznesit. Drejtimi është i mendimit se këto procedura nuk do të kenë një efekt material në pozicionin financiar apo në rezultatet operative të Bankës.

Nuk ka angazhime të tjera të rëndësishme për ngjarje të paparashikuara.

21. SHIFRA KRAHASUESE

Disa shifra krahasuese janë rishikuar për të pasur të njëjtën bazë krahasimi me prezantimin e këtij viti.

4.5. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë:

Ne kemi audituar bilancin e Bankës së Shqipërisë ("Banka") më 31 dhjetor 2000 dhe 1999, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit të vet. Drejtimi Bankës së Shqipërisë është përgjegjës për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Përgjegjësia jonë është të japim opinion mbi këto pasqyra në përfundim të auditimit tonë.

Përveç sa diskutohet në paragrafin e mëposhtëm, ne drejtuam auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të zbatojmë procedurat e auditimit për të dhënë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Auditimi, bazuar mbi kryerjen e testeve, ka të bëjë me ekzaminimin e dokumenteve në mbështetje të shifrave dhe informacioneve të tjera, të paraqitura në pasqyrat financiare. Auditimi, gjithashtu vlerëson parimet kontabël të përdorura dhe parashkimet e bëra nga Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, si dhe jep një opinion të përgjithshëm mbi paraqitjen e pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për dhënien e opinionit.

Ne nuk kryem auditimin e bilancit më 31 dhjetor 1998, sepse kjo datë ishte para angazhimit tonë si auditorë, rregullime të cilat mund të kishin ndikim material në përpilimin e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 1999; ndaj, ne nuk jemi në gjendje, dhe nuk shprehim opinion mbi pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit të vet më 31 dhjetor 1999.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efektit në pasqyrat financiare të çështjes së trajtuar në paragrafin e mësipërm, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2000 dhe 1999 dhe rezultatet e aktiviteteve të saj dhe kapitalin e vet për fund viti, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("SNK") të modifikuara për parimet e përgjithshme të pranura kontabël, të aplikueshme për bankat qëndrore.

Deloitte & Touche, Sh.p.k

Tirana, Albania

10 mars 2001

Kapitulli 5. Aktivitetet e tjera të Bankës së Shqipërisë

5.1. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Objektivi kryesor strategjik afatmesëm i Bankës së Shqipërisë për sistemin e pagesave është rritja e qarkullimit të parave nëpërmjet sistemit bankar dhe, për rrjedhojë, reduktimi i sasisë së *cash*-it në ekonomi.

Realizimi i këtij objekti lidhet me nivelin e marrëdhënieve të klientëve me bankat, me traditën dhe kulturën si dhe me zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme. Për këto arsye, për arritjen e tij, Banka e Shqipërisë do të përqëndrojë punën në disa drejtime kryesore: **së pari**, futja e instrumenteve të reja në përdorim; **së dyti**, përmirësimi i sistemit të pagesave; dhe **së treti**, përmirësimi i sistemit ndërbankar të pagesave, që trajton pagesat me vlera të vogla.

5.1.1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Viti 2000 u karakterizua nga përpjekjet për:

- A. *Prezantimin e instrumenteve të reja të pagesës*, nëpërmjet realizimit të marrëveshjeve për njohjen dhe për përdorimin e “*urdhrit për debitimin direkt*” dhe “*urdhrit për pagesë periodike*”.
- B. *Reduktimin e kohës së përpunimit të dokumentacionit në sistemin bankar*. Për këtë u nënshkrua marrëveshja e unifikimit të afateve të procesimit të instrumenteve në sistemin bankar, të urdhërpagesave dhe të çeqeve, ndërmjet bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë.
- C. *Standardizimin e instrumenteve të pagesës në përdorim*. Viti 2000 shënoi fillimin e kësaj pune me marrëveshjen “Për unifikimin e urdhërpagesave dhe çekut” si një hap drejt afrimit me standardet ndërkombëtare.
- D. *Hartimin e bazës rregullatore për instrumentet e reja dhe përmirësimin e bazës rregullatore ekzistuese*. Konkretisht:
 - * u hartua rregullorja “Për pagesat elektronike”, në të cilën përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen, me qëllim që mjetet e reja elektronike të pagesave të sjellin: siguri dhe dobi për klientët, produktivitet dhe siguri më të madhe për emetuesit e tyre;

- * u rishikua rregullorja “Për administrimin e llogarisë rezervë të bankave të nivelit të dytë”. Kjo rregullore u krijon një lehtësi të re bankave të nivelit të dytë në administrimin e likuiditetit duke iu dhënë mundësinë e përdorimit deri në 5 për qind të rezervës së detyrueshme pranë Bankës së Shqipërisë.

Në vitin 2000 u realizua studimi, për automatizimin e kleringut si një element i rëndësishëm i sistemit të pagesave, që lidhet direkt me klientët e bankave, me individët dhe me bizneset shqiptare, i cili përcaktoi si mënyrë të përshtatshme organizimi, për kushtet në të cilat operon sot sistemi bankar dhe përqëndrimin që ka biznesi, organizimin e tij në Tiranë. Organizimi i kleringut në mënyrë të përqëndruar është një vazhdim i praktikës aktuale të organizimit të procesit të kleringut, i cili ka përparësitë e mëposhtme:

- * bën të mundur rritjen e shkallës së automatizimit me kosto minimale dhe rritjen e sigurisë së procesit të kleringut, pa sjellë ndryshime të mëdha të mënyrës së përdorur aktualisht prej bankave pjesëmarrëse për këtë qëllim;
- * nuk sjell ndryshime në organizimin e shërbimit korrier, i cili do të vazhdojë të funksionojë për të grumbulluar dhe transportuar instrumentet letër;
- * ndikon në shpejtësinë e kryerjes së pagesave me urdhërpagesë, megjithëse nuk sjell ndonjë ndikim pozitiv në shpejtësinë e përpunimit të çeqeve;
- * dërgimi i rezultateve të kleringut në formë elektronike do të ndihmojë bankat, të cilat janë të automatizuara, për të rakorduar lehtësisht sistemin e brendshëm kontabël.

5.1.2. INSTRUMENTET E PAGESËS.

Gjatë vitit 2000, instrumentet që u përdorën më tepër nga klientët e bankave ishin urdhërpagesa dhe çeqet, me një rritje në krahasim me vitin e mëparshëm prej 7 për qind. Kështu, vlera e transaksioneve të kliruara nëpërmjet kleringut gjatë vitit 2000 ishte 54.4 miliardë lekë (rreth 381 milionë dollarë amerikanë³⁰) vlerë, e cila përfaqëson 5.9 për qind të vlerës totale të qarkulluar në llogaritë e bankave. Të njëjtën vlerë dhe peshë zë dhe vlera e veprimeve ndërbankare të kryera nga bankat e nivelit të dytë. Vlera e qarkulluar nga të gjitha bankat për vitin 2000 është 913 miliardë lekë ose 6.4 miliardë dollarë amerikanë. Volumi i aktivitetit të kleringut për vitin 2000 shënoi një rritje prej 8.7 për qind në krahasim me vitin 1999. Rritjen më të madhe e kanë patur pagesat e bëra nëpërmjet urdhërpagesave, vlera e të cilave kapi shifrën 28.04 miliardë lekë (196 milionë dollarë) dhe përfaqëson një rritje prej 9.3 për qind në krahasim me vitin 1999.

³⁰ Kursi me dollarin është ai i fundit të vitit 2000, 1USD= 142,64 lekë.

Tabela 48. Volumi i transaksioneve të kliruara në seancat e kleringut gjatë vitit 2000.

Instrumenti	Numri (në njësi fizike)		Vlera (në miliardë lekë)	
	1999	2000	1999	2000
Viti				
Urdhërpagesa	53 357	57 500	25.6	28.0
Çeqe ³¹	6 000	6 500	24.4	26.3
Totali	59 357	64 000	50.0	54.4

Tabela 49. Vlera mesatare e instrumenteve të pagesës (milionë lekë).

Instrumenti	Vlera mesatare për instrument		Vlera mesatare mujore	
	1999	2000	1999	2000
Viti				
Urdhërpagesa	0.5	0.5	2 136.8	2 336.7
Çeqe	4.1	4.1	2 031.0	2 195.3
Totali			4 167.9	4 531.9

³¹ Në grupin "çeqe" përfshihen çeqe bankare dhe çeqe personale.

5.2. EMISIONI I MONEDHËS

Më 1 shtator 2000 u emetua dhe u hodh në qarkullim prerja më e madhe e monedhës metalike, monedha metalike e prerjes 100 lekë. Kjo prerje është hedhur në qarkullim për herë të parë dhe është e dubluar (monedhë dhe kartëmonedhë). Hedhja e saj në qarkullim është motivuar nga treguesit ekonomikë dhe do të vazhdojë si prerje e dubluar deri në vitin 2004.

Më 31 dhjetor 2000, u hoqën nga qarkullimi kartëmonedhat e prerjes 10 lekë, 5 lekë, 3 lekë e 1 lek — emetime të viteve 1964 e 1976 dhe monedhat metalike të prerjeve 2 lekë, 1 lek, 50 qindarka, 20 qindarka, 10 qindarka e 5 qindarka, emetime të viteve 1964, 1969, 1988 dhe 1989.


Gjendja e treguesve të monedhës më 31.12.2000, rezulton si më poshtë:

* Emisioni	106.000.000.000,00 lekë
* Monedha në qarkullim	101.408.538.645,55 lekë.

Emisioni i monedhës, për vitin 2000, u shtua me 21 miliardë lekë, duke mbajtur parasysh plotësimin e nevojave të ekonomisë për para në një strukturë optimale.

Monedha në qarkullim, rezultoi në shumën 101.408.538.645,55 lekë. Krahasuar me fundvitin 1999, ajo është rritur me 18,5 miliardë lekë ose 22,3 për qind. Rritjen më të madhe e ka pësuar në muajin dhjetor, me 5,53 miliardë lekë ose 29,9 për qind të të gjithë shtesës vjetore (shih grafikun 24).

Shtesa e monedhës në qarkullim		
M u a j t	Mujore	Progresive
Janar	+ 1,68	+ 1,68
Shkurt	+ 1,08	+ 2,76
Mars	+ 0,78	+ 3,54
Prill	+ 0,32	+ 3,86
Maj	+ 0,41	+ 4,27
Oershor	+ 1,30	+ 5,50
Korrik	+ 1,59	+ 7,16
Gusht	+ 3,77	+10,93
Shtator	+ 1,42	+ 12,35
Tetor	+ 0,60	+12,95
Nëntor	- 0,02	+12,97
Dhjetor	+ 5,53	+18,50



Grafiku 25. Ndryshimi i gjendjes së monedhës në qarkullim (ndryshimi mujor në përqindje).

Disa nga faktorët, që vlerësohet të kenë ndikuar në shtesën e monedhës në qarkullim, janë:

- * depozitat gjithsej të qytetarëve në lekë e në valutë në dhjetor 2000, krahasuar me fundvitin 1999, u shtuan 9.6 për qind nga 22,3 për qind që u shtua monedha në qarkullim;
- * ulja e interesave bankare për depozitat me afat;
- * stabilizimi, në përgjithësi, i kursit të këmbimit dhe niveli i ulët i inflacionit, kanë shtuar besimin e publikut tek monedha kombëtare;
- * plotësimi i nevojave të konsumit nga popullata dhe pagesat për qëllime tregtare, kryesisht ato brenda vendit, megjithë zhvillimet, akoma, në një masë të konsiderueshme, vazhdojnë të kryhen në *cash*.

Tabela 51. Struktura e monedhës në qarkullim (në %).

Prerjet	Viti 1999	Viti 2000
5000	0.25	0.98
1000	21.00	23.30
500	33.37	33.23
200	14.44	13.02
100	9.29	9.43
10	4.00	3.68
5	3.32	3.06
3	3.38	3.13
1	10.95	10.16
Tot K/m	100.00	100.00
100	0.00	1.98
50	7.23	4.04
20	10.11	5.92
10	10.82	6.57
5	7.68	4.51
2	0.26	0.12
1	10.27	5.00
0.5	8.71	4.21
0.2	18.84	9.11
0.1	22.01	10.65
0.05	4.08	1.97
Tot M/m	100.00	100.00

Përsa i takon fenomenit të falsifikimit të monedhës, ai ishte i pranishëm edhe gjatë vitit 2000. Krahasuar me vitin 1999 falsifikimi në total (dhe për çdo prerje) është rritur 2.2 herë.

Tabela 52. Falsifikimet e rezultuara në numër transaksionesh.

Nr.	Prerjet	Viti 2000	Progresiv (nga viti 1992)
1.	1000 lekë	747	10796
2.	500 lekë	1487	4750
3.	200 lekë	834	944
4.	100 lekë	6	6

Më "të ekspozuara" ndaj falsifikimit kanë qenë prerjet 1000 lekë, kryesisht emetimet e viteve 1992 e 1994; prerja 500 lekë emetim i vitit 1996, prodhim i Shtypshkronjës së Bankës së Shqipërisë dhe emetimi i vitit 1994.

Gjatë vitit 2000, ka rritje të ndjeshme të falsifikimit të prerjes 1000 lekë, emetim i ri i vitit 1996 dhe të prerjes 200 lekë, emetim i vitit 1994. Vetëm për këtë të fundit, nga 944 copë gjithsej të falsifikuara, 834 copë i përkasin vitit 2000. Kryesisht, falsifikimet janë realizuar me fotokopje dhe shtyp *offset*. Sa i takon kartëmonedhave të huaja të falsifikuara, sasia e tyre është e pakonsiderueshme.


5.3. INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

5.3.1. PROCESET E INTEGRIMIT.

Dekada e parë e tranzicionit shqiptar ishte ajo e një riorientimi të rëndësishëm ekonomik dhe institucional drejt Bashkimit European. Pritet, që dekada e dytë, të shënojë zhvillime të ndjeshme drejt procesit të anëtarësimit më formal në strukturat e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar European. Objektivi për anëtarësim në BE ka qenë forca drejtuese e reformave ekonomike dhe institucionale, që janë kryer dhe që janë në proces. Në këtë kuptim, politikat ekonomike dhe monetare të BE-së, po bëhen gradualisht si një ankorë dhe për politikat ekonomike dhe monetare të vendit tonë.

Për herë të parë, në dhjetor të vitit 1992, Shqipëria nënshkroi me BE-në Marrëveshjen e Tregtisë dhe të Bashkëpunimit, e cila i dha një shtysë riorientimit të aktivitetit ekonomik dhe tregtar të vendit tonë. Që nga fillimi i tranzicionit, Bashkimi European është bërë partneri ekonomik dhe tregtar më i rëndësishëm i vendit. Me këtë grup, Shqipëria zhvillon më shumë se 80 për qind të aktivitetit të tregtisë dhe të investimeve. Bashkimi European është, gjithashtu, dhe donatori dhe mbështetësi kryesor i reformave ekonomike, që janë ndërmarrë. Ndihma që Bashkimi European ka akorduar, që nga viti 1991 deri në fund të vitit 2000, llogaritet në rreth 633.4 milionë EURO³².

Eksportet shqiptare drejt BE-së, për periudhën 1996-2000 u rritën me 22.6 për qind duke përbërë, mesatarisht, 90 për qind të volumit të përgjithshëm (shih grafikun 25).



Grafiku 26. Shpërndarja gjeografike e eksporteve.

³² MBET, material mbi përgatitjen e Tryezës së Dytë të Punës për Paktin e Stabilitetit, 2001.

Në maj të vitit 1999, Komisioni European miratoi dokumentin e quajtur “Procesi i Asocimit dhe Stabilizimit për Europën Juglindore”, dokument, që hedh bazat e integritetit edhe të vendit tonë me BE-në.

Marrëveshja e Asocimit dhe Stabilizimit përfshin elemente të tilla si:

- * institucionalizimin e dialogut politik midis Shqipërisë dhe Këshillit të Asocimit dhe Parlamentit European;
- * forcimin e bashkëpunimit rajonal, përfshirë perspektivat e krijimit të zonave të tregtisë së lirë me vendet e rajonit;
- * perspektivat e krijimit të një zone të tregtisë së lirë me BE-në pas nënshkrimit të marrëveshjes;
- * masa në drejtim të lëvizjes së lirë të njerëzve, të shërbimeve dhe të kapitalit;
- * angazhim në përafrimin e legjislacionit dhe të institucioneve etj..

Në Samitin e Zagrebit (nëntor 2000) midis Bashkimit European³³ dhe vendeve të Europës Juglindore, u inicua programi CARDS (Community Assistance for Reconstruction, Democratisation and Stabilisation), që përfshin një financim prej 4.6 miliardë eurosh për vitet 2000-2006 për të gjitha vendet e rajonit. Kjo asistencë do të synojë mbështetjen e reformave demokratike, ekonomike dhe institucionale të vendeve përkatëse.

Banka e Shqipërisë ka qenë pjesë e këtij procesi, duke marrë pjesë aktive në diskutimet e zhvilluara në tryezat ekonomike në kuadrin e Paktit të Stabilitetit dhe të Kompaktit të Investimeve, si element përbërës i tij, si edhe në zhvillimin e bisedimeve për çeljen e procedurave për anëtarësim në BE. Veç mbështetjes, që Banka e Shqipërisë ka ofruar nëpërmjet ndjekjes së politikave të përshtatshme monetare, ajo ka marrë dhe përgjegjësi konkrete, që po zhvillohen sipas matricës së angazhimeve të marra nga autoritetet e vendit.

Ndër përgjegjësitë që ka Banka e Shqipërisë në këtë proces vlen të përmenden:

- * përsosjet e nevojshme ligjore, të tilla si për shoqatat e kursim-kreditit dhe për legjislacionin e ri mbi sigurimin e depozitave;
- * nisma të tjera të rëndësishme në fushën e zhvillimit të tregut financiar si zgjerimi i pjesëmarrjes së individëve në tregun e bonove të thesarit, forcimi dhe zhvillimi më tej i standardeve të mbikëqyrjes bankare me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e një sistemi bankar të shëndoshë etj.;
- * projekte të rëndësishme si krijimi i Zyrës së Informacionit mbi Kredinë dhe zhvillimi i sistemit të pagesave bruto në kohë reale (RTGS).

³³ Programi është miratuar me Vendimin e Këshillit (EC) No 2666/2000, më 5 dhjetor 2000 “Për asistencën për Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, Republikën Federale të Jugosllavisë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”.

5.3.2. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.

Banka e Shqipërisë ka patur një nivel marrëdhëniesh, që mund të konsiderohet i kënaqshëm me institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat e tjera qendrore.

Është për të mos mbetur jashtë vëmendjes, rigjallërimi i marrëdhënieve, në njëfarë mase të mbetura pa zhvillime të reja, për efekt të krizës kosovare. Normalizimi i përgjithshëm i financave dhe i ekonomisë së vendit, u reflektua edhe në marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me homologët e saj të rajonit e sidomos ato fqinje.

Shkëmbimi i përvojës në fushën e operacioneve monetare, të sistemit të pagesave, të teknologjisë së informacionit etj., ka vazhduar të jetë në vëmendje të bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë me institucionet financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Mjaft të rregullta dhe të vlefshme në asistencën teknike që ofrojnë, mund të konsiderohen marrëdhëniet, tashmë disavjeçare, të Bankës së Shqipërisë me Federal Rezervën e Nju Jorkut, Bis Baselin, Bankën Qendrore të Austrisë, Bankën Qendrore të Anglisë etj..

Shembull konkret i bashkëpunimit të suksesshëm të Bankës së Shqipërisë me institucionet financiare ndërkombëtare është konferenca “Informacioni statistikor në Shqipëri”. Përfaqësues të këtyre institucioneve të ftuar në konferencë, treguan me pjesëmarrjen dhe prezantimet e tyre, vlerësimin për organizatorët e kësaj konference dhe bashkëreferuesit e të ftuarit e tjerë të saj.

5.4. NISMAT LIGJORE

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2000 është përpjekur të rrisë cilësinë e kontributit të saj në fushën ligjore dhe rregullatore.

Në përgatitjen e ligjeve dhe të akteve nënligjore me nismë të saj apo në bashkëpunim të nismave ligjvënese të të tretëve në fushën ekonomike dhe financiare, Banka e Shqipërisë ka synuar konsolidimin e legjislacionit në fuqi.

Pjesëmarrja aktive e Bankës së Shqipërisë në procesin ligjvënës bazohet në ligjin nr.8417, datë 21.10.98 “Për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” nenet 81-85, në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” nenet 3, 24 dhe në ligjin nr.8365, datë 2.7.98 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” neni 6.

Banka e Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor, mbështet stabilitetin dhe zhvillimet ekonomike të vendit. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me organet legjislative dhe ekzekutive të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë kur e konsideron të nevojshme, ndërmerr veprime për të nxitur këtë bashkëpunim në kryerjen e funksioneve të saj veçanërisht nëse legjislacioni në fuqi nuk është i mjaftueshëm për shmangien e kërcënimit të sistemit financiar si dhe për parandalimin e rrethanave të jashtëzakonshme financiare. Bankës së Shqipërisë i jepet për mendim çdo akt normativ, që i dërgohet për miratim Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, me karakter ekonomik dhe me pasoja në fushën e politikës financiare, monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore.

Banka e Shqipërisë, për përgatitjen e dokumenteve ligjore, me nismën e saj apo të të tretëve gjatë vitit 2000 ka kontribuar si më poshtë:

1. Nëpërmjet miratimit të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parasë”, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me FMN dhe organizatat e tjera ndërkombëtare të specializuara, përfundoi me sukses nismën e saj disavjeçare për parandalimin e një prej formave më moderne të veprimtarisë kriminale. Banka e Shqipërisë, duke shfrytëzuar burimet e saj profesionale dhe fleksibilitetin e saj institucional për t’ju përgjigjur zhvillimeve mbarëbotërore në këtë fushë të ndjeshme, arriti t’u imponojë nismën e saj organeve ligjvënese dhe ekzekutive, pavarësisht se nuk është institucioni, që trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë problematikën, në përgjithësi, të krimit financiar dhe, në veçanti, të krimit të pastrimit të parave.
2. Projektligji “Për sigurimin e depozitave” është përfshirë në politikat strukturore të vitit 2001 si rezultat i zhvillimeve të fundit në sistemin bankar shqiptar. Projekti është pjesë e rëndësishme e politikave strukturore në sistemin bankar për arsye se rregullon marrëdhënie të caktuara ndërmjet depozituesve, bankave të nivelit të dytë dhe organeve shtetërore, ligjvënese dhe ekzekutive. Këto marrëdhënie, luajnë rol shumë të rëndësishëm në kuadër të përfundimit të procesit të privatizimit të bankave shtetërore, të rritjes së konkurrencës në tregun e produkteve bankare si dhe të zbutjes së pasojave të krizave të paparashikueshme financiare.

3. Banka e Shqipërisë, u angazhua edhe në rishikimin e ligjit “Për shoqëritë e kursim-kreditit”. Në bazë të ligjit, Banka e Shqipërisë rivlerësoi qëndrimin e saj nëse shoqëritë e kursim-kreditit duhen përjashtuar apo përfshirë si subjekte në dispozitat e ligjit nr.8365, datë 02.07.98 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, tërësisht ose pjesërisht, për shkak të natyrës, të vëllimit të veprimtarisë dhe të origjinës së burimeve financiare të tyre. Gjithashtu, rishikimi i ligjit trajtoi edhe aspektet e qëllimit të krijimit të shoqërive të kursim-kreditit. Qëllimet e rishikimit të ligjit kanë të bëjnë me përcaktimin e shoqërive kursim-krediti dhe të unioneve që krijohen nga bashkimi i tyre si subjekte të dispozitave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë kuadër, të rishikohet edhe mënyra dhe procesi se si do të realizohej licencimi, mbikëqyrja dhe rregullimi i aktivitetit të tyre.

4. Gjatë vitit 2000, u përfundua procesi i kalimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit nga Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë në zotërim të subjekteve Kent Bank, Koorporata Ndërkombëtare Financiare dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Banka e Shqipërisë kontribuoi për plotësimin dhe për saktësimin e kuadrit ligjor “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare”. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë në bazë të ligjit nr.8365, datë 02.07.98 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” miraton paraprakisht (a) çdo aksioner që propozohet të zotërojë pjesëmarrje influencuese në më shumë se 10 për qind të kapitalit aksioner të shoqërisë; (b) administratorët e shoqërisë të propozuar nga blerësit; (c) zvogëlimin e kapitalit aksioner të shoqërisë; (ç) transferimin, në një masë të konsiderueshme, të aktiveve të bankës etj..

Gjithashtu, vlen të përmendet bashkëpunimi në përgatitjen e amendamenteve në ligjin e letrave me vlerë, në ligjin për fondet e investimit, në projektligjin për falimentimin, në amendamentet në ligjin e agjencisë së trajtimit të kredive të këqija etj..

Kapitulli 6.

Zhvillimi i institucional i Bankës së Shqipërisë

Strategjia për zhvillimin institucional të Bankës së Shqipërisë³⁴ përcaktoi një sërë objektivash të domosdoshëm për t'u përmbushur në periudhë afatshkurtër e afatmesme me qëllim që të nxitej zhvillimi i bankës qendrore. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2000, vëmendje e veçantë iu kushtua atyre objektivave, që përbënin prioritet ku mund të përmendet rritja e transparencës, përshtatja e strukturës organizative të bankës me detyrat e reja, që do të kryheshin apo zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe përmirësimi i statistikave.

6.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Në tetor të vitit 2000, Këshilli Mbikëqyrës miratoi ndryshimin e strukturës organizative të Bankës së Shqipërisë. Ky ndryshim³⁵, i kryer në kuadrin kohor të dy vjetëve e gjysmë, u gjykua i nevojshëm me qëllim që struktura e Bankës t'i përshtatej më mirë përmbushjes së objektivave strategjike si dhe për të siguruar një lidhje funksionale më efektive midis departamenteve dhe njësive përbërëse të tyre.

Në strukturën e riorganizuar, u pakësuan ose u thithën nga njësi të tjera disa nga njësitë, të cilat nuk justifikonin pavarësinë apo krijonin dublim të aktivitetit. Ndryshimet kanë të bëjnë me:

1. Bashkim njësish.

- * Në funksion të mbështetjes së strategjisë për përsosjen e sistemit të pagesave dhe kontabilitetit, struktura e re përcaktoi, gjithashtu, edhe bashkimin e Departamentit të Kontabilitetit me Departamentin e Pagesave. Ky organizim pritet të ndikojë në zhvillimin, konceptimin dhe implementimin e një sistemi të pagesave të tipit RTGS, por, gjithashtu, edhe në përsosjen e sistemit të kontabilitetit, si një mjet në shërbim të nevojave të administrimit dhe të drejtimit të brendshëm. Po kështu, kalimi i Sektorit të Financës nga Departamenti i Administrimit në Departamentin e Kontabilitetit dhe Pagesave, siguroi grumbullimin, në një departament të vetëm, të njësive me funksione të ngjashme si dhe ndarjen e detyrave midis "regjistruarit" të shpenzimeve dhe "ekzekutuesit" të tyre, duke siguruar dhe rritjen e kontrollit mbi shpenzimet që kryen banka qendrore.

³⁴ Strategjia është miratuar me vendimin nr. 111, datë 17.11.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁵ Ndryshimet e fundit të skemës organizative të Bankës së Shqipërisë i përkasin marsit të vitit 1998.

- * Bashkimi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit me Qendrën e Informacionit, u diktua nga nevoja për informatizimin dhe centralizimin e procesit të grumbullimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së informacionit statistikor të Bankës së Shqipërisë. Procesit të përmirësimit të informacionit statistikor mendohet t'i shërbejë dhe krijimi, po në këtë departament, i njësisë së vrojtimeve statistikore, gjë që do të sigurojë kryerjen e vrojtimeve më profesionale nga Banka e Shqipërisë.
- * Nisur nga prioritetet e administrimit dhe të kualifikimit të kapitalit human, të përmirësimeve ligjore dhe të akteve rregullatore të Bankës së Shqipërisë si dhe marrëdhënieve midis punëmarrësve dhe punëdhënësve në bankën qendrore, u pa i nevojshëm bashkimi, në një departament të vetëm, i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Departamentit Juridik. Nga ky veprim synohet të përsoset dhe të mbështetet një shërbim më i kualifikuar juridik dhe i burimeve njerëzore, shërbim, i cili do të reflektojë ndikimet e tij në departamentet dhe njësitë e tjera të institucionit.

2. Njësitë e reja.

- * Brenda departamenteve ekzistuese u krijuan njësi të reja që do të kryejnë funksione të reja. Ndër më të rëndësishmet, vlerësohet të jetë krijimi, në Departamentin e Operacioneve Monetare, i strukturës përkatëse që do të merret me matjen e rrezikut të investimeve të Bankës së Shqipërisë, vlerësimit të investimit, kontrollit real të zbatimit të politikës së administrimit të rezervës valutore, funksione këto, të cilat e plotësojnë më mirë kuadrin e veprimtarisë së këtij departamenti.
- * Synimi i Bankës së Shqipërisë për të qenë më e hapur dhe për të zhvilluar më tej marrëdhëniet me publikun, duhet të mbështetet nga një departament i mirëorganizuar, ai i Marrëdhënieve me Publikun.

Sipas strukturës së riorganizuar është:

- shtuar numri gjithsej i punonjësve nga 314 në 334. Rritjet në numrin e punonjësve vërehen më tepër në disa departamente sidomos në ato kryesore, por dhe mbështetëse, si në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Në këtë mënyrë është vendosur një raport më i drejtë midis punonjësve, që merren me zbatimin e funksioneve të bankës qendrore në krahasim me punonjësit, që kryejnë aktivitet mbështetës. Në fund të vitit 2000, në Bankën e Shqipërisë punonin 294 vetë. Pra, shkalla e plotësimit me punonjës sipas strukturës ishte 88 për qind;
- realizuar një ndarje e varësisë së departamenteve midis tre administratorëve të bankës. Departamentet, që kryejnë funksionet bazë të bankës qendrore kanë kaluar në varësi të Guvernatorit.

Dy zëvendësguvernatorët janë edhe drejtorë departamentesh. Ky riorganizim ka për synim rritjen e përgjegjësisë së administratorëve dhe, njëkohësisht, ofron një skemë më efektive e funksionale në zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Nëpërmjet kësaj ndarjeje, sigurohet mundësia e një kontrolli më të madh në ndjekjen dhe në realizimin e objektivave;

- krijuar një post i ri në departamente të ndryshme. Krahas drejtorit të departamentit, struktura e re parashikon dhe zëvendësdrejtorët. Kjo u bë e nevojshme si pasojë e bashkimit të njësive të ndryshme me qëllim administrimin më të mirë të tyre. Njëkohësisht, prania e zëvendësdrejtorëve do të eliminojë një nga mangësitë në organizimin e punës së Bankës së Shqipërisë, përqendrimin e problemeve në pak duar. Zëvendësdrejtorët, gjithashtu, janë të detyruar të jenë të informuar për problemet e departamentit. Kjo siguron vijimësi normale pune në çdo situatë;
- parashikuar emërimi i “kryespecialistëve”. Kryespecialisti nuk përfaqëson shkallë ngritjeje në pozitë në hierarkinë e bankës, por një vlerësim për punë të mirë të specialistëve të saj, duke shërbyer edhe si një nxitës në punë³⁶.

³⁶ Për detaje shih skemën organizative bashkëngjitur.

6.2. BANKA E SHQIPËRISË – BANKË MË TRANSPARENTE

Banka e Shqipërisë vepron në përputhje me detyrat e saj ligjore dhe është përgjegjëse përpara publikut për zbatimin e politikës monetare, për drejtimin e mbikëqyrjes bankare si dhe për përmbushjen e detyrave të tjera ligjore. Është detyrim i Bankës së Shqipërisë të informojë publikun për veprimtarinë e saj. Për pasojë, rritja e transparencës u kthye në një prioritet për Bankën e Shqipërisë në vitin 2000. Veprimet e ndërmarra gjatë vitit 1999 dhe më me intensitet gjatë vitit 2000 shërbyen si masa për të vendosur themelet e transparencës, për të adoptuar filozofinë e të qënurit institucion i hapur. Kjo nuk mund të realizohej lehtë në një institucion, që kishte qenë relativisht i panjohur dhe i fshehur për sytë e publikut dhe në një ambjent me tradita jodashamirëse ndaj transparencës.

6.2.1. KRAHASUESHMËRIA ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE.

Banka e Shqipërisë, pa mëdyshje, përcaktoi si synim të saj respektimin e standardeve ndërkombëtare të përpunuara në fushën e transparencës siç janë Kodi i Praktikave më të Mira për Transparencën në Politikat Monetare dhe Financiare (Kodi) dhe Standardet e Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (GDDS). Banka e Shqipërisë kërkoi nga FMN të vlerësonte shkallën e respektimit të kërkesave të Kodit dhe të bënte pjesë në GDDS.

Suksesi në respektimin e këtyre dy standardeve është i ndryshëm. Shqipëria u zgjodh vend pilot në zbatimin e GDDS dhe arriti të përfundojë me sukses fazën e parë të tij, botimin e *metadatave* në muajin prill 2000. Në lidhje me respektimin e Kodit, vlerësimi i FMN-së ishte zhgënjyes: “... *shkalla e zbatimit të praktikave të dëshirueshme të përcaktuara në Kod, nga ana e Bankës së Shqipërisë, është e përzier. Nga njëra anë, Banka e Shqipërisë ka arritur, për të gjitha qëllimet praktike, zbatim të gjerë të praktikave të dëshirueshme në lidhje me qartësimin e roleve, përgjegjësi dhe objektivave. ... Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë zbaton vetëm pjesërisht ose madje aspak praktikën e dëshirueshme të Kodit në lidhje me procesin e hapur për formulimin dhe raportimin e politikës monetare. ... Zbatimi i praktikave të dëshirueshme të Kodit në këtë fushë, kur ndodh, është shpesh në lidhje me tekstin e Kodit jo me frymën e tij. Kjo situatë është shkak për t'u shqetësuar sepse ndikon ndjeshëm transparencën dhe, në fund të fundit, përgjegjshmërinë. Përveç kësaj, ajo dëmton efektshmërinë e mekanizmit të transmissioinit të politikës monetare duke e bërë më të vështirë për tregjet të formojnë me efektshmëri pritshmëritë. Dobësitë e theksuara në këtë fushë duhet të trajtohen si një çështje prioritare.*”

6.2.2. RREGULLORJA PËR “TRANSPARENCËN DHE KONFIDENCIALITETIN NË BANKËN E SHQIPËRISË”.

Për të siguruar respektimin e standardeve dhe angazhim maksimal të drejtuesve dhe të punonjësve të Bankës së Shqipërisë në rritjen e transparencës së institucionit, u miratua, në qershor të vitit 2000, rregullorja mbi “Transparencën dhe konfidencialitetin”.

Objekti kryesor i rregullores është **“rritja e transparencës në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë si dhe administrimi i informacionit jopublik në Bankën e Shqipërisë”**.

Miratimi i rregullores synonte të realizonte një ndërrim të filozofisë së Bankës: nga institucion konfidencial, në institucion të hapur ndaj publikut. Zbatimi i kërkesave të kësaj rregulloreje synonte:

- adoptimin e një aktiviteti më transparent brenda për brenda Bankës së Shqipërisë;
- njohjen e organeve shtetërore qendrore, të pushtetit gjyqësor dhe të publikut me çështje të natyrës ekonomike.

Në këtë mënyrë, procesi i rritjes së transparencës mendohet të ndihmojë në rritjen e besueshmërisë, e përgjegjshmërisë dhe të pavarësisë së Bankës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, kjo do të sigurojë edhe edukimin e publikut me problemet ekonomike, duke orientuar lojtarët ekonomikë dhe duke kontribuar në rritjen e eficiencës së mekanizmit të transmisionit të vendimeve të Bankës së Shqipërisë në ekonomi. Elementi më i rëndësishëm i rregullores janë detyrimet kohore të vendosura për realizimin e një sërë hapave, të cilët do të çojnë në rritje të transparencës.

6.2.3. KONFERENCAT DHE PUBLIKIMET.

Rritja e transparencës është menduar të realizohet nëpërmjet shtimit të konferencave për shtyp, daljeve në Kuvend, organizimit të seminareve dhe të takimeve për diskutim apo të konferencave.

Gjatë vitit 2000, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë është paraqitur tri herë në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit; dy herë në konferenca shtypi; në Fakultetin Ekonomik dhe në Shkollën e Lartë të Magjistraturës për të mbajtur leksione mbi pavarësinë e bankës qendrore dhe inflacionin; një herë në takimin e diskutimit mbi funksionimin e Bursës së Tiranës.

Në vitin 2000, për herë të parë Banka e Shqipërisë organizoi konferencën kombëtare “Informacioni Statistikor në Shqipëri” në bashkëpunim me Institutin e Statistikave. Qëllimi i organizimit të konferencës ishte tërheqja e vëmendjes për nivelin e ulët të zhvillimit të statistikave në Shqipëri dhe për kujdesin e pakët, që i është kushtuar këtij problemi. Nga ana tjetër, organizatorët kërkonin të përçonin në autoritetet më të larta të vendit, por edhe në mjedisin e biznesit, idenë e dobishmërisë së pasjes së statistikave të mira. Nëpërmjet kësaj konference synohej të edukohej publiku mbi rëndësinë që kanë statistikatat për procesin vendimarrës.

Nga ana tjetër, rritja e numrit të titujve të publikimeve dhe e abonentëve do të ndihmojë në rritjen e shkallës së njohjes së aktivitetit të Bankës së Shqipërisë.

Publikimet, aktualisht, përbëjnë mjetin më kryesor me të cilin Banka e Shqipërisë zbulon veprimtarinë e saj në publik. Publikimet e Bankës së Shqipërisë përbëhen sot nga një shumëllojshmëri titujsh. Ato i ofrohen periodikisht publikut ose, sipas rastit, ka edhe botime të veçanta.

Nëse viti 1998 shënon një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të rritjes së numrit të titujve të publikuar, viti 2000 shënon një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të cilësisë së publikimeve, duke ofruar material të bollshëm, që trajton çështje të shumë sektorëve të ekonomisë, jo thjesht aspektet bankare, financiare e të politikave monetare e valutore, të shkruara në gjuhë teknike, por edhe në gjuhë të thjeshtë.

Zhvillim i rëndësishëm në vitin 2000 ka qenë rritja e botimeve me karakter shpjegues dhe që shkruhen me gjuhë të thjeshtë. Këto janë botime të realizuara në formën e broshurave, që marrin përsipër të transmetojnë tek publiku njohuri mbi çështje të ndryshme të fushës ekonomike. Për herë të parë, një broshurë e tillë u botua në korrik të vitit 1999 dhe shpjegonte bankën qendrore. Në vitin 2000 u kalua në botimin periodik të broshurave, një herë në tre muaj.

Botimet joperiodike, gjithashtu, patën një shtim të konsiderueshëm sidomos në titullin e materialeve të diskutimit. Për herë të parë, Banka e Shqipërisë ka botuar analiza vrojtimi duke pasqyruar një aktivitet të ri, që ajo filloi në përpjekje për të përmirësuar shkallën e informacionit. Analizat e vrojtimit përmbajnë analiza, konkluzione e rekomandime në të cilat arrihet pas kryerjes së vrojtimeve për aspekte të ndryshme.

Numri i faqeve të botuara çdo muaj është rritur nga 90 në vitin 1998 në 200 përkatësisht për vitet 1999 dhe 2000. Në vitin 2000 numri i faqeve të botuara si materiale studimi dhe materiale promocionale është rritur përkatësisht 70 për qind dhe 6 herë në krahasim me vitin 1999. Megjithatë, këto botime ende zënë një peshë të vogël në numrin e botimeve gjithsej, përkatësisht 9.8 dhe 5 për qind. Në këtë mënyrë, Banka e Shqipërisë ka identifikuar si objektiv për vitin 2001, shtimin e materialeve promocionale dhe të materialeve të diskutimit.

Për të qenë më pranë publikut, në vitin 2000, Banka e Shqipërisë botoi faqen në internet, e cila përmban informacion të bollshëm dhe të hollësishëm. Për herë të parë këtë vit ajo bën publike, paraprakisht, tematikën e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës si dhe menjëherë pas mbledhjeve të tij publikon dhe sqaron vendimet e marra. Nga muaji në muaj është shtuar numri i mesazheve që merr banka nga të interesuarit për faqen e saj. Në vitin 2000 është dyfishuar numri i përgjigjeve informuese nga Banka e Shqipërisë (rreth 250 në muaj).

Banka e Shqipërisë ka si parim të ofrojë mbështetje të konsiderueshme financiare për procesin e rritjes së transparencës:

- botimet e bankës qendrore mund t'i kërkojë çdokush dhe ato ofrohen falas për këdo. Konkretisht, lista e abonentëve të Bankës së Shqipërisë në vitin 2000 është shtuar mesatarisht tre herë në krahasim me vitin 1998. Ndërsa, lista e abonentëve për broshurat promocionale në vitin 2000 në krahasim me vitin 1999 është shtuar 5 herë³⁷. Shpenzimet e kryera për botimet në vitin 1999 janë rreth 3 herë më të larta se në vitin 1998. Në vitin 2000 ato ishin 3 dhe 18 herë më të larta përkatësisht se vitet 1999 dhe 1998;
- organizon seminare, takime diskutimi e konferenca për të cilat është shpenzuar një fond prej 3.1 milionë lekësh;
- vrojtimet statistikore, si pjesë e përmirësimit të statistikave dhe transparencës, për të cilat janë shpenzuar 460 mijë lekë.

³⁷ Krahasimet bëhen përkatësisht me vitet 1998 dhe 1999 pasi përfaqësojnë periudhën kur janë përgatitur botimet për herë të parë.

6.3. ZHVILLIMET NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit përbën më shumë se një domosdoshmëri, një përparësi të zhvillimit të institucionit. Duke marrë në konsideratë shkallën aktuale të zbatimit të sistemeve të informacionit, tendencat dhe prirjet e sotme, nevojat e pritshme, Banka e Shqipërisë mendon se zbatimi, në një shkallë të gjerë, i këtyre sistemeve do të ndihmojë në rritjen e eficiencës dhe në zhvillimin e përgjithshëm institucional të saj.

Në këtë vështrim, gjatë vitit 2000, Banka e Shqipërisë, ka riorganizuar njësinë përgjegjëse për realizimin e sistemeve të informacionit, me qëllim mbështetjen me struktura dhe me specialistë të projekteve të ndërmarra si dhe rritjen e cilësisë së komunikimit midis njësive të tjera të Bankës së Shqipërisë dhe asaj të Teknologjisë së Informacionit. Nga ana tjetër, ajo ka përqendruar vëmendjen e saj në realizimin e dy projekteve mjaft të rëndësishme dhe parësore: zbatimin e sistemit kontabël brenda bankës qendrore dhe të RTGS.

6.3.1. ZHVILLIME ORGANIZATIVE.

Ndyshimet organizative të realizuara gjatë vitit 2000, si dhe rikonceptimi i detyrave dhe funksioneve të njësive dhe të secilit individ brenda Njesisë së Teknologjisë së Informacionit mendohet të jenë faktorë mbështetës në (1) realizimin e suksesshëm të projekteve të ndërmarra tashmë, (2) rritjen e shkallës së mbështetjes që teknologjia e informacionit i jep njësive të tjera të Bankës së Shqipërisë, (3) sigurimin, dhe për të ardhmen, të vazhdimësisë për realizimin e objektivave, (4) specializimin e ngushtë të punonjësve si dhe vendosjen e tyre në vendet më të përshtatshme.

Nuk mund të mendohet, në asnjë rast, që zhvillimet brenda departamentit janë të mjaftueshme për realizimin e detyrave të tij. Për realizimin e objektivave në fushën e teknologjisë së informacionit duhet të kontribuojnë dhe njësitë e tjera të Bankës së Shqipërisë, të cilat janë dhe përfitueset e këtyre sistemeve.

Duke vlerësuar si mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin brenda institucionit, gjatë vitit 2000, është punuar në drejtim të përfshirjes reale të njësive të tjera të Bankës së Shqipërisë si në hartimin e strategjisë së zhvillimit të teknologjisë së informacionit, ashtu dhe në realizimin e projekteve të kësaj fushe. Më konkretisht, është punuar për ngritjen e Komitetit të Strategjisë së Zhvillimit të Teknologjisë së Informacionit. Detyra kryesore e tij është përcaktimi i një strategjie zhvillimi në përputhje me atë të zhvillimit të vetë institucionit.

6.3.2. PROJEKTET KRYESORE NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT.

Projektet për zbatimin në bankën qendrore të sistemit kontabël dhe RTGS.

Banka e Shqipërisë ka si objektiv parësor afatshkurtër realizimin e një sistemi pagesash në vlerë të madhe (RTGS) si dhe të një sistemi kontabël dhe të administrimit të rezervës valutore dhe aktivitetit të saj financiar.

Për realizimin e këtyre dy projekteve, në vijim të një sërë rekomandimesh të FMN-së, si dhe me ndihmën dhe asistencën teknike të ekspertëve të huaj në këto fusha, Banka e Shqipërisë, ka përgatitur një dokument të detajuar mbi “Kërkesat e biznesit” për të dyja sistemet e informacionit. Dokumentet e mësipërme kanë marrë miratimin përkatës nga FMN e më pas, në kuadrin e ndihmës dhe të asistencës tekniko-financiare të Bankës Botërore, kanë qenë subjekt përmirësimesh.

Sistemi i pagesave në vlerë të madhe (RTGS) do të konsistojë në (1) rregullimin në kohë-reale midis pjesëmarrësve të këtij sistemi nëpërmjet llogarive të tyre në bankë, (2) ofrimin e instrumenteve dhe të mjeteve për rritjen e eficiencës së administrimit të likuiditetit të pjesëmarrësve, (3) përmirësimin e mjeteve në administrimin dhe në mbikëqyrjen e politikës monetare (4) realizimin e një shkalle të lartë besueshmërie, sigurie dhe integriteti, të aftë të përballojë nevojat në rritje të ekonomisë shqiptare, (5) zhvillimin e infrastrukturës komunikuese të sistemit bankar shqiptar, (6) realizimin e infrastrukturës mbështetëse për zhvillime të mëtejshme në këtë fushë.

Realizimi dhe zbatimi i këtij projekti kërkohet të bëhet në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe duhet të mbështetet në parimet (1) fleksibilitet dhe modularitet, për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm dhe integrim maksimal me nënsistemet e tjera (2) shkallë e lartë sigurie dhe integriteti (3) qëndrueshmëri dhe besueshmëri e lartë (4) gjurmim i plotë mbi të gjitha transaksionet dhe rrjedhën e tyre.

Realizimi i këtyre kërkesave të biznesit është kryer, gjithashtu, me bashkëpunimin dhe përfshirjen e bankave, të cilat do të jenë pjesëtare dhe përfituese të shërbimeve të tij.

Zbatimi i sistemit kontabël, administrimit të rezervës valutore si dhe funksioneve të tjera financiare të Bankës së Shqipërisë konsiston në (1) automatizimin e procesit, (2) zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit duke ndjekur praktikat më të mira ndërkombëtare në formulimin e politikave dhe të procedurave kontabile për bankat qendrore, (3) përmirësimin dhe zhvillimin e mjeteve dhe të procedurave për administrimin e rezervës valutore dhe, ndërhyrjeve në treg, (4) lidhjen, në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë-reale, me degët e Bankës së Shqipërisë nëpër rrethe, (5) krijimin e një ndërfaqeje automatike me sistemin RTGS, (6) rritjen e cilësisë dhe të disponueshmërisë së informacionit kontabël.

Duke konsideruar rëndësinë e dy projekteve të mësipërme si dhe shkallën e ndikimit, jo vetëm mbi aktivitetin e bankës, por në gjithë sistemin bankar dhe ekonominë shqiptare, në përgjithësi, realizimi i tyre do të bëhet me ndihmën dhe asistencën tekniko-financiare të Bankës Botërore. Financimi i projekteve bën pjesë në projektin e ri të “Asistencës teknike për ndërtimin e institucioneve të sektorit financiar” miratuar në qershor 2000.

Gjatë vitit 2000 janë përcaktuar, gjithashtu, hapat e mëtejshëm, që duhet të ndiqen në drejtim të finalizimit të projekteve. Për një administrim më të mirë të burimeve njerëzore si dhe duke marrë parasysh shkallën e varësisë së sistemeve, realizimi i tyre mendohet i ndarë, ku përparësi do të ketë ai kontabël. Gjatë vitit 2001 mendohet të përfundojë zbatimi i sistemit qendror kontabël si dhe do të fillojë puna për realizimin e sistemit RTGS. Përfundimi i këtij të fundit mendohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2002.

Sistemi IDCN.

Gjatë vitit 2000, është punuar, gjithashtu, për realizimin e rrjetit të komunikimit ndërbankar. Qëllimi i këtij projekti është realizimi i komunikimit të sistemit bazuar në "Teknologjinë internet". Bankat dhe pjesëmarrësit e tjerë në sistem, nëpërmjet këtij mjeti standard komunikimi të mbështetur në një nivel të lartë sigurie, do të mund të shkëmbejnë informacion në mënyrë të shpejtë e të sigurt si me Bankën e Shqipërisë ashtu dhe ndërmjet tyre.

Realizimi do të jetë modular dhe do të ofrojë fillimisht shërbimin e komunikimit *on-line* dhe *kohë-reale*, mundësinë e publikimit, nga pjesëmarrësit, të kuotimeve të tyre për instrumente të ndryshme financiare, dërgimin e kërkesave për pjesëmarrje në ankadet e repo –repo të anasjellta të organizuara nga Banka e Shqipërisë etj.. Zbatimi në trajtë modulare dhe me pavarësi maksimale midis shërbimeve, do të mundësonte zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve të këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë mendohet që, në një fazë të dytë, të realizohet një sistem elektronik raportimi i bankave në Bankën e Shqipërisë.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2001 mendohet të fillojë lidhja e klientëve të parë në sistem dhe gjatë tremujorit në vazhdim mendohet të përfundojë lidhja e të gjithë pjesëmarrësve.